REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 9

Rrogozhinë, më 22.11.2023 ora 13 : 00 ^oo

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës "Njoftim", të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.4181.Prot datë 16.11.2023 si më poshtë :

1- Miratim i rendit të ditës.
2- Miratim i procesverbalit Nr.8, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 02.11.2023.
3- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%".
4- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i pushtetit vendor".
5- Shqyrtim i Paketës Fiskale 2024 për Bashkinë Rrogozhinë.
6- Raport nga Administratorët e Njësive Administrative Kryevidh, Lekaj, Sinaballaj.
7- Raport nga Sektori i Auditit të Brendshëm.
8- Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Silvana Aliu, Indrit Dedej, Lije Dedej, Besnie Coraj, Saimir Cani, Mitat Daja, Fatbardha Sina, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Mukades Gixhari, Erind Tosku, Hekuran Xhani.

Mungojnë :

Ferdi Avdiu, Sokol Gosa, Renato Kalemi, Shpati Kolgega.

Të ftuar :

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Shkelqim Gjoni - Administrator i Njësisë Administrative Kryevidh.
3. Altin Mema - Administrator i Njësisë Administrative Lekaj.
4. Valmira Troka - Administratore e Njësisë Administrative Gosë.
5. Mexhit Saliu - Administratore e Njësisë Administrative Sinaballaj.
6. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
7. Amarildo Duka - Sekretar i Përgjithshëm.
8. Rezart Vogli - Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social.
9. Fatmir Meçaj - Drejtori i Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Kulturës.
10. Orges Tosku - Drejtor i të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
11. Geraldo Gjini - Drejtori i Politikave Urbane.
12. Helidon Plaku - Drejtor i zyrës Juridike dhe Marrëdhënieve me Publikun.
13. Olsi Dranga - Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse.
14. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Pyjeve, Veterinarisë, Kullimit dhe Vaditjes.
15. Ledian Hasani – Përgjegjës i Shërbimit Social.
16. Nuredin Tosku - Përgjegjës i Auditit të Brendshëm të Bashkisë.
17. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshmëm gjithsej 14- Këshilltarë, z. Erind Tosku dhe z. Hekuran Xhani i bashkohen në vijim mbledhjes së KB-së.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Të nderuar këshilltarë! Përpara se të hapim këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë më lejoni të përkujtojmë humbjen e parakohshme të kolegut tonë Bajazit Thaçi. Ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje për të nderuar dhe respektuar kujtimin e anëtarit të dashur të Këshillit Bashkiak, i cili la pas një boshllëk të ndjeshëm në zemrat tona.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Këshilltarët dhe pjesëmarrrësit në mbledhje ngrihen në këmbë dhe mbajnë një minutë heshtje.

... I paharruar qoftë gjithmonë kujtimi i të mirit Bajazit.

Mukades Gixhari . Meqë e kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!
Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët:
Znj. Silvana Aliu, Z. Indrit Dedej, Znj. Lije Dedej, Znj. Besnie Coraj, Z. Saimir Cani, Z. Mitat Daja, Znj. Fatbardha Sina, Z. Altin Tosku, Znj. Gezime Met-hasani, Z. Lulzim Hasa, Znj. Alime Hoxha, Z. Enver Memolla, Znj. Fatmira Thartori, dhe Mukades Gixhari.
Lexojmë verifikimin ligjor të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për mbledhjen e datës 02.11.2023.
Vendim nr.28, datë 02.11.2023 "Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shpërndarjen në buxhet" është në përputhje me ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, si dhe aktit normativ nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në buxhetin e vitit 2023".
Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Prefekti Afrim Qendro.

Tani para se të kalojmë në rendin e ditës ju kam dërguar në grupin e këshillit në whatsapp si dhe i keni të fotokopjuara përpara projektvendimin "Mbi një shtesë në vendimin e këshillit Bashkiak nr.8, datë 30.06.2023 'Për miratimin e komisioneve të përhershme të këshillit bashkiak Rrogozhinë", informacionin mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Tetor 2023 të ardhur nga Njësia Administrative Gosë. Kemi të pranishëm dhe Përgjegjësin e Elektrikut z. Edmond Memolla për të diskutuar mbi problematikat e ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë. Jeni dakord që t'i përfshijmë në rend dite dhe ti trajtojmë në pikën të ndryshme të rendit të ditës këto? Jeni dakord të nderuar Këshilltarë? E hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim?

- Miratohet me 14-vota pro, përfshirja në rend dite e projektvendimit, "Mbi një shtesë në vendimin e këshillit Bashkiak nr.8, datë 30.06.2023 'Për miratimin e komisioneve të përhershme të këshillit bashkiak Rrogozhinë", informacioni mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Tetor 2023 të ardhur nga Njësia Administrative Gosë, si dhe shqyrtimi i problematikave të ndërprerjes së energjisë elektrike nga përgjegjësi i OSHE dega Rrogozhinë.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratim i rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, Kundra, Abstenim? Të gjithë pro miratohet.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

-Miratohet me 14 vota pro pika e parë e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën dy. Miratim i procesverbalit nr.8, datë 02.11.2023. E hedhim në votim. Pro, Kundra, Abstenim? Të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 14 vota pro pika e dytë e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës miratim i projektvendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% ". Do na relatojë përgjegjësi i shërbimit social z. Ledian Hasani. Përshëndetje z. Ledian!

Ledian Hasani . Përshëndetje të gjithëve! Në total janë 18 familje përfituese dhe fondi është 67 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje për z. Ledian në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës. Po z. Enver Memolla.

Enver Memolla . Unë nuk kam ndonjë gjë po thjesht kërkoj edhe nga Ledio që anën ligjore në komisonin e ekonomisë u diskutua në lidhje me rritjen e pagesave por që ana ligjore nuk ta lejon. Ja kishim kërkuar edhe … mirëpo e kanë sjellë dhë është ok kjo pjesë. Pika e fundit e cakton qartë që thotë në bazë të përfitmit të ndihmës ekonomike, në këtë pjesë nuk ndërhyjmë dot për ta rritur.

Ledian Hasani . E kemi miratuar që në 2020, po të njëjtën gjë do miratojmë po i njëjti projektvendim.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim tjetër? E hedhim në votim? Kush është pro, kundra, abstenim? Të gjithë pro, miratohet.

-Miratohet me 14 vota-pro, pika tre e rendit të ditës.

Vendim nr.29. Miratohet me 14 vota pro projektvendimi i propozuar nga kryetari i Bashkisë me nr.4152,prot datë 14.11.2023, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%".

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, miratimi i projektvendimit, "Për dhënien e ndihmës

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i pushtetit vendor".
Vazhdojmë po me përgjegjësin e sektorit të shërbimit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Në total janë 20 familje përfituese dhe fondi është 91 mijë lekë të reja.

Indrit Dedej . Sa më shumë aq më mirë.

Ledian Hasani . Edhe ju kur keni ndonjë familje që e shikoni që është në nevojë, t'i verifikojmë dokumentacionin edhe... Ne nuk kemi parë kujt krahu i përket fare.

Enver Memolla . Ne dje diskutuam edhe në komisionin e ekonomisë edhe Ledit ja thashë që këtu është një person për ndihmë ekonomike tek pjesa e ministrisë sociale. Do kërkoja pak transparencë për këtë emër që ta thoje ti vetë se pse do hasim në ndesh mbledhjet e tjera pse është ky emër dy herë.

Ledian Hasani . Pa merak fare, atëherë tek kriteret që kemi miratuar në 2020 janë po ato familje mund të jenë përfituese tek fondet e bashkisë edhe ato familje që janë në vështirsësi ekonomike, i keni kriteret aty dmth tek ai dokumenti që ju solla dje.

Enver Memolla . Më shumë thashë për transparencë.

Ledian Hasani . Ajo është familje në vështirësi ekonomike, përgjegjësinë për atë e mbaj unë. Besoj ti e njeh atë?

Enver Memolla . E njoh prandaj thashë ta bëj transparente këtë pjesë, se e diskutuam këtë dje.

Ledian Hasani . Është Pasionata Muhamet Xhafa është edhe përfituese tek skema e ndihmës ekonomike edhe tek... kjo ka një fëmijë që e ka të sëmurë dhe nuk ka mundësi që ta ndjekë nëpër spitale apo në qendra shëndetësore.

Silvana Aliu . Po e kërkuam në mbledhjen e radhës dhe nuk e bëtë... punonjësi social ta marri fëmijën të paktën t'i bëjë shërbim...

Ledian Hasani . Nuk kam qenë në mbledhje. Nuk kam qenë prezent se po të kisha qenë këtu të kisha thënë do e kisha bërë. Kjo është një ndiohmë q ëajo do përfitojë tre muaj besoj që I dalin për të shkuar për t'i bërë shërbim vizita.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Andi Proshka . Rezart shihe pak këtë.

Ledian Hasani . I dalin për të kryer vizita jo me i kryer hallin asaj ajo mund të ketë halle shumë.

Rezart Vogli . Përshëndetje! Një sqarim për rastin Aishe Xhafa vajza e Bujarit dhe Pasionatës referuar dhe në drejtorinë e shërbimit social, po e referoi edhe znj. Silvana po ndiqet nga stafi i shërbimit social, vajza është me probleme të shëndetit dhe Bashkia Rrogozhinë edhe Shërtbimi Social është në ndjekje të rastit. Faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Ndonjë pyetje tjetër? Atëherë e hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 14-vota pro pika 4 e rendit të ditës.*

Vendim nr .30. Miratohet me 14-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me nr.4057.prot datë 08.11.2023 "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i pushtetit vendor".

Mukades Gixhari . Ju bëj me dije që mbledhjes ju bashkua z. Saimir Cani. Tani për procedurë, meqë kemi procesverbalin e komisionit të mandateve, i propozojmë Këshillit Bashkiak të deklarojë me vendim këshilli mbarimin përpara afatit të mandatit të këshilltarit të z. Bajazit Thaçi. Miratohet.

- *Miratohet me 14- vota pro, Propozimi i Komisionit të Mandateve për deklarimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të këshllitarit z. Bajazit Thaçi.*

Vendim nr.31. Miratohet me 14 vota pro, propozimi i komisionit të mandateve "Për deklarimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të këshilltarit z. Bajazit Thaçi".

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën pesë të rendit të ditës. Shqyrtimi i paketës fiskale 2024. Fjala për drejtorin e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik z. Orges Tosku dhe si drejtorët e tjerë të jenë të gatshëm për plotësime sipas sektorit që mbulon secili. Z. Orges përshëndetje, fjala për ju.

Orges Tosku . Atëherë përshëndetje të gjithëve! Paketa fiskale normalisht hartohety në bazë të ligjeve në fuqi që miratohen nga qeveria qëndrore dhe është në bashkëpunim me të gjithë drejtoritë e bashkisë Rrogozhinë, secila drejtori për ato tarifa për ato shërbime që ka. Taksa e

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

ndërtesës taksa e tokës bujqësore, ndikimit në infrastrukturë dhe taksat që mblidhen nga agjentët tatimorë janë të përcaktuar nga këto ligje që miraton qeveria qëndrore. Edhe kategoritë që mund të përjashtohen nga një lloj takse siç janë pensionistët që përjashtohen nga taksa e ndërtesës janë të përcaktuara. Ne mund të vendosim për disa lehtësira si për tokën bujqëesore dhe për taksën e ndërtesës gjë që e kemi aplikuar tek të gjithë njësitë administrative. Gjithashtu ne përcaktojmë nivelin e tarifave si për biznesin ashtu edhe për familjarët, paketa fiskale ka ecur po në gjurmët e paketave fiskale të viteve më parë duke ruajtur një politikë fiskale sa më të saktë në vitet më përpara. Disa ndryshime që ne kemi parashikuar, janë shtuar disa kategori specifike dhe më identifikuese për efekt tarifash, disa lloje biznesesh. Tarifa pastrami për bar kafe kemi menduar nga 10 mijë lekë të vjetra në 15 mijë lekë, fast food, piceri, bar bufe nga 15 mijë lekë ta çojmë në 20 mijë lekë. Disa tarifa nga drejtoria e politikave urbane dhe tarifa e vaditjes me rrjedhje mekanike nga 2 miojë lekë që ka qenë vjet e kemi parashikuar ta çojmë në 1 mijë lekë.

Enver Memolla . Propozim?

Orges Tosku . Propozim.

Enver Memolla . Është propozim i komisionit të ekonomisë kështu që nuk mund ta shprehësh atë pjesë, po nuk u mor vendimi këtu, duhet t'i përmbahesh çfarë ke tek relacioni.

Mitat Daja . Ne patëm faktikisht në orën 11 ishte dëgjesa publike që këshilli bashkiak duhet ta organizojë dhe...

Enver Memolla . Jo nuk e organizon këshilli bashkiak, dëgjesa publike është e bashkisë Rrogozhinë.

Mitat Daja . Më ler të mbaroj pastaj... ju po prisni "vdekjen e mbretit"... ju keni qenë në kafe duke pritur "vdekjen e mbretit". Kishim dëgjesë publike që e organizon këshilli bashkiak, dhe për fat të keq shumica e këshillit bashkiak nuk mori pjesë se nuk ishin të interesuar për paketën fiskale. Keni kohë të flisni që të gjithë do jua japë kohën kryetarja... Ato që morën pjesë diskutuan ato që kishin me diskutuar , kalimi i paketës fiskale sot ose diskutimi është i pamundur realisht sepse këtu flitet për taksat që do vendosen që do paguajnë njerëzit dhe një paketë fiskale e pakonsultuar me njerëzit nuk mund të jetë paketë e rregullt. Kështu që për ti dhënë dhe hapësirën e duhur të gjithëve dhe ato që harruan me ardhur sot se ishin duke pritur atë që thashë pak më përpara, mendoj që të lejmë një ditë tjetër, ku secili prej anëtarëve të këshillit sepse është detyrim ligjor në qoftë se nuk e dinë anëtarët e këshillit të marrin përfaqësuesit e tyre që i kanë votuar në paketën fiskale. Ndoshta mund të ketë dhe gjëra që janë të padrejta dhe mund të kenë

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

kërkesat e tyre që janë...Prandaj unë propozoj që paketa fiskale që është sot ne e shikojmë dhe e dëgjojmë drejtorin sepse ka ardhur këtu për të na folur por se nuk mund ta kalojmë dot sot pa e konsultuar njëherë me përfaqësuesit tanë që kemi, të flasin dhe ata fjalën e tyre se fundja dhe ne jemi përfaqësues të atyre dhe ata kanë të drejtën e tyre që të flasin. Dhe detyrimi ligjor është që ata të dëgjohen derisa thotë dëgjesë publike është detyrim ligjor. Unë mendoj të lejmë një takim tjetër një dëgjesë publike më të zgjeruar, secili prej nesh të ftojë bizneset të ftojë njerëzit e vet që i ka për hallet e problemet e tyre që i kanë se ka shumë , i kemi të gjithë ne përfdaësuesit tanë dhe ta organizojmë një ditë tjetër. Mos vonohet shumë mendoj që propozim ose e vendosim të gjthë se unë një person jam, të Mërkurën tjetër që të mos zgjatemi shumë të bëhet një dëgjesë publike tjetër në një vend tjetër ku ne...

Indrit Dedej . Datën nuk e përcakton ti, e përcaktojmë ne kryetarët...

Mitat Daja . Thashë propozim... Pra të bëhet një gjë e tillë sepse ne...

Orges Tosku . Sot është për diskutim, ju në qoftë se keni propozime...

Mitat Daja . Ne diskutimin e kemi këtu por ti nuk më ke sjellë mua ... ke bashkëngjitur një raport ti ... unë do dëgjoj atë që do më thonë njerëzit mua dhe do sjell propozimin...

Orges Tosku . Por duhet ta kishe sjellë sot ...

Mitat Daja . Por jo se nuk e dija që duhet ta bëja unë mendoja që duhet ta bësh ti...

Orges Tosku . Unë them që për mua është kjo e drejtë...

Mitat Daja . Nuk është fare e drejtë se ti nuk më ke sjellë as ndryshime ... Ke pasur mbledhje komisioni dje ti?

Orges Tosku . Po.

Mitat Daja . Ku e ke ndryshimin që ke bërë tek mbledhja e komisionit taksat e komisionit nuk ma ke sjellë ndryshimin ku është?!

Mukades Gixhari . Po, z. Enver.

Enver Memolla . Për transparencë, duhet të dimë diçka zonja kryetare thjeshtë po ta bëj dhe

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

pyetje të drejtpërdrejtë. Dëgjesën publike e ka organizuar Këshilli Bashkiak?

Mukades Gixhari . E ka thirrur Këshilli Bashkiak dhe është postuar dy herë tek faqja e këshillit.

-Mbledhjes i bashkohet zëvendëskryetari i këshillit z. Erind Tosku në minutën e 17 të zhvillimit të mbledhjes.

Enver Memolla . Unë nuk e di kështu se nuk kam njoftim zyrtar. Unë kryetari i grupit nuk e di. Di që Bashkia ka bërë thirrjen në faqen e saj zyrtare në mos gaboj për këtë datë por jo këshilli bashkiak. Nuk është këshilli bashkiak që bën dëgjesa publike është bashkia Rrogozhinë. Këshilli Bashkiak mund të jetë i ftuar mund të vijë dhe si qytetar por jo të bëjë këshilli bashkiak dëgjesë publike. Unë skam bërë propozim nuk e di asnjë nga grupi ska bërë propozim për këtë pjesë dhe diçka tjetër në bisedat që kemi pasur bashkë të kam thënë që është jo e drejtë të bëhet mbledhja brenda ditës që është edhe dëgjesa sepse unë dua të shoh këtu cila është ajo gjë që është diskutuar në dëgjesë publike.

-Mbledhjes i bashkohet zëvendëskryetari i këshillit z. Hekuran Xhani në minutën e 19 të zhvillimit të mbledhjes.

Mukades Gixhari . Është shqyrtim.

Enver Memolla . Patjetër është shqyrtim por në shqyrtim zotëria duhet të vinte dhe me pjesën çfarë ka thënë publiku, se prandaj është dëgjesë publike të dëgjohet publiku dhe nuk e di kush ka qenë grupi i interesit nga biznesi i madh kush ka qenë, nga biznesi i vogël nga qytetarët kush ka qenë?! Se kjo është gjithë transparenca që të vi atje që e ka bërë këshilli bashkiak kjo është e palejueshme. Unë dhe Indriti nuk kemi informacion që këtë e bën këshilli bashkiak.

Mitat Daja . Atëhrë sekretari i këshilli bashkiak tha që është detyrim ligjor që këshilli bashkiak ta organizojë dëgjesën publike në mbledhjen që patëm. Konsultohuni me sekretarin e këshillit bashkiak dhe vendosni... mendoj unë e thashë propozimin tim.

Ervis Shera . Atëherë njoftimi është bërë tek faqja zyrtare e këshillit bashkiak që me datë 16 Tetor detyrimi që ka këshilli, ka bërë njoftimin tek stenda e bashkisë është bërë njoftimi gjithashtu , ju si këshilltarë se ju thatë në dëgjesën publike që kishit takuar ...

Indrit Dedej . Me kë u konsultove ti sekretar që more vendim ti je për të mbajtur procesverbal nuk je për të marrë vendime.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Ervis Shera . Jam konsultuar unë se ne kemi ...

Indrit Dedej . Nuk je konsultuar as me mua si kryetar grupi, as me Verin as me kryetarin e bashkisë jo.

Ervis Shera . Ne kemi një program pune që e kemi miratuar në fund viti miratojmë paketën fiskale dhe buxhetin dhe që nga data 16 deri në datën sa jemi sot, ju në qoftë se do donit më herët apo më vonë kishit të gjithë kohën e duhur që të thonit ...

Indrit Dedej . Ju thatë që e ka mbledh këshilli.

Ervis Shera . Ju po përpiqeni që të ja veni fajin organizatorit tani kjo është gjëja ai që e ka organizuar e ka organizuar keq...

Mitat Daja . Nuk ka lidhje me gjetur fajtorin lidhje ka që të bëhet një gjë e mirë.

Ervis Shera . Po pra, ju thatë që ju kanë votuar 700 qytetarë, kam takuar biznese ...Po pse nuk i thatë hajdeni sot në orën 11 kemi dëgjesë . Si përfaqësues i qytetarit kjo është detyra jote.

Indrit Dedej . Nuk është kryetar bashkie ai se nuk ka asgjë në dorë.

Ervis Shera . Kryetari i Bashkisë dhe administrata e bashkisë mund të organizpojë dëgjesa për hesapin e vet sa të dojë.

Indrit Dedej . Nga përvoja ime edhe në Durrës është bërë se unë jetoj në Durrës është bërë dëgjesë publike. Kryetari i Bashkisë ka shkuar lagje më lagje edhe me urdhër...

Ervis Shera . Kryetari i Bashkisë, jo këshilli?

Indrit Dedej . Nuk ka gjë këshilli në dorë, ankesat që kam unë i parashtroj këtu.

Ervis Shera . Ne kemi njoftuar zyrtarisht, të gjithë ne duhej të njoftonim njëri tjetrin dhe të mos vinim ...

Indrit Dedej . Sekretar ne përfaqësojmë një komunitet...

Ervis Shera . Zotëria tha unë përfaqësoj 700 qytetarë, të sillte 50.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Indrit Dedej . Ai sjell ankesat nuk mund të shkojë një votues i tij të shkojë të takojë një x person ...

Ervis Shera . Dëgjo kjo ishte më mirë kështu sepse në qoftë se do i sillte administrata nëse do i sillte Kryetari ju do thonit pse i ka sjellë kryetari këto qytetarë... sillni ju qytetarë .

Indrit Dedej . Ne nuk kemi nevojë fare për dëgjesë publike se ne nuk jemi në ekzekutiv që kemi një punë në dorë që mund të mbarojmë ...

Ervis Shera . Kemi thirrur administratën kemi thirrur drejtorat për këtë punë...

Indrit Dedej . Unë kam shkuar kam pasur ankesë nga qytetari kam shkuar dhe nuk kam gjetur zgjidhje kam shkuar vetë në bashki edhe nuk kam gjetur zgjidhje për një kanal.

Ervis Shera . Në rregull t'i shqyrtojmë tek dëgjesa të gjitha.

Enver Memolla . Për mua është diskutim mes Bashkisë dhe publikut jo midis Këshillit ... këshilli është vendimmarrës.

Indrit Dedej . Unë kam të drejtë të ngre një komision si këshill edhe i mbaroj punë qytetarit që nuk e pyes fare atë. Qytetari nuk gjen zgjidhje dhe dëgjesën publike duhet ta bëni ju se ju jeni në shërbim të qytetarit, performanca juaj duhet të tregojë që bashkia po funksionon.

Ervis Shera . Duhet ta bëjë administrata dhe mos thërrasë këshillin fare?

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë pak drejtorin e financës z. Rezart Vogli.

Indrit Dedej . Të mblidheshin kryetarët e grupeve bashkë me kryetarin bashkë me kryetarin e bashkisë , kolegji i kryetarëve që nuk është mbledhur asnjëherë është e detyrueshme të mblidhet apo jo? Edhe ne vendosim ecurinë e vazhdimësisë të bashkisë, apo nuk është kështu? Thuaj njëherë ti sekretar ke mbajtur protokoll se u mbledh kolegji i kryetarëve? Atëherë me çfarë urdhri e more ti, ne nuk u mblodhëm këtë mbledhje do e bëjë këshilli, se do e bëjmë ne?

Ervis Shera . Kemi miratuar një kalendar që në fillim viti... që në fund vitit që shkoi dhe ju është përcjellëdhe ju të gjithëve me email.

Enver Memolla . Kryetare tani paketën fiskale e harton bashkia Rrogozhinë apo Këshilli Bashkiak?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Orges Tosku . Bashkia.

Enver Memolla . Se nuk po merremi vesh se në bazë të dëgjesave publike do miratohet pjesa e ndryshimeve. Këto vijnë nga populli këto vijnë nga pjesa e komisionit të ekonomisë që kemi kërkuar dhe ne tre ndryshimet tona për pjesën që duam të bëjmë. Por ama të thërrasë këshilli bashkiak nuk ka të drejtë nuk ka ndodhur ndonjëherë këshilli bashkiak... Këshilli bashkiak është përfaqësues dhe unë vi si përfaqësues si popull për të dëgjuar.

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë pak Rezartin ka qenë në një trajnim dje.

Rezart Vogli . E citova dhe pak më parë në takimin e orës 11:00 të dëgjesës publike. Ne dje ishim të ftuar nga ana e Prefektit të qarkut Tiranë përfaqësues ishin: Kryetarja e Këshillit, Sekretari i Këshillit drejtori i financave. Drejtori i taksave dhe drejtori juridik. Jo më kot ishin këto drejtori të ftuara atje se jemi drejtori që kemi më shumë projektvendime dhe kalojmë më shumë shkresa në këshill bashkiak. Takimi kishte të bënte me ligjshmërinë dhe me detyrat që ka këshilli bashkiak dhe administrata e bashkisë Rrogozhinë. Ndër të tjera u citua dëgjesat publike thirren nga anëtarët e këshillit bashkiak, administrate ftohet nga këshilli bashkiak të japë informacion dhe të informojë publikun për paketën fiskale dhe për buxhetin afatmesëm. Në këtë mbledhje që u zhvillua dje ishin të ftuar edhe përfaqësues të projektit Bashki të Forta dmth është projekti që është organizator i funksionimit të mirë të këshillit bashkiak ju keni pasur dhe një trajnim nga ana e tyre mesa di unë para pak kohësh për detyrat dhe funksionet e këshillit bashkiak dhe Prefekti i Qarkut jo më kot e organizoi takimin. Është detyrë e këshillit bashkiak të thërrasë dëgjesën publike, është detyrë e administratës së bashkisë Rrogozhinë të raportojë për çdo lek të fondeve publike.

Erind Tosku . Të bëj një pyetje Rez? Pse çuditërisht sot paska ardhur gjithë kjo administratë qenka mbushur kaq shumë plot këshilli bashkiak?! Sa herë i kemi thirrur drejtorat dhe nuk na kanë ardhur, çfarë ndryshoi sot pse qenka dëgjesë publike kanë ardhur sot? Ne kemi kërkuar për të dhënë shpjegime shumë drejtora këtu dhe nuk na kanë ardhur.

Enver Memolla . Kryetare me leje? Në emër të grupit të PS kërkoj që seanca të ndërpritet për 10 minuta nuk e di nëse kolegu është dakord, të bëhet mbledhja e kolegjit të kryetarëve.

Indrit Dedej . Dakord.

-Mbledhja ndërpritet për 10 minuta. Pas pushimit mbledhja rifillon me fjalën e Kryetares si më poshtë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Mukades Gixhari . Atëherë vazhdojmë po me pikën 5, për shqyrtimin e paketës fiskale. Ndonjë pyetje për drejtorin?

Alime Hoxha . Përshëndetje ! Atëherë dje nga mbledhja e komisionit të ekonomisë pasi dëgjuam drejtorin e taksave, të financës dhe drejtorin e urbanistikës që ishin të pranishëm në mbledhjen e këshillit. Konstatuam që tarifat siç na u tha edhe nga drejtuesi nuk kanë ndryshuar në përgjithësi. Të gjithë tarifat që ka për detyrim të vendosen nga këshilli bashkiak janë të pandryshuara nga viti paraardhës përveç këtyre tarifave që ishin shtuar tek pjesa e urbanistikës tani ky është një detyrim sipas drejtorit të urbanistikës na u tha që duhet të vendosim disa tarifa për hapjen e dosjeve për marrjen e dokumentave kjo mbetet për t'u diskutuar. Dhe bëmë dy propozime për një taksë që është një taksë prej 300 lekësh tarifë 3 mijë lekë të vjetra për zonat rurale për njësitë administrative në të cilën sipas drejtorit të taksave përfshin të gjitha shërbimet. Pra në qoftë se një qytetar do vijë të marrë shërbime në bashkinë e Rrogozhinës nuk i paguan kur i merr por në total për një vit paguan një tarifë prej 300 lekësh apo 3 mijë lekësh të vjetra në vit. Dhe tjetër propozim që bëmë ishte për ujitjen me rrjedhje mekanike që ishte 2 mijë lekë për hektar, po flasim me të reja 2 mijë lekë të reja për hektar dhe 2 mijë lekë të vjetra për dynym me rrjedhje mekanike. Meqenëse për rrjedhjen e lirë kjo tarifë është 3 mijë lekë duke llogaritur edhe koston që ka fermeri me naftën që të vendosi pompë për rrjedhjen mekanike të ketë pompë që punon me naftë menduam që kjo tarifë të ulet në 1 mijë lekë të vjetra. Këto ishin propozimet e komisionit të ekonomisë.

Fatmira Thartori . Unë doja të bëja një pyetje. Atëherë nga komisioni dëgjuam që ka rritje të taksës së banesës…

Orges Tosku . Janë disa tarifa nga drejtoria e urbanistikës për hapje dosje, nëse ti do të bësh restaurime tek shtëpia pllaka bojë…

Fatmira Thartori . Pse janë këto shtesa dhe nuk mund të jemi tek ajo pjesa që nuk mund të jenë shtesa apo pluse sepse bëhet fjalë për qytetarët e zonës tonë që nuk janë shumë të pasur, janë dhe zonë rurale nuk mund të themi që janë zonë urbane.

Amarildo Duka . Janë vënë tarifa për nenin 6?

Orges Tosku . Për deklaratë paraprake.

Fatmira Thartori . Ne duhet të jemi të gjithë koshientë si këshill bashkiak që nuk duhet të ngrihen këto tarifa.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Orges Tosku . Nga 4 mijë lekë të vjetra (në fakt është të reja) shkon 5 mijë lekë se normalisht derisa krijon mbetje.

Fatmira Thartori . Prap është… ne duhet të jemi tek kjo pjesa…

Erind Tosku . Po taksa për hapësirën që zejnë bizneset, hapësira publike.

Orges Tosku . Po është 60 lekë në muaj.

Erind Tosku . Nuk ka abuzime?

Orges Tosku . Ato që kanë paguajnë.

Indrit Dedej . Për të bërë një restaurim brenda shtëpisë duhet të paguaj taksë personi?

Orges Tosku . Duhet të paguajë tarifë 5 mijë lekë të reja.

Indrit Dedej . Durrësi nuk e ka.

Amarildo Duka . Jo nuk ekziston kjo për restaurime brenda shtëpisë.

Indrit Dedej . Të bësh një dritare duhet të paguash një tarifë që të bësh një dritare?

Enver Memolla . Për restaurime është shprehur dje, për riparim restaurim dritare dyer për hapje dosje.

Fatmira Thartori . Po mirë se janë po pse duhet t'i ngrejmë?

Geraldo Gjini . Disa Bashki e kanë disa jo, ne e kemi pasur 4 mijë lekë të vjetra duke qenë se këtu në Rrogozhinë pjesa më e madhe nuk kanë dokumentacion i bie që të mos e bëjnë fare shtëpinë. Ne kemi proceudar me këto, do bëjë suvatime tek shtëpia, kapotë apo një gjë kemi marrë vërtetim nga njësitë që është banor apo posedon një shtëpi se si rregull duhet të ketë një dokument pronësie që ti të kryesh punime në shtëpi, që ta bëjmë çdo gjë të rregullt sipas ligjit.

Amarildo Duka . Është për nenin 6?

Geraldo Gjini . Për 6-ën.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Amarildo Duka . Për 6-ën është thjeshtë njoftim nuk ka nevojë për…

Geraldo Gjini . Tirana nuk e ka.

Silvana Aliu . Nuk e ka Tirana që është, imagjino…

Orges Tosku . Këto grumbullime do pastrohen, ky grumbullimi ka kosto…çohen tek vend depozitimi dhe paguhen atje me kilogram me ton, këtë e paguan Bashkia.

Indrit Dedej . Ç'punë ka qytetari të paguajë lejen që do mari leje për një dritare.

Orges Tosku . Është gjë tjetër kjo.

Erind Tosku . Mos bëni ndonjë lapsus.

Orges Tosku . Nuk është lapsus kjo është tarifë, bashkia ka të drejtë të vendosi çdo lloj tarife. Tirana ka tarifë për të mbajtur dyqanin 24 orë hapur për shembull, se atë lloj jete biznesi ka, ne nuk kemi. Nuk është tarifë është ligj.

Indrit Dedej . Të mbash dyqanin si thotë ky do licensë më vete, që të marrësh për punime të brendshme unë kam bërë se kam pagur.

Orges Tosku . Nuk është e thënë edhe Durrësi tarifën e pastrimit për familjarë e ka 40 mijë lekë, ne e kemi 20 mijë lekë. Ta bëjmë sa Durrësi?

Indrit Dedej . Se di atë.

Silvana Aliu . Nivelin e jetesës si Durrësi e kemi?

Orges Tosku . Me i hyrë asaj pastaj…

Enver Memolla . Po këtu merret se merret niveli bazë për jetesë sa është kosto për jetesë…Durrësin e ke nivel tjetër Bashkie e ke nivel i tretë nuk e ke nivel i dytë e të parë. Këtu nis dhe niveli i taksimit nga qeveria qëndrore edhe pjesë e tarifave nuk mund të kemi tarifa më të larta se taksat vendosur me VKM-në e qeverisë, se niveli i bashkive është ndryshe.

Indrit Dedej . Ti mundohesh të ngresh taksat edhe biznesit të vogël ja ka ngritur taksat.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Orges Tosku . Jo nuk i ngrejmë ne taksat o Indrit, taksat vijnë nga qeveria vijnë fikse, ne ngrejmë vetëm tarifat me vendim të këshillit bashkiak ne ngrejmë vetëm tarifat.

Indrit Dedej . Nga 100 mijë lekë e ke bërë 150 mijkë lekë.

Orges Tosku . Është tarifë, jo taksë.

Indrit Dedej . Sa biznese ke, nuk po ka njerëz fare…

Andi Proshka . Indrit prandaj jemi në fazë shqyrtimi jemi në bashkëbisedim…

Indrit Dedej . E dyta ju nuk jeni të zotë të mblidhni taksat? Ju keni dal me vitet e kaluara keni dalur skëterrë 300 milion lekë pa mbledhur taksa nuk jeni të aftë t'i mblidhni.

Orges Tosku . Nuk janë falur ato një nga ato debitorë je dhe ti.

Indrit Dedej . Nuk je i aftë me i mbledhur pra.

Orges Tosku . Të gjithë procedurat janë bërë.

Indrit Dedej . Unë këtë po them pra, nuk je i aftë t'i mbledhësh.

Orges Tosku . Procedurat ligjore janë bërë, debitorë pastaj normalisht do krijohen.

Enver Memolla . Tani një pyetje retorike më fal për ndërprerjen…

Indrit Dedej . Sepse unë kur jam debitor duhet të më mbyllësh biznesin.

Orges Tosku . Nuk ekziston, ke mbyll biznesin ti kemi bërë bllokim llogarie e të gjithë masat tjera janë marrë ndaj teje.

Indrit Dedej . Tani ti mos ma lër mua biznesin nuk paguan hajt se është shoku im, mbylle.

Orges Tosku . Ne kemi disa masa dhe këto masa janë marrë për të gjithë debitorët.

Amarildo Duka . Me strukturën e re do bëhet edhe një sektor më vete sektori i borxhit që do merret vetëm me këtë pjesë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër në lidhje me këtë pjesë.

Orges Tosku . Duhet me theksuar që Bashkia Rrogozhinë ka ndër tarifat më të ulëta në rang të gjithë Bashkive tjera. Të marrësh nje Bashki në kategori me ne nuk i ka këto tarifa.

Amarildo Duka . Meqenëse kemi bregdetin ta rrisim pak.

Indrit Dedej . Ta rrisim por ta përcaktojmë. Ai i Sinaballaj nuk mund të paguajë sa ai në bregdet.

Gezime Met-hasani . Për tarifën e pastrimit ne në Sinaballaj nuk kemi asgjë çfarë do paguajmë 6 mijë lekë kur nuk ka asnjë kosh e asgjë, apo gjelbërimi, apo …

Altin Tosku . Gjelbërim ke plepa sa të duash.

Gezime Met-hasani . Nuk ke asgjë pse ta paguaj unë këtë 6 mijë, 8 mijë as ndriçim asgjë këtë kisha.

Erind Tosku . Faktikisht ajo që tha Indriti pse nuk i mblidhni ju është shumë e vështirë, normalisht është shumë e vështirë sepse do dal tek ajo që tha Gezimja në Sinaballaj i njëjti problem, Gosa e vogël i njëjti problem fshatrat i njëjti problem. Pra unë nuk kam ndriçim … nuk po e përmend Rrogozhinën se është pak më ndryshe se sa fshatrat, rrugët nuk kanë as mirëmbajtje e asgjë plehrat hidhen rrugës. Tani hajde se po vazhdojmë po i paguajmë taksat por nuk kam parë gjë asnjë ndryshim asnjë masë…

Andi Proshka . Tani shërbimi zero nuk është…

Erind Tosku . Zero është sepse nuk ka kosh, ai nuk ka ndriçim.

Silvana Aliu . Nëse një lagje e Rrogozhinës nuk arrin të pastrohet shërbimi është zero mos prit për fshatrat.

Andi Proshka . Kush lagje nuk është pastruar?

Silvana Aliu . Ke rreth stadiumit e ke skandal…

Andi Proshka . Tek rruga po që është e pashtruar por jo se ka mbeturina. Tek stadiumi janë dy kosha.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Silvana Aliu . Mbaron ndeshja edhe rruga e stadiumit është me mbeturina, fusha përballë pallatit tek lagja ku jemi ne sikur të fusin ato gratë edhe po ti thuash a mund ta pastrosh?-Nuk më kanë dhënë urdhër. Shërbimi është zero nëse për ju funksionon që pastrimi do jetë vetëm rrugët kryesore…

Indrit Dedej . Ndoshta nuk je në dijeni ti si titullar.

Andi Proshka . Edhe ju nëse keni të tilla probleme vini dhe i trajtoni.

Erind Tosku . Jemi të gjithë në Rrogozhinë kalojmë pesë herë tek e njëjta rrugë, po të njëjtat problematika i shohin të gjithë.

Andi Proshka . Tani nuk besoj që Rrogozhina është një nga këto.

Erind Tosku . U kapa tek fjala që the po të vini ju e të na thoni, dakord ju e shikoni dhe vet se kaloni përditë nuk merni dot punonjësin tuaj që e keni vartës shiko se filan vend është problematika se keni bërë …

Andi Proshka . E kemi bërë …

Erind Tosku . Në rregull kërkoj ndjesë unë, se kam parë.

Silvana Aliu . Dmth ti quan pastrim kur vjen makina vetëm në darkë mërr vetëm ato, dhe ajo quhet pastrim?

Andi Proshka . Jo, edhe punonjësit e shërbimeve janë gjithmonë të …

Silvana Aliu . Absolutisht nuk i kam parë ndonjëherë në rrugë, megjithatë…

Indrit Dedej . Po sikur të bëjmë një amnisti, sikur ulni 10% të tatimeve të prapambetura …

Amarildo Duka . Duhet parë dhe baza ligjore funksionon apo jo.

Orges Tosku . Të bëjë një aktmarrëveshje t'i paguajë avash avash.

Enver Memolla . Këtë që kam propozuar unë që kam thënë siç e ka koorporata e OSHE-së që paguan muajin e radhës paguan dhe një përqindje… edhe ul borxhin edhe paguan vitin aktual.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Indrit Dedej . Baza ligjore është se unë e kam dëgjuar nga dikush.

Orges Tosku . Pastaj i bie që ai që ka paguar pastaj ta subvencionosh, se çfarë kuptimi ka?! Po rri dhe unë 5 vjet dhe hajt se po më falen…

Indrit Dedej . Më mirë të mbledhësh se sa mos të mbledhësh fare.

Mitat Daja . Borxhi është borxh do paguhet.

Orges Tosku . Unë i kam paguar çfarë do bësh do më subvencionosh? Nuk bëjmë dot amnisti.

Enver Memolla . Unë para sa kohësh kam bërë një propozim, jo për të ulur borxhin por për të ja marrë në mënyrë tjetër paguaj një vit të prapambetur dhe vitin aktual, vetëm kështu mund ta zgjidhësh borxhin pa e shtuar.

Orges Tosku . Bëjmë marrëveshje me këste. Që të falim ne nuk kemi tagër ligjor që të faliom detyrimet e prapambetura për aktmarrëveshje jemi të hapur si me bizneset edhe me familjarët edhe është proceduar.

Indrit Dedej . Ai që ka taksa toke psh ka vite që nuk ka paguar…

Altin Tosku . Nuk i paguan se nuk ka kanalizim çfarë do paguajë ai?!

Amarildo Duka . Faktikisht është një ligj që kur kalon afati dy vjeçar për mbledhjen e taksave mund të bëjë kërkesë për heqjen e gjobave kamatvonesave…

Orges Tosku . Duhet me e parë mirë të rrijmë të gjithë nga dy vjet vitin e tretë na e fal këshilli. Është në Itali ka taksën e ndërtesës kthehet pas tre vjetësh të ja fshijmë ne? Hajde se po rrijmë të gjithë këtu mos paguajmë asgjë dhe vitin e tretë me vendim këshilli.

Indrit Dedej . Nuk ka shans edhe në Hënë të shkojë ai pa ardhur me marrë një shkresë në bashki.

Altin Mema . Po duhet me gjetur bazën ligjore Indrit.

Amarildo Duka . Po presim të bëjmë një kontratë me ujësjellësin që taksat e ndërtesave tokave bujqësore t'i marrim nga ujësjellësi.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Indrit Dedej . Kushdo të jetë jashtë pa një hall në bashki nuk ka shans edhe pas 15 vitesh t'i paguajë të gjithë detyrimet.

Alime Hoxha . Meqenëse jemi këtu ne e propozojmë njëherë për këtë taksën 3 mijë lekë e heqim për të gjithë kategoritë nëpër fshatra nëpër zonat rurale dhe të rishikohet për taksën e gjelbërimit dhe pastrimit. Megjithatë edhe në qoftë se ajo tarifë nuk do hiqet nuk kanë pastrim nuk kanë gjelbërim, të paktën dy punëtorë me pastruar ato rrugët a mund të gjenden? Se andej janë rrugët që i kanë mbushur ferrat.

Orges Tosku . Kur është mundësia kanë shkuar.

Alime Hoxha . Tani më fal ju e sillni këtë tarifë për pastrimin nuk e ofroni këtë shërbim pastrimin, e mblidhni për ndriçimin nuk ja ofroni, të paktën mbuloni këtë shërbimin tjetër dhe mbulojmë mënyrën se si po e merr këtë taksë.

Orges Tosku . Në dijeninë time ka punëtorë sezonalë që shkojnë në zonar ku është nevoja.

Alime Hoxha . Ju e dini teorikisht por praktikisht sa është bërë sepse ne i kemi parë që të gjitha rrugët dhe ajo që është më kryesore rrugët që të çojnë në bregdet në kohën e sezonit i kanë mbuluar ferrat unë e kam ngritur dhe herë tjetër këtë çështje.

Olsi Dranga . Nuk është e vërtetë.

Alime Hoxha . Tani ne kemi kaluar aty i kemi parë.

Olsi Dranga . Për të dyja rrugët e bregdetit edhe të Vilë Bashtovës edhe të Spillesë është kompani e kontraktuar nga ARSH -ja e cila kryen shërbimin e mirëmbajtjes në ato rrugë.

Erind Tosku . Pastrimin apo mirëmbajtjen?

Olsi Dranga . Pastrimin e bëjmë ne.

Erind Tosku . Vetëm për pastrimin po thonte zysha.

Olsi Dranga . Edhe pastrimin e ka ARRSH-ja. Mos e ngatërrojmë sherbim pastrimin e bëjmë ne.

Fatmira Thartori . Ju që keni ardhur këtu drejtora, a mbani shënime për këto që po thotë

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

kryetarja e komisionit të ekonomisë? Pra propozimet që po jep ajo ju duhet t'i mbani shënim këto që radhën tjetër kur ju të na sillni paketën fiskale që ne ta miratojmë të jenë në rregull këto konform të gjitha gjërave që thotë zonja.

Alime Hoxha . Edhe një propozim tjetër ne propozojmë që edhe ajo tarifa …

Mitat Daja . Zonja kryetare do i japim drejtim apo do e bëjmë… sepse vazhdoi si muhabet kafeje.

Silvana Aliu . Punonjësit e administratës ta heqin këtë që punëtori shkon kur ka mundësi e detyron ti…

Orges Tosku . Kur është nevoja…

Silvana Aliu . Si kur është nevoja pastrimi rrugët të paktën dy herë në javë.

Andi Proshka . Ato janë gjithmonë në shërbim të qytetit por sipas nevojave më emergjente futen nëpër zona të caktuara jo se… janë gjithmonë në shërbim.

Indrit Dedej . T'i bëj një pyetje këtij drejtorit të shërbimeve, më trego një foto që ke dalë me punëtorët e tu.

Olsi Dranga . Mos u shqetëso, duke pastruar letra … po.

Silvana Aliu . Jo atë që ke bërë në Spille që ke qenë me fushatë…

Olsi Dranga . Të lutem do foton, t'i tregoj foton…

Mitat Daja . Tani po diskutojmë paketën fiskale apo po diskutojmë ato problemet… letrat që mbledh administrata, u bë muhabet kafeje po na ofendoni ne të tjerëve që rrijmë këtu.

Altin Tosku . Nuk jam dakord me rritjen e tarifës së tabelës ose të ngrihen të gjitha ose nuk më duket e arsyeshme.

Orges Tosku . Taksa e tabelës vjen e përcaktuar nuk është se e vendosim ne.

Altin Tosku . Ajo që ngrihej 50 mijë lekë çfarë ishte ajo?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Orges Tosku . Tarifë pastrimi … kështu e kemi menduar ne.

Altin Tosku . Arsyeja psh pse e keni menduar kështu, jepni shpjegime?

Orges Tosku . Duke qenë se janë edhe biznese, që kanë mbetje më shumë se tjerat…

Altin Tosku . Kush ka më shumë se tjerat?

Orges Tosku . Baret, kafetë.

Altin Tosku . Çfarë kanë baret vetëm kafe kanë, kanë kanaçe ato i marrin … Çfarë kanë baret?! Po e bëni sikur kanë baret kanë mbeturina plehra…

Orges Tosku . Ne kështu e kemi menduar…

Altin Tosku . E mendoni ju por nuk është ashtu ose t'i ngrehen të gjithëve, unë nuk jam dakord me këtë.

Orges Tosku . Këto e kanë pasur më të ultën janë barazuar me tjerët.

Altin Tosku . E bëni sa të doni unë po flas në mënyrë të përgjithshme nuk është e thënë vetëm për këtë pjesë.

Enver Memolla . Në vazhdën e asaj që tha dhe kolegu tjetër një pyetje kam se po thoni që mund të ketë më shumë mbetje. Pyetja që lind është në moment që ka më shumë mbetje pastrimi bëhet njëherë në ditë tani do bëhet dy herë apo tre herë në ditë apo do vazhdojë po i njëjti ritëm?

Orges Tosku . Se di, unë e di që shërbimi është bërë.

Enver Memolla . Atëherë i bie që shërbimi është bërë dhe tarifa nuk duhet të rritet. Në qoftë se është kjo është bërë nga dje ose nga sot e tutje me kaq tarifë pse mos bëhet edhe më mbrapa po me këtë tarifë që ka qenë?

Orges Tosku . Këto lloj biznesesh janë barazuar dhe me tjerët se ka qenë ndër më të ulëtat 100 mijë lekë në vit bar kafeja.

Altin Tosku . Atëherë kjo është arsyeja që do i barazojmë me të tjerat jo t'i rritet këtyre.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Erind Tosku . Çfarë studimi keni bërë ju si Bashki nuk po them vetëem ju si drejtori, që ky zëri nga studimi që keni bërë ju paska dalë Rrogozhina me shumë mbetje e të gjithë gjërat tjera që duhet të rritet ky fond kjo taksë dmth që ne ta menaxhojmë situatën që na ka dalë jashtë kontrollit.

Orges Tosku . Duke qenë se bizneset e kanë pasur tarifën nga më të ulëtat janë barazuar edhe me tjerët.

Altin Tosku . Atëherë kjo mund të jetë nga arsyet më të rregullta, janë barazuar me tjerat.

Erind Tosku . Kur është mundësia për të rritur hajde se po e rrisim por si nuk ka një arsye se nuk po dëgjoj një arsye që të jem i bindur… po bëjnë bizneset më shumë po kush biznese? Çfarë mbetjesh po bëjnë, a nuk kemi mjet që t'i marrim këto mbetje, hajde ta rrisim gjejmë mjetin por nuk po e kuptojmë çfarë, pse.

Enver Memolla . Prandaj unë po them nuk ka arritur me këtë shërbim të pastrohet e gjithë, ka ngelur aty sepse makina me kaq volum nuk vjen dot dy herë ? Arsyetimi vjen në bazë të fakteve.

Orges Tosku . Ka qenë lloji i bizneseve më të ulëta.

Enver Memolla . Atëherë ky është ndryshim relacioni sepse ndryshe kur thua do e barazoj me pjesën tjetër do e bëj standard siç ishte dhe unifikimi i ujit para dy muajsh, ndryshe kur thua ka më shumë mbetje duhen më shumë lekë për të pastruar.

Orges Tosku . Edhe pjesa e mbetjeve dihet…

Amarildo Duka . Duke qenë se u bë dhe rruga e re e Spillesë psh, parashikohet që numri i turistëve të rritet, baret dhe restorantet që janë në atë zonë…

Altin Tosku . Atëherë është për pjesën atje jo për pjesën këtu.

Enver Memolla . Atëherë specifikoje është për të gjithë zonën?

Amarildo Duka . Shumica e bizneseve në atë zonë janë.

Enver Memolla . Ndryshe ai që ka restorant atje.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Amarildo Duka . Duke qenë se atje ka mbetje peshku duhet pastruar më shpesh.

Enver Memolla . Dakord jam për pjesën e bregdetit nuk jam kundër por tek relacioni po biem në kontradiktë me drejtorin se ndryshe kur rritet tonazhi për të bërë pastrimin dhe për ta çuar në incinerator dhe ndryshe kur thuhet dua ta barazoj është tjetër gjë.

Orges Tosku . 5 mijë lekë të reja në vit është. Është për të gjithë bashkinë nuk është vetëm për pjesën e…

Indrit Dedej . Nuk ja vlen që ta ngresh në qoftë se e përcaktojmë pjesën e plazhit dhe turizmit po e ngrejmë për sa mban ajo lodhja që kanë për dy muaj.

Amarildo Duka . Dakord po numri i njerëzve që kalojnë për dy muaj aty është shumë më i lartë…

Altin Tosku . Do i marrësh taksë ti atij.

Enver Memolla . Rritja e taksave e përmirëson shërbimin apo jo unë këtë dua të di? Sepse në qoftë se me rritjen e taksave do vijë po një herë apo një herë në tre ditë tek lagja mbi stacionin e trenit kjo është gjë tjetër pastaj. Unë këtu e kam tarifa e përcakton shërbimin?

Mitat Daja . Nuk e përcakton shërbimin tarifa është tarifë shërbimi do ofrohet në bazë të kontratës që bën ajo…

Enver Memolla . Unë këtë po kërkoj.

Mitat Daja . Ajo është për taksat o Ver, nuk është për shërbimet, shërbimet duheët të flasësh me drejtorin e shërbimeve më vonë. Ai thotë taksën e kam parë të arsyeshme të jetë kështu, arsyetimi atij për tarifën. Nuk ta jep drejtori i taksave përgjigjen për këtë punë se po xhirojmë po në vend.

Andi Proshka . Paketa fiskale përmbush objektivat e bashkisë aty ku ka probleme do shtohet një punëtor një kosh apo për çfarë ka nevojë bashkia, këtë po thotë edhe Gesi por ju nuk po e keni të qartë.

Enver Memolla . Në përgjigjen e Gesit e kam dhe dje tek komisioni i ekonomisë e kam dhe sot që thotë dua ta barazoj me të tjerat nuk po më thotë që në bazë të taksës rritet tarifa për të kryer

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

shërbimin, për të shtuar punonjësin dhe për të mbuluar gjithë zonën.

Mitat Daja . Tarifat janë vendosur i ka menduar zotëria që të jenë të tilla, unë propozimin e bëra për të bërë një dëgjesë tjetër publike, pavarësisht se jam i vetëm dhe nuk kam mbështetje unë hedh si propozim të mendohet të arsyetohet, të shikohet dhe të jepen propozimet e duhura. Ose të bëjmë propozim për efiçensën e mbledhjes së taksave, të diskutohet dhe buxheti të bëhen të gjithë këto punë. Lejmë një ditë tjetër që paketa fiskale është mirë që të dëgjohet nga njerëzit është mirë që të ketë transparencë dhe është mirë që njerëzit të japin arsyetimet e tyre për tarifat që vendosen në bashkinë e Rrogozhinës, qoftë nga Sinaballaj, qoftë nga Kryevidhi, apo fshati më i fundit që është në Bashkinë e Rrogozhinës. Pra ideja është mos t'i bëjmë gjërat kështu rutinë thjeshtë hajde ta kalojmë apo thjeshtë hajde ta propozojmë. Mendimet tona janë të vakëta nëse ne nuk e zgjerojmë rrethin tonë të mendimit me njerëzit dhe gjykimin që kanë njerëzit. Ky është propozim unë mendoj ta hedhim në votë, e pranuat mirë po nuk e pranuat është puna juaj pastaj. Unë mendoj që ky propozim të hidhet në votë se kam të drejtën ta propozoj që të hidhet në votë që ne të bëjmë dëgjesë publike tjetër për paketën fiskale.

Indrit Dedej . Unë jam i mendimit që dëgjesën publike pak a shumë jemi dhe Live tani ne u keqkuptuam ata po na ndjekin...

Mitat Daja . Mirë ti jep mendimin tënd thuaj kundërshtoje. Zysh propozoj ta hedhim në votë edhe e kundërshtojmë nuk jemi dakord.

Indrit Dedej . Të mbaroj mendimin unë dhe e hedhim në votë, kurse për paketën kemi nevojë për më gjatë. Tani për dëgjesën publike tani populli ka dhe hallet e vitit të ri, ka problemet me festat me ullishtat.

Mukades Gixhari . Tjetër koment në lidhje me paketën?

Enver Memolla . Vetëm pikat që janë lënë të merren parasysh që të bëhen ndryshimet.

Alime Hoxha . Atëherë për paketën këto ishin, kemi diskutime tjera u mbyllën diskutimet kemi ato propozimet që kemi dhënë shpresojmë të merren parasysh propozimet që ne kemi dhënë. Megjithatë secili anëtar këshilli ka të drejtën të takojë persona qofshin biznese, qofshin persona fizikë të jua marrë mendimin dhe ti sjellë ato shqetësime që ato kanë këtu.

Mitat Daja . Edhe për ta hedhur në propozim duhet me marrë mendimet e kryetarëve. Hidhe propozimin në votim le ta kundërshtojnë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Alime Hoxha . Nuk janë dakord kryetarët.

Mitat Daja . Hidhe në votim, kundërshtojeni mbylleni.

Mukades Gixhari . Kush është dakord me propozimin e z. Mitat Daja? Për të bërë një dëgjesë tjetër publike? E hedhim në votim. Pro? Pro dhe unë jam pro dhe vota ime shkon pro. Miratohet.

Enver Memolla . Sa vota janë?

Mukades Gixhari . Edhe njëherë t'i numërojmë, si i patët ngritur. Një, dy… dhjetë.

Enver Memolla . Dhjetë?

Fatmira Thartori . Dhjetë sepse i bie që ai çuni…

Enver Memolla . Me dhjetë, me shumicë nuk kalon.

Mukades Gixhari . Duhen 50 plus 1.

Mitat Daja . Pse nuk kalon?

Enver Memolla . Duhen njëmbëdhjetë. 50 plus 1 ke rregulloren.

Indrit Dedej . Nuk ka vendim që të kalojë poshtë njëmbëdhjetë votave.

Mitat Daja . Sa veta je në këshill ti? Sa është pjesëmarrja mos u tallni me njerëzit këtu se jeni dhe live. Ver mos u tallni. Sa veta jemi ?

Mukades Gixhari . Jemi 15.

Mitat Daja . 10 janë dakord që ky propozim të kalojë dhe thoni nuk miratohet. Kjo është gallatë.

Silvana Aliu . Nuk është gallatë se ti gjërat e tjera i kalon me 11.

Mitat Daja . Sekretari i këshillit mund të na japë zgjidhje për këtë punë, na sqaro këtë punë që ta dimë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Ervis Shera . Është rasti që kalohet me shumicë të thjeshtë, kështu që miratohet.

Mukades Gixhari . Miratohet dhe me 10?

Ervis Shera . Shumicë e thjeshtë, shumica e të pranishmëve në sallë.

Mukades Gixhari . Miratohet.

-Miratohet me 10 vota pro 5 vota kundër propozimi për zhvillimin e një dëgjese publike të dytë për Paketën Fiskale dhe Buxhetin e Bashkisë për vitin 2024.

Mitat Daja . Faleminderit shumë.

Besnike Coraj . Sa më shumë të dëgjohemi aq më mirë është.

Fatmira Thartori . Nuk është puna tek anëtarët e këshillit është për qytetarët ajo.

Besnike Coraj . Për punën e Bashkisë është akoma më mirë sa më shumë të dëgjojmë ankesat që njerëzit kanë, hallet do shkojë shumë më mirë dhë më ok.

Mukades Gixhari . Atëherë kalojmë në pikën 6, Raport nga administratorët e njësive administrative Kryevidh, Lekaj, Sinaballaj. Fillojmë me administratorin e njësisë Kryevidh z. Shkelqim Gjoni. Z. Shkelqim përshëndetje!

Shkelqim Gjoni . Të nderuar këshilltarë përshëndetje! Periudha në të cilën ju kërkoni informacion përkon me sezonin turistik, ju që ta dini komuna Kryevidh është baza e turizmit për Bashkinë Rrogozhinë edhe sigurisht 60% e të ardhurave mblidhen ne Njësinë Kryevidh. Kështu që edhe puna jonë kujdesi jonë i gjithë administratës Kryevidh është përkushtuar në drejtim të mirëmbajtjes së sezonit turistik. Mbase nuk keni shumë njohuri por unë ju them me sa përvojë që kam unë në atë drejtim atje në muajin Gusht aty frekuentojnë gati 25 mijë pushues në ditë.

Mitat Daja . Se ke shkruar këtu tek raporti sa veta e frekuentojnë.

Shkelqim Gjoni . E them me gojë.

Mitat Daja . Po pse nuk e shkruani dot këtu ju, shoh dhe ato raportet tjera që kanë sjellë ato administratorët tjerë që kanë çuar është për të ja çuar emergjencave civile më shumë se sa për ta dëgjuar ne këtu.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Shkelqim Gjoni . Që në fillim ne e kemi filluar me sistemimin e punëtorëve sezonalë të cilët janë marrë me pastrimin e mbeturinave në rrugë. Në rrugë kryesore që të çon në bregdet me pastrimin e brezit të gjërë të pishave si dhe me pastrimin e plazhit publik sepse kjo është detyra jonë, është detyrë e njësisë të bëjë pastrimin e plazheve publikë të hapësirës së gjelbër se duhet ta dini që ne e kemi këtë ku hajmë aty i hedhim mbeturinat nuk e kemi akoma atë kulturë që të marrim një qese t'i çojmë tek kazani i mbeturinave. Ndërsa për dërgimin e mbeturinave, kanë punuar dy firma, firma e kontraktuar nga Bashkia dhe firma "Fusha" e kontraktuar nga qeveria. Një firmë e kryen pastrimin në mëngjes firma tjetër e kryen pastrimin në mbrëmje dhe nuk kemi pasur asnjëherë probleme dhe ankesa nga qytetarët dhe nga bizneset e zonës të paktën për këto vitet e fundit. Sepse kur koshat largohen mbeturinat në mëngjes e në mbrëmje dmth që largon dhe atë erën e keqe që mund të mbajë koshi i mbeturinave. Është për t'u festuar të paktën për njësinë Kryevidh që këtë vit që lam pas nuk patëm asnjë rast të mbytur, sigurisht që kjo është edhe shprersa nga Zoti por edhe një punë që kanë bërë rojet vrojtuese të plazheve. Sepse kanë fituar dhe ato me kalimin e viteve përvojën e nevojshme për të bërë ballë situatave emergjente. Siç jemi në dijeni në këtë periudhë kanë filluar edhe ndërtimi i rrugës Vilë Bashtovë - Guri i Lëmuar një rrugë kjo që i ka dhënë një hapësirë më të madhe biznesit por edhe i ka rritur vlerën pronave edhe banesave. Kështu që besoj që është një investim që do i ngrejë edhe më shumë të ardhurat e Bashkisë tonë për vitet në vazhdim.

Mitat Daja . Investim i Bashkisë apo i qeverisë?

Shkelqim Gjoni . Tani ky është një investim 3.5 milion euro nuk ka mundësi bashkia të investojë këtë shumë.

Amarildo Duka . Investim i qeverisë me kërkesë të bashkisë.

Mitat Daja . Pyeta dhe për publikun që ta dëgjojnë dhe ata.

Shkelqim Gjoni . Bashkia ka bërë kërkesën dhe projektin, gjithashtu një investim tjetër që mund të konsiderohet pjesë e investimit është edhe ndarja e kanalit kullues Kazie-bregdet gjithmonë në funksion të vijës bregdetare. Ndërsa ndër problematikat kryesore që ne kemi hasur në këtë periudhë janë mungesa trajtimit të ujërave të zeza. Nëse plazhi i Spillesë ka një pikë të dobët një pikë të errët, trajtimi i ujërave të zeza është pika më e dobët që ne na bën të ulim kokën. Sigurisht që ky është një investim i madh që kushton gati 12 milion euro dhe Bashkia nuk e bën për 100 mijë vjet këtë lloj investimi. Por kemi ndërhyrë bashkë me kryetarin e bashkisë meqenëse po bëhet dhe rruga e re është kërkuar një shtesë fondi që të trajtohet dhe të punohet dhe me kanalizimin e ujërave të zeza dhe të ndërtimit të trajtimit të impiantit të ujërave të zeza. Meqë po

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

bëhet investim i madh ky mbetet investim përgjysëm pa largimin e ujërave të zeza, se duhet me thënë atë që është një pjesëe ujërave të zeza derdhen në det. Problematikë tjetër që kemi hasur meqenëse na iku dhe drejtori i elektrikut është tensioni i ulët në zonën e bregdetit, aty banesat dhe pupullimi vijnë duke u shtuar, thashë që në muajin Gusht vijnë 20 mijë veta në ditë dhe normal që kërkohet një tension më i lartë. Shpresoj që të kryhet një investim për të ardhur një tension më i lartë në zonën e bregdetit.

Mitat Daja . Kjo është e domosdoshme, por çfarë hapash janë marrë për të bërë këtë punë?

Shkelqim Gjoni . Tjetër gjë që ne kemi hasur është dhe mungesa e eksavatorit me krah të gjatë për pastrimin e kanaleve kulluese që këto t'i paraprijmë mos presim që të vijë dimri dhe situata emergjente por t'i kryejmë në kohën e duhur. Po me sa jam në dijeni Këshilli Bashkiak ka miratuar blerjen e eksavatorit kështu që shpresojmë që do na ndihmoj në këtë etapë. Tjetër gjë që unë kisha në këtë periudhë është në Spille funksionon qendra shëndetësore verore por realisht aty nuk ka një autoambulancë që të rrijë gjatë gjithë ditës aty 24 orë tani këto funksionojnë me nr 127 por kur të vijë ambulanca nga Rrogozhina larg qoftë ai që mbytet është në emergjencë dhe nuk pret dot ka edhe trafik aty duhet një ambulancë. Ne si njësi kemi pasur 2-3 mjete në pronësi të komunës, tani aktualisht nuk kemi asnjë mjet autoveturë, të paktën për periudhën e plazhit sepse unë për periudhën e plazhit, punonjësi i shërbimeve dhe punonjësi i taksave, polici bashkiak por dhe unë jemi përditë në atë zonë nëse ka mundësi bashkia për një autoveturë të na e japë për ato tre muaj është e nevojshme.

Mitat Daja . Pse për tre muaj për gjithë kohën?!

Shkelqim Gjoni . Të paktën për ato tre muaj mos shpenzojmë shumë se do ngrehen dhe njësitë e tjera dhe do duan të gjithë.

Mitat Daja . Të gjitha të pajisen me mjete nëse është...

Shkelqim Gjoni . Po varet sa e ka mundësinë Bashkia, të gjithë duam gjëra por varet nga xhepi.

Amarildo Duka . Tani punonjësi i taksave është në varësi të bashkisë apo në varësi ...?

Shkelqim Gjoni . Është i joni e kemi pasur punëtor taksash.

Amarildo Duka . Nuk është i drejtorisë të ardhurave?

Shkelqim Gjoni . Është i njësisë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Indrit Dedej . Në varësi të bashkisë.

Shkelqim Gjoni . Në varësi të bashkisë jemi të gjithë.

Mitat Daja . Çim janë disa kërkesa këtu që ke bërë nuk e di tani na përkasin ne këto kërkesa psh ti ke thënë tensioni i ulët. Çfarë mund të bëjmë ne Spilleja është zonë që duhet ti japim dorë se s'bën sepse ndihmon bashkinë. Por çfarë mund të bëjmë ne për këtë sepse ky muhabet ka raportet që bëhen, disa raporte janë parë për t'u çuar tek emergjencat civile disa raporte nuk janë... Çfarë mund të bëjë këshilli bashkiak për tensionin e ulët që ti ke kërkuar këtu.

Shkelqim Gjoni . Thashë këto janë problematikat.

Mitat Daja . Problematikat por çfarë mund të bëjmë ne, si mund të të ndihmojmë ne ty?

Shkelqim Gjoni . Me anë të drejtorit që ka Rrogozhina t'i bëjmë një kërkesë Tiranës apo Durrësit.

Mitat Daja . E bën Këshilli Bashkiak Andi?

Andi Proshka . Këto janë problematika. edhe me kanalet këto janë problematika që ju të jeni në dijeni të ngrini zërinmë lart se duhet.

Mitat Daja . Po mirë a do bëjmë ndonjë relacion nga këshilli bashkiak për këto probleme?

Fatmira Thartori . A mund të bëhen projekte dhe këto projekte shkojnë diku dhe mund të bëhen pastaj në zonë sidomos në zonën bregdetare gjatë verës si në Gosë, si në zonën e Vilës Kryevdidhit të gjithë zonën bregdetare mund të bëhen këto, mund të bëhet projekt?

Andi Proshka . Prandaj ishte thirrur dhe përgjegjësi i OSHE-së për t'u njohur me këtë problematikë.

Fatmira Thartori . Përgjegjësi iku por a mund të bëhet ndonjë projekt për këto?

Amarildo Duka . Projekte bën OSHE nuk bëjmë ne.

Fatmira Thartori . Po mirë të ishte çuni këtu se ne prandaj jemi këtu.

Mukades Gixhari . Z. Enver Memolla.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Enver Memolla . Sa i përket përgjegjësve të OSHE-së ishin të tre prezentë te unë Indriti dhe kryetarja është një defekt në zonë në Lekaj që u larguan direkt për këtë punë. Tani gjëja tjetër këto janë të drejtorisë rajonale nuk i përkasin Bashkisë Rrogozhinë, varen nga drejtoria rajonale e Durrësit dhe këtu e kemi thirrur dhe herë tjetër para... dhe ka thënë që ne këtu mbajmë përgjegjësi për sa i përket shërbimit të klientit për qytetarin, pjesën e investimeve e kemi bërë kërkesën lart për 20 - in që do si Vila në Gosë dhe Lekaj por dhe zona e Kryevidhit që një pjesë e mer nga Divjaka këto janë investime që vijnë nga qeveria qëndrore nuk janë që i bën këshilli bashkiak. Këshilli Bashkiak mund të thërrasi në raport drejtorin e drejtorisë rajonale të OSHE-së Durrës mund ta thërrasi po kemi të drejtë ligjore t'i çojmë shkresë zyrtare të vijë në mbledhjen e radhës të raportojë ne këtë e kemi në dorë...

Mitat Daja . Këtë po them...

Enver Memolla . Për pjesën e investimeve ...

Fatmira Thartori . Kërkesa ne jemi zëri i qytetarëve dhe ne duhet të ja drejtojmë dikujt, kështu që ne këtë po kërkojmë bëht një projekt nga kush bëhet, të bëhet nga Bashkia apo bëhet nga OSHE-ja? Dhe ne bëjmë zgjidhjen t'i japim drejtim situatës.

Hekuran Xhani . Tek informacioni je shprehur për nevojën e një ambulance e cila lidhet drejtpërdrejt me shpëtimin e jetës së njeriut. Si mendon ti, si mund ta zgjidhim?

Shkelqim Gjoni . Kjo në bashkëpunim me drejtorinë e ...

Fatmira Thartori . Ose ministrinë e shëndetësisë ndoshta.

Hekuran Xhani . Në lidhje me eksavatorin deri ku është arritur sepse ne e kaluam me vendim.

Andi Proshka . Ka nisur si procedurë për blerje.

Hekuran Xhani . Në bashkëpunim me administratën ndihmëse të marri zgjidhje emergjente ambulanca dhe eskavatori të mos vonohet...

Shkelqim Gjoni . T'i bëjmë punët në kohë mos presim emergjencat.

Erind Tosku . Unë kisha faktikisht një pyetje për sa i përket, ndonjë problematikë që kanë më emergjente hotelet, restorantet në zonën e Spillesë mund të na jepni mund të na jepni çfarë

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

problematike kanë që dhe tek projektbuxheti që do na vijë i shqyrtuar i punuar a mund të na thuash që çfarë problematike kanë? Se ne do rrisim dhe taksat e pastrimit e mirëmbajtjes etj? Çfarë problematike ka që ne të ja përmirësojmë këtë që dhe biznesi të dijë u rrit taksa por shërbimi...

Shkelqim Gjoni . Të thashë që problemi kryesor është trajtimi i ujërave të zeza është pika më e rëndë e plazhit të Spillesë, se plazhi e ka pishën e ka rërën ka pastrimin që bëjmë ne por ujërat e zeza janë pikë e errët që ul kokën nuk ke çfarë të thuash.

Amarildo Duka . Është investim gati 11 milion euro.

Erind Tosku . Vetëm ujërat e zeza kanë problem?

Shkelqim Gjoni . Këtu është pika më e errët tjerat përballohen.

Fatmira Thartori . Edhe energjia e dobët elektrike.

Shkelqim Gjoni . E thashë.

Fatmira Thartori . Po pra këto janë më emergjentet që duhen patjetër.

Erind Tosku . Bashkia ka projekt për menaxhimin e ujërave të zeza, për rivitalizimin mirëmbajtjen ose rirregullimin e këtyre gjërave.

Geraldo Gjini . Bashkia me stafin që ka nuk bën dot projekte të atij niveli sepse siç po thonim është projekt që shkon me miliona euro por ujësjellës kanalizime Durrës ka nisur procedurën në dijeninë time po bën një studim paraprak çfarë tubacioni duhet, me çfarë impianti edhe trajtimi i ujërave të ndotu menaxhohet nga ujësjellësi.

Erind Tosku . E kisha më shumë në qoftë se Bashkia jonë nuk ka potencial për projekte të këtyre përmasave dhe nuk i ka në dosjet e bashkisë mund të ketë një fond ose të nënkontraktojë një zyrë që të merret me këto lloj projektesh?

Amarildo Duka . "Arabel " e ka studio, në dijeninë time është projekti.

Erind Tosku . Dmth është projekti? Çështja është thjeshtë presim miratimin ... Edhe diçka kemi marrë vesh nga rrjetet sociale që në qendrën shëndetësore Rrogozhinë është shtuar një tjetër

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

autoambulancë dhe është një gjë shumë e mirë. Besoj që me drejtorinë e shëndetit që kemi ne mund të bëhet diçka që tre muajt e verës një nga autoambulancat të shkojë në Spille? Besoj që ju të merreni me këto lloj procedurash që të bisedoni...

Andi Proshka . Ne e kemi pasur një takim me drejtorin e spitalit dhe na ka thënë ok. Një ambulancë i ka të gjitha mjetet e duhura...

Enver Memolla . Do e japë drejtori i qendrës shëndetësore apo i ISHP-së Kavajë?

Andi Proshka . Ajo autoambulnacë i është dhuruar qendrës shëndetësore spitalit në Bashkinë Rrogozhinë.

Enver Memolla . Po flet për këtë të renë që ka ardhur tani?

Andi Proshka . Po me një marrëveshje gjatë sezonit veror i ka të gjitha mjete e duhura .

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër për z. Shkëlqim? z. Shkëlqim faleminderit për gjithçka. Administratori i Sinaballaj për arsye personale nuk është sot në mbledhje.

Mitat Daja . Kush është ai zysha që nuk është ?

Mukades Gixhari . Tani kalojmë tek administratorja e Gosës znj. Valmira Troka.

Mitat Daja . Zysha kam një kërkesë përpara se të fillojë Valmira se e kam pasur dhe kolege dhe e ka shkruar raportin më mirë nga të gjithë. Po meqë është Andi nënkryetari i Bashkisë dhe Sekretari i Përgjithshëm kam një emergjencë të madhe për zonën e malësisë sepse tani është koha e prodhimit të ullinjve dhe tani gjithë ajo zonë atje është për turp që të paktën nuk çohet buldozeri apo çfarë mjetesh ka Bashkia për të pastruar pak rrugën është zonë komplet malësia është emergjencë është kërkesë…

Mukades Gixhari . Tek të ndryshme z. Mitat, ke shumë të drejtë.

Mitat Daja . Meqë ai nuk është sepse do ja kërkoja atij meqë nuk do diskutohet tani, thashë për sot ta diskutojmë sot jo për herën tjetër.

Valmira Troka . Atëherë problemet më të shumta në zonën e njësisë administrative Gosë i kemi në fushën e bujqësisë na duhet patjetër pastrimi i kanaleve vaditëse dhe atyre kulluese.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Pavarësisht se ne me punonjësit e shërbimeve pak a shumë e kemi bërë një mirëmbajtje të kanaleve por kjo nuk është se ka qenë e mjaftueshme. Është bërë një punë nga bordi i kullimit me kanalin kullues K5, i cili është në përfundim kemi pastruar pak a shumë disa kanale në Gosë të Madhe, në Gosë të Vogël, Kalush dhe Kërçukaj edhe pse ne kemi bërë disa pastrime paraprake kjo nuk ka qenë e mjaftueshme sepse ngelet një punë shumë e madhe për t'u bërë. Kemi plot 20 kanale kulluese të dyta në kënetën e Gosës qendër për t'u pastruar, gjithashtu e domosdoshme është për t'u pastruar kanali kullues i ujërave të larta Lekaj që bëhet në derdhjen e Shkumbinit dhe kjo sjell pasojë përmbytjen e tokave që kap komplet zonën e Gosës. Gjithashtu jemi marrë si njësi me pastrimin e ambienteve publike, shkollave, rrugëve. Ne si njësi kaq mundësi kemi pastaj…

Mitat Daja . Tani për këtë tek taksat ose tarifat që keni mbledhur ju aty, ti ke shkruar vetem fakt por sa ka qenë plani nuk e ke shkruar, ne nuk e dimë se sa ka qenë menduar të realizohet e para. E dyta ke një taksë tregu për 6-mujorin është ky apo jo?

Valmira Troka . Nga Qershori deri në Tetor e ke.

Mitat Daja . 46 mijë e 500 e ke taksë tregu, sa i bien me të vjetra apo me të reja?

Valmira Troka . Me të vjetra.

Mitat Daja . Tregun e administron njësia administrative apo jo?

Valmitra Troka . Po.

Mitat Daja . Sa është tarifa aty për një tavolinë.

Valmira Troka . Nuk është se ne kemi marrë një tarifë konkrete…

Mitat Daja . Si nuk keni marrë? Shkon dhe merr sa i teket atij…

Valmira Troka . Zakonisht kemi marrë… nuk është zyrtare.

Erind Tosku . Mesa di unë tarifë fikse ka tregu i Rrogozhinës…

Mitat Daja . Po ka për m^2 është përcaktuar…

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Erind Tosku . Dhe në Rrogozhinë ke pjesën e trotuareve aty që…

Mitat Daja . Më vjen keq tani në rrugë ka një tarifë për sa m^2 ka vendosur tezgë ai personi?

Orges Tosku . Është 500 lekë të vjetra për m^2.

Mitat Daja . Po të pjesëtojë këtë, tregu bëhet një herë në javë, i bie 4 herë në muaj I bie që mund të ketë 20-30 tregtarë kaq ka tregu?

Valmira Troka . Pak a shumë aq, tani që të jemi konkret një fshatari të thjeshtë që shet dy speca, dy qepë…

Mitat Daja . Kam frikë se nuk është pa lekë ai fshatari i shkretë, ai fshatari shkretë e paguan tarifën.

Valmira Troka . Mund t'i marrim 100 lekë të vjetra.

Mitat Daja . Nuk ka ndodhur nuk ndodh kjo.

Valmira Troka . Ndodh.

Mitat Daja . Ta siguroj unë që nuk ndodh. Ai fshatari shkretë paguan njëmijë lekëshin se po nuk pagoi… por shikojeni pak këtë shikojeni pak tregun. Unë ju këshilloj që ta shikoni tregun.

Valmira Troka . E shohim tregun ne por problemi është se nuk është se ka dhe aq shumë njerëz që ata tregtarët të bëjnë punë, çfarë të bëjnë t'i marrim frymën?

Mitat Daja . Jo.

Orges Tosku . Tregtarë të mirëfilltë ke shumë pak.

Mitat Daja . Sa tregtarë ka në tregun e Gosës a ka ndonjë bllok aty që paguhet tarifa?

Valmira Troka . Patjetër që ka bllok.

Mitat Daja . Sa veta paguajnë në javë aty në treg të Gosës? Po të bëj një pyetje meqë ndërhyre si drejtor taksash.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Orges Tosku . 70-80 mijë lekë të vjetra në javë.

Mitat Daja . Na dëgjojnë dhe njerëzit, unë propozoj tani 3- vetë një komision nga këshilli të shkojnë dhe të mbledhin taksat një javë atje edhe ta shohim.

Orges Tosku . Po ta them pra shumica janë tregtarë të zonës.

Erind Tosku . Bashkohem pak me Mitatin tek pjesa, a është kërkuar nga Njësia zhvendosja e tregut mos me e lënë aty në mes të rrugës dhe me i gjetur një hapësirë që të mbledhë taksat më mirë. Unë mendoj se aty një pjesë…

Valmira Troka . Atë gjë unë e kam menduar dhe me të drejtë kam pasur edhe fondacion për ta bërë një treg të mirëfilltë por nuk kam pasur zonë nuk kam pasur tokë shtet, vend hapësirë publike që të bëj tregun, se edhe investimi më është ofruar por nuk kam gjetur…

Fatmira Thartori . Sa për tregun ne që jemi banorë të Gosës, ai treg aty duhet ndryshuar sepse në mëngjes ne të gjithë kalojmë aty herët përveçse është e zënë komplet xhadeja, pra nga të dyja anët është dhe rrezik për kalimin e fëmijëve aty se do kalojnë në xhade ato nuk ke nga kalon tjetër. Nga një anë tezgat që shesin dhe nga ana tjetër pastaj i bie mes përmes xhades dhe mendimi jonë… Si mendon ti Tasha? Jo vetëm thjeshtë orari gjejmë hapësirë por mund të jetë edhe brenda për brenda qendrës së Gosës siç ka pas qenë më përpara që nuk rrezikonte asnjë edhe u mblidhnin më mirë taksat. Kurse aty në xhade është diçka që duhet patjetër emergjente të ndryshohet.

Mitat Daja . Tani tregun nuk mund ta largosh shumë.

Valmira Troka . Jo jo brenda për brenda Gosës siç ka qenë.

Besnike Coraj . Dhe unë për këtë doja të flisja si tha dhe Vali të gjenim një haoësirë tjetër.

Fatmira Thartori . Tek pallatet siç ka qenë më mirë aty.

Mitat Daja . Duhet të kuptoni diçka që tregu sa më afër rrugës aq më shum është efiçent kush ka bërë tregti e kupton këtë gjë, tek shkolla nuk është efiçent.

Besnike Coraj . Nuk po flasim që të jetë tek shkolla.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Valmira Troka . Ambulanca të ketë kushte të ketë personelin të kualifikuar…

Besnike Coraj . Unë kam qenë vetë por nuk jepej ndihma e kërkuar ishin tre mbytje … ambulanca do shumë kushte, i kanë kapur njerëzit me peshqirë ka qenë një pamje nuk e di ç'të them. Kemi qenë aty gjithë si staf por nuk bënim dot asgjë po nuk ishte shërbimi me ambulancë me kushte me… kjo është edhe për ne nuk është vetëm për…

Mukades Gixhari . Është e drejtë znj. Besnike. Z. Indrit.

Indrit Dedej . Sa për tregun meqë rruga nacionale nuk kalon unë them është më i përshtatshëm aty edhe për bizneset sepse është edhe hapësira më e madhe kurse brenda në komunë ku është ajo lulishtja e vogël nuk mblidhet nuk ka shans.

Valmira Troka . Duke e çuar në rrugë kam menduar që të ushqehen edhe bizneset një herë në javë të paktën.

Fatmira Thartori . Jam dakord tek ajo pjesë që është rrugë nacionale nuk paguan taksa dhe taksat i mblidhni ju por puna është a nuk rrezikohen qytetarët pak më parë u tha aty që nuk ka shumë tregtarë, kurse tani ka tregtarë… dhe nuk ka shumë tregtarë dhe këto pak tregtarë mund të shkojnë prap në ato zona ku ka qenë tregu që prap komuna i merr taksat njësia administrative i merr taksat nuk i merr biznesi. Prap brenda për brenda rrethit të qendrës së Gosës që janë nëpër palate kurse aty është rrezik dhe të gjithë më kanë thënë që unë ta ngre zërin për këtë pjesën që të gjithë kur kalojmë në mëngjes është tmerr dita e Mërkurë sepse nuk kalohet as me makina por edhe fëmijët ke frikë do i përcjellësh fëmijët prindërit vijnë kastile për të përcjellur fëmijët, ditët tjera jo por atë ditë i përcjellin dhe i marrin sepse është ngarkesë është në rrugë nacionale.

Valmira Troka . Unë them të kalojë tek një pjesë e dytë dmth të kalojë tek pjesa ku është që ka qenë lokali i Takut, që del përmes lagjeve një ditë për dy orë ose tre orë bëhet dërman dmth të besh thjeshtë lëvizjen t'i tjetërsosh. Është një rrugë alternative dmth edhe mund të bëhet.

Indrit Dedej . Merr policinë bashkiake atë ditë që ka treg të vijë aty.

Erind Tosku . Vali kishim një propozim dhe një sugjerim që tek problematikat që i kategorizoni primare sekondare etj. Të shihet që ajo rruga Gosë-Vilë Bashtovë që janë ato ferrat kallamishtet të pastrohet dhe të dali kanali në pah se nuk e dimë ku është fundi rrugës, sa i thellë është kanali dhe të paktën të prehet. Është prerë vetëm njëherë këtë sezonin e verës e kam parë vetë personalisht …

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Valmira Troka . Po e kam çuar unë.

Erind Tosku . Por nuk prehet ashtu, duhet prerë taman të dali trafikndarësja, ka qytetarë ngaqë i kanë zënë kallamishtet nuk e dinë që ka trafikndarëse.

Valmira Troka . Ka qenë privatisht.

Enver Memolla . Edhe për të mos e zgjatur shumë unë dy gjëra kam, meqenëse kemi dhe Valin këtu që të marrim në shqyrtim kërkesën e zotërisë që është nga Gosa edhe e dyta përpara kësaj marr shkas nga fati keq i kolegut tonë Bajazitit atë ditë që isha atje erdha prap vura re që ajo rrugë Vilë Bashtovë Gosë është pa sinjalistikë. Dhe do kërkoja nuk e di se sa mundësi ka Bashkia me ARRSH-në për këtë pjesë sidomos si tek ura e Çopanit, si dhe kthesa e fortë aty të paktën disa mburoja anësore sepse i bashkohem asaj që tha Erindi ne nuk e dinim që ishte aq i gjërë ai kanal, tani e pamë që u pastrua K5 se dhe rruga aty ka disnivelet e veta, realisht ajo kthehet në rrugë sezonale për plazhin sidomos edhe për të ikur në Spille më shkurt por edhe për të shkuar në Vilë Bashtovë që po ngrehet tani së fundmi. Realisht kjo është një kërkesë që nuk do lënë pas dore Val, sepse ndodhi një tragjedi të mos kemi të dytë më. Për pjesën e barrierave këtë e kam thirrje për gjithë Bashkinë jo vetëm për ... se realisht aty është minë me sahat, rruga nuk ka nivel për arsye të tokës që ujë këtej ujë andej dhe zbutet dhe tonazhi bën punën e vet por ajo është minë me sahat. Makina është ne qytetarët e thjeshtë jemi me këmbët e huaja jo me këmbët tona rrëzohemi kollaj por mos ndodhë fatkeqësi tjetër, se e kam ballë për ballë të ndjerin realisht që atë ditë që e pamë...

Indrit Dedej . Është përgjegjësi e zyrës...

Enver Memolla . Është përgjegjësi kjo pjesë. Andi nuk e di nëse e mbajte shënim këtë pjesën e Vilë Bashtovës. Tani edhe kjo pjesa tjetër për kërkesën meqë është edhe Vali që të mos e shkëpusim, ta diskutojmë këtë pjesën e kërkesës.

Mukades Gixhari . Atëherë kemi një kërkesë nga Njësia Adminsitrative Gosë.
Kryetarit të Bashkisë z. Edison Memolla.
Kryetares së Këshillit znj. Mukades Gixhari.

Unë i quajturi Darda Zejnel Vallasi banor i fshatit Gosë qendër, ju patashtroj kërkesën time si më poshtë vijon :
Kam një shtëpi të ndërtuar para 20 vitesh me Çertifikatë Pronësie të banesës dhe të tokës truall mbi të cilën është ndërtuar shtëpia. Firma që ndërtoi para disa vitësh shkollën e re kur bëmë

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

rrethimin e shkollës muri rrethues nga ana e shtëpisë time është vendosur pothuajse ngjitur me shtëpinë time. Kjo më heq mundësinë të bëj qoftë edhe një shërbim të vetëm për nevojat që i duhen shtëpisë, e pakta për një pastrim të thjeshtë por edhe për t'i ardhur rreth shtëpisë për nevoja në të ardhmen.
Ju lutem Bashkisë Këshillit Bashkiak që të më mundësohet që nga ana ku kam këtë problem të më ndihmojë në zgjidhjen e këtij problemi nga sa ju parashtrova më sipër jam i gatshëm që shpenzimet t'i heq vetë deri në përfundim të punimeve.
Faleminderit duke shpresuar që kërkesa ime të merret parasysh.
Me respekt, Dardan Zejnel Vallasi
Është dhe certifikata e pronësisë.

Besnike Coraj . Kjo qëndron problemi që ka zotëria është e vërtetë në hapësirën që ai ndahet nga shkolla ai nuk futet nuk ka fare hapësira që t'i vijë shtëpisë së tij rreth e rrotull.

Valmira Troka . Madje ishte tani nuk ka as tre javë që ai donte të bëntë një ndërhyrje tek shtëpia e tij dontë të suvatonte dhe na ka marrë leje ne për të vënë skelat nga ana e shkollës sepse është avllia muri rrethues i shkollës ...

Besnike Coraj . Ai do të shtyjë pak murin e shkollës që të ketë hapësirë të kalojë ...

Erind Tosku . Tani shkolla i ka zënë hapësirën zotërisë apo avllia është hapësirë e shkollës?

Valmira Troka . Është e shkollës.

Besnike Coraj . Ai ka shumë vite që e ka bërë shtëpinë aty është truall i vjetër.

Altin Tosku . Ai duhet t'i lejë vetë hapësirë vetes së vet për më bërë shtëpinë nuk do futesh ti në hapësirën e shkollës.

Mukades Gixhari . Informacion, komshiu që është afër zotërisë avllia që i ka qëlluar tek shtëpia ka marrë ato hapësirat sepse zotëria ka bërë dhe foto, tek komshiu që është si zotëria i ka ardhur avllia me zig-zag dmth i është krijuar mundësia komshiut që të ketë hapësirë mbrapa shtëpisë, ndërsa zotërisë në fjalë ju ka ngjitur fiks fare. Të dëgjojmë pak z. Enver.

Enver Memolla . Tani kjo është një problematikë që jo vetëm zotërisë që e ka sjellë por dhe persona tjerë që njoh unë që kanë të tilla përplasje në bashki apo komuna. Unë kam disa pyetje

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

faktikisht por po e nis nga e para: Kur filluan punimet e shkollës së re që u bë nga rindërtimi, zotëria e ka pasur hapësirën nga pas që kërkon?

Altin Tosku . E ka pasur truall…

Valmira Troka . Punimet kur janë bërë janë bërë po tek themeli i vjetër edhe avllia e shkollës…

Enver Memolla . Po flas për rrethimin.

Valmira Troka . Po pra rrethimi i avllisë është bërë po tek e vjetra nuk është lëvizur.

Enver Memolla . I bie që është në kufi të vet rrethimi i shkollës.

Valmira Troka . Po.

Enver Memolla . Atëherë zotëria kërkon hapësirë nga shkolla tani? Dhe i bie që të japim hapësirë publike, jo se e ka zënë shkolla?

Valmira Troka . Jo nuk e ka zënë shkolla.

Enver Memolla . Këtu lind ngërçi sepse zotëria duhet të dijë shumë mirë që ka një hapësirë ligjore që në bazë të kufirit ka 1 m^2 , linear që duhet të rrijë larg kufirit apo jo? Gerald kam një pyetje, çdo objekt a e ka hapësirën e kuadratëve që duhet të ketë brenda llojit të vet? Sepse këtu ndodh ajo nuk i ka hyrë shkolla në territory.

Valmira Troka . Po.

Enver Memolla . Pikërisht pra që ta kemi të qartë këë pjesë. Në rregull unë po them që në qoftë se shkolla nuk i ka prekur hapësirën publike, hapësirën personale të z. Dardan dhe nëse muri kufitar është po i shkollës nuk e kemi ne si shqyrtim por ama nëse ai pretendon nga ana e komshiut kjo është pjesë që e zgjidh vetë urbanistika me anë të hartës që ka vetë ne kadastër nuk është pjesë e këshillit.

Erind Tosku . Kjo kthehet në precedent pastaj ka shumë banesa që janë afër shkollave, afër spitalit, thotë ai shiko se spitali më shqetëson…

Valmira Troka . Nëse një metër nuk i prish punë shkollës…

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Andi Proshka . Personi nuk është se po ankohet ai po kërkon bashkëpunim. Edhe ato komshinjtë që ka aty i kanë ruajtur distancat vetë.

Enver Memolla . Unë propozoj që kërkesa e zotërisë t'i shkojë zyrës kompetente, të merret me problemin ne nuk kemi vendim këtu.

Indrit Dedej . Unë kam një mendim ndryshe me komisionin e konflikteve bashkë me zyrën e Urbanistikës dhe shohim atje…

Geraldo Gjini . Ajo pjesë është e qartë edhe ai nuk pretendon që i ka zënë shkolla.

Hekuran Xhani . Ky është një problem që i përket Njësisë Administrative, ky është një problem që e dinë mirë administratorja dhe këto zonjat që përfaqësonjë njësinë në këshill. Unë mendoj t'i japim një zgjidhje atij qytetarit që ne jëmi këtu në emër të tyre dhe të mos i vijmë përqark ligji apo Maliqi se kështu as për 10 vjet nuk mbarojmë punë…

Valmira Troka . Unë jam dakord që atij t'i lejohet që në një krah të shtëpisë t'i lirohet 1 m. Ne nuk na prish asnjë lloj pune.

Hekuran Xhani . Këshilli është dakord edhe të votojmë për të ja zgjidhur problemin atij.

Andi Proshka . Ngrihet një grup verifikimi që të ngrihet ta verifikojë.

Enver Memolla . Indrit sot e ke kërkesë nuk merr dot vendim sot.

Indrit Dedej . Ne kemi të drejtë verifikimi.

Fatmira Thartori . Nuk kemi të drejtë ne të ngrejmë komision se është bashkia institucion.

Hekuarn Xhani . Si anëtar i këshillit bashkiak ke të drejtë tit ë shqyrtosh ankesat dhe kërkesat e qytetarëve?

Enver Memolla . Për shqyrtim jam por jo për vendim.

Hekuran Xhani . Por dhe do i japësh zgjidhje zotëri, se këshilli është organ vendimarrës. Indrit këshilli ka përfaqësuesin e vet atje kanë shkuar e kanë parë mirë, është drejtuesja e njësisë është ajo zonja nga Gosa do dhe ti nga Rrogozhina me e parë shko shihe. Ti japim zgjidhje problemit jemi për të zgjidhur hallin …

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Mitat Daja . Atëherë Vis, ti je nga ana ligjore ne mund të marrim dot një vendim për ta zgjidhur këtë problem.

Ervis Shera . Përgjigjen ta jep drejtori i Urbanistikës.

Mitat Daja . Drejtori i urbanistikës ne mund të marrim një vendim për këtë?

Geraldo Gjini . Kjo nuk është tagër as e juaja as e jona sepse ajp është ambient i shkollës ajo që të hiqet një pjesë toke e shkollës duhet të kalojë me VKM nuk e kaloni dot as ju as ne.

Mitat Daja . Tani çfarë mund të bëjmë ne? Këtë po them pse zgjatemi shumë a bëjmë dot gjë ne?

Hekuran Xhani . Banesa e këtij e ka hapësirën e nevojshme sipas ligjit? Qenka më e rëndësishme Ministria e Arsimit se banorët e bashkisë Rrogozhinë. A mund t'i shërbejmë ta ndihmojmë qytetarin se drejtuesja e njësisë thotë që e ndihmojë qytetarin pa i bërë dëm shkollës. Pse mos e ndihmojmë ne?

Indrit Dedej . Qytetari mund ta ketë bërë ndërtesën me distancën nga muri i shkollës mbrapa ka bërë një kacolle. Tani nuk është faji jonë se ka shtuar kacolle atje, ne shohim ka tokë ska tokë.

Alime Hoxha . Ne nuk kemi të drejtë të ja japim atë çfarë diskutojmë.

Erind Tosku . Drejtori urbanistikës na dha përgjigjen zyrtare ligjore tha pa vendim nga këshilli i ministrave për hapësirën publike që zotëron shkolla se shkollat kanë çuar hartën atje. Shkollat kanë çuar hartën sa hapësirë kanë shkollat dhe është miratuar në Ministrinë e Arsimit, gjimnazin tonë ja kam çuar unë hartën atje dhe nuk preket. Tani hajde të gjejmë një zgjidhje nuk kemi çfarë t'i bëjmë nuk është në tagrin tonë kjo pjesë.

Enver Memolla . Në bazë të kërkesës që ka bërë Bashkia Rrogozhinë të ngrejë komision të verifikojë faktin në terren të zotërisë dhe të marri vendim Bashkia vetë pastaj.

Hekuran Xhani . Kjo zonja po thotë që ka mundësi të ndihmoeht qytetari, këto zonjat përfaqësuese të njësisë administrative Gosë thonë që ka mundësi të ndihmohet mos i kërkoni frymën ligjit. Ai thotë ka mundësi ta ndihmojmë hajde ta ndihmojmë ne jemi këtu për të ndihmuar.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Enver Memolla . Të mos keqkuptohemi drejtori i kadastrës thotë nuk ka mundësi ligjore nëse është pronësi shtet duhet VKM …

Mukades Gixhari . Atëherë Bashkia do ngrejë verifikimi për ta ndjekur kërkesën e zotërisë.

Hekuran Xhani . Këshilli është dakord me zgjidhjen e problemit të qytetarit.

Mukades Gixhari . Kemi administratorin e njësisë administrative Lekaj z. Altin Mema.

Altin Mema . Meqenëse profesori na bëri pak vërejtje për relacionin them më mirë të shprehi ato pakënaqësitë që ka, çfarë pyetje ka t'i përgjigjemi. Të mirat nuk ja them se ja kam shkruar ai do të këqiat që nuk i kam shkruar prandaj po pres…

Mitat Daja . Po mirë pse mbaheni tek profesori ju… ?

Altin Mema . Sepse ti e bëre vërejtjen.

Indrit Dedej . Performanca jote është e shkëlqyer, i ke dhënë ndonjë ndihmë fshatarëve tonë atje sipër?

Altin Mema . Me naftën unë jam më i miri nga njësitë administrative janë 365 persona që kanë marrë.

Fatmira Thartori . E ka për fushatën e ullinjve.

Altin Mema . Ullinjtë nuk kanë mbajtur.

Enver Memolla . Altin diga e rezervuarit është funksionale?

Altin Mema . Diga është bërë dy vjet ka që është bërë.

Enver Memolla . Porta?

Altin Mema . Porta ka rrjedhje akoma por është normale nuk ndonjë rrjedhje të madhe që të bëhet shqetësim i madh. Po të bëhet rrjedhja është investim 5 mijë euro.

Mitat Daja . Është investim i madh 5 mijë euro?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Fatmira Thartori . Është investim i madh 5 mijë euro? Po vetëm ne të zonës atje e bëjmë atë.

Mitat Daja . Ka pasur një problematikë të madhe për vaditjen në Gërmej. Tani është bërë ndonjë përçapje për ta rregulluar këtë problem?

Altin Mema . Ky është investim goxha i madh duhen diku tek 500 milion lekë të vjetra unë e kam shënuar aty është pjesa e "Lugut" është dhe pjesa e "Fogut" me emërtimin popullor siç njihet.

Mitat Daja . Unë kam dëgjuar për një tub normale që mund ta blejë.

Altin Mema . Nuk janë tuba normale ato.

Mitat Daja . Është bërë një projekt për ta rregulluar këtë? Është gjithë ajo zonë.

Altin Mema . Është bërë dhe i ka shkuar Ministrisë së Bujqësisë dhe ka 2 vjet.

Mitat Daja . Përgjigja për këtë?

Altin Mema . Nuk ka ardhur se i vjen Bashkisë nuk i vjen njësisë edhe ministrisë Bashkia i drejtohet.

Mitat Daja . Bashkia si mund të lehtësojë këtë punë?

Altin Mema . Bashkia vetëm të këmbënguli t'i shkruaj shkresa gjithmonë.

Mitat Daja . Pra edhe këtë vit nuk shpresohet që të ketë diçka…

Altin Mema . Nuk e them dot, ndoshta bëhet për dy muaj ajo kryhet.

Fatmira Thartori . Mitat na lër ne që jemi banorë të zonës të flasim e të kërkojmë.

Mitat Daja . Fatmira ti ke konflikt interesi.

Fatmira Thartori . Absolutisht burrin nga Okshtuni vetë nga Gosa. Atëherë për sa i përket portës ky projekti që është planifikuar a e përfshin portën apo jo? A e përfshin atë tubin që tha ai çuni?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Altin Mema . Saimir porta është bërë në kohën që ka qenë Bushi. Kurse tek diga është porta është bërë në kohën që ka qenë Bushi është hedhur ajo baza materiale është ngjeshur janë hedhur gurët është bërë kanali me veshje betoni.

Fatmira Thartori . Si mund t'i japim një zgjidhje ne si banorë të asaj zone të gjithë ose edhe Bashkia?

Altin Mema . Aty porta do një investim të dytë.

Fatmira Thartori . Atëherë ne po e bëjmë këtu publike na duhet një portë për atë zonën atje.

Saimir Cani . Porta është por thjeshtë duhet rregulluar pjesa poshtë që të mos dalë uji.

Altin Mema . Nuk ta merr njeri përsipër Saimir me e bërë, këtu e kemi problemin se është 17 m portë.

Fatmira Thartori . Të bëhet përpara verës është puna që të grumbullohet uji dhe pastaj të bëhet vaditja gjatë periudhës së verës.

Indrit Dedej . Kush e administron rezervuarin?

Altin Mema . Bashkia.

Indrit Dedej . Po rritjen e peshkut kush e administron?

Altin Mema . Asnjë. Ai rezervuar është kërkuar nga dikush dhe nuk është dhënë.

Hekuran Xhani . Altin për rrugën Okshtun Levanaj disa qytetarë kanë ankesa sepse ngritja e ujit nuk i lejon që të kalojnë me mjete atje, si mund të zgjidhet për t'i dhënë mundësi sepse atje janë gjithë ato toka gjithë ato prona.

Altin Mema . Urbanistika pati duhet një investim i madh përderisa kjo nuk u krye në kohën e atij qoftëlargut që iku.

Hekuran Xhani . Në atë kohë unë kam qenë këshilltar, në atë kohë funksiononte rruga.

Altin Mema . Vetëm për verë kur mbushet me ujë nuk kalohet se tani kalohet se nuk ka ujë rezervuari.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Hekuran Xhani . Është shumë e lehtë është vetëm një luginë që do mbushur me shkuar mjetet po për 5 mijë euro,

Altin Mema . Problemi ndodh kur mbushet rezervuari me ujë se tani aty kalohet po kur mbushet… edhe ai investimi që thanë ata prap do kalojë uji sipër është e pamundur. Është një rrugë nga lart por don shumë investim.

Fatmira Thartori . Rruga nga lart do thjeshtë skrepin se unë kam kaluar tek ajo rruga me skrep nuk do kishte shumë harxhim.

Altin Mema . E di sa do ajo? -Dy muaj punë me skrep.

Fatmira Thartori . Është i Bashkisë skrepi të punojë atje dy muaj nuk do kishte shumë harxhim nga ana e bashkisë.

Mitat Daja . Po a janë dy skrepa?

Fatmira Thartori . Janë 3 tani.

Altin Mema . Kanalet kulluese kanalet tona atje poshtë si rregull i bie pas 2020 se çdo 5 vjet pastrohen.

Hekuran Xhani . Ish drejtori i bujqësisë ka pëergjegjësinë që nuk i ka bërë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetej tjetër për z. Altin? Z. Saimir kishe gjë për Gërmenjin? Atëherë z. Altin faleminderit. Kalojmë tek Raport nga sektori i auditit të brendshëm. Fjala për përgjegjësin e auditit të brendshëm z. Nuredin Tosku. Z. Nuredin përshëndetje!

Nuredin Tosku . Njësia e auditit të brendshëm ka bërë një auditim për vitin 2023 në Njësinë Administrative Kryevidh. Dhe kemi evidentuar gjetjet dhe kemi dhënë rekomandimet përkatëse të cilat jua kemi dërguar dhe në materialin që keni. Gjetjet kryesisht janë të karakterit organizativ nuk kanë të bëjnë me ndonjë shkelje të rëndë. Kemi dhënë rekomandimet në bashkëpunim dhe me drejtorinë e taksave jemi përpjekur që të arrijmë një gjëdnje sa më të pastër të të ardhurave nga debitorët normalisht debitorët janë shumë në Njësinë Kryevidh janë 8 miion 947 mijë lekë të reja është një gjëndje që don shikuar patjetër.

Indrit Dedej . Janë mbledhur?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Nuredin Tosku . Jo janë debitorë.

Indrit Dedej . Sa mbledhje keni pasur ?

Nuredin Tosku . Mbledhjet mund t'i shohim tani, është për vitin 2021 që e kemi bërë ne auditimin. Këto janë rekomandimet se e kemi thënë të ardhurat sa janë mbledhur 34 milion e 116 mijë e 740 lekë plan fakt realizimi është në 110 %. Dhe për subjektet që janë të paregjistruara kemi dhënë rekomandim që të merren masat, sipas ligjit nr. 9920 për regjistrimin e këtyre subjekteve. Këto janë masat që kemi marrë, N=në qoftë se këni ndonjë pyetje.

Indrit Dedej . Masë më ekstreme keni marrë?

Nuredin Tosku . Dmth aktualisht jam duke kryer një audit në MZSH-në, unë 1 muaj kam që jam përgjegjës.

Indrit Dedej . Ne kemi qejf që t'i shohim gjërat si puna e SPAK-ut.

Nuredin Tosku . Ne jemi mbështetës për Bashkinë ne e ndihmojmë Bashkinë, që të arrijë obkjektivat e saj nuk është se jemi SPAK-u. Ne jemi të brendshëm.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër për auditin e brendshëm?

Erind Tosku . Sa zgjat auditimi i një Njësie?

Nuredin Tosku . Varest se sa e parashikon ne e parashikojmë zakonisht 1 muaj, mund të parashikohet edhe më pak në varësi të problematikave që ka njësia.

Erind Tosku . Auditimi është i paralajmëruar apo është ...?

Nuredin Tosku . Po po dmth krijojmë një plan vjetor dhe një plan strategjik...

Erind Tosku . Dmth njoftohet njësia administrative që do ketë...?

Nuredin Tosku . Po po ka afatet përkatëse.

Alime Hoxha . Dmth ju jepni rekomandimet, pastaj kush merret me këtë?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Nuredin Tosku . Njësia na sjell planin e veprimit të rekomandimeve, se mund të ketë dhe rekomandime të cilat nuk pranohen dhe më pas e ndjekim po ne shkojmë për kontroll për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër? Faleminderit. Tani kalojmë tek "Të ndryshme" ku kemi … projektvendim…

Enver Memolla . Kryetare me leje? Në mbledhjen e kaluar jam drejtuar për vendimet e marra nga këshilli bashkiak për periudhën Janar – Tetor sa janë zbatuar dhe sa janë në zbatim sa janë pa zbatuar dhe s'më ka ardhur mund ta di arsyen?

Ervis Shera . Rezi mund të na thuash pak për atë vendimin që nuk është konfirmuar. Ai i shpenzimeve të varrimit vetëm ai është që nuk është konfirmuar gjatë periudhës.

Rezart Vogli . Nuk është konfirmuar nga ana e Prefekturës se ishte detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 80/2020 i Kryetarit të Bashkisë, kompetencë e kryetarit që të kryeje shpenzimet e varrimit .

Mukades Gixhari . Është zgjidhur?

Enver Memolla . Për mua kjo nuk është përgjigje.

Rezart Vogli . Veri po thotë të gjithë vendimet e këshillit bashkiak …

Enver Memolla . Nuk është përgjigje se pyetja ka qenë shumë e drejtpërdrejtë dhe e qartë më duhet raport sa projektvendime janë marrë, sa janë ekzekutuar sa janë në ekzekutim e sipër sa janë pa ekzekutuar nuk po kërkoj një apo dy. Më duhet numri total, se kam një muaj që e kam kërkuar nuk doja ta thoja në fillim të mbledhjes këtë pjesë por realisht unë këtë e shoh shumë të padrejtë sepse është kërkesë e anëtarit të këshillit bashkiak dhe kryetarit të grupit të PS-së. Siç na kërkojnë projektvendimet që të vijnë këtu, atëherë kjo për mua duket e paprecedentë dhe në vazhdën e vazhdimësisë. Dhe diçka tjetër e kam thënë në mbledhjen e dytë të këtij mandate të këshilit bashkiak që të lutem vendimi për të bërë datën, ditën, orën e cakton kolegji i kryetarëve të mbledhjes së këshillit bashkiak.

Alime Hoxha . Edhe diçka tjetër, e kemi lënë për komisionin e ekonomisë që të mblidhet të paktën 5 ditë para mbledhjes, ndoshta dhe komisionet e tjera të paktën 5 ditë para mbledhjes.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Ervis Shra . 5 ditë para bëhet njoftimi por komisonet mund të mblidhen kur të duan me vullnetin e Kryetares së Komisionit mund të mblidhen.

Enver Memolla . Edhe pyetja ishte e drejtpërdrejtë që çdo lloj komisioni do merret vendimi ta marri kolegji i kryetarëve. Të mblidhen kryetarët e komisioneve, kryetarët e grupeve parlamentare kryetari sekretari dhe të vazhdojë historia e kësaj pune. Sepse ndryshe kjo histori tani që …

Ervis Shera . Raporti që kërkoni ju është tek programi i punës që kemi kaluar në Dhjetor dhe vjen çdo fund viti ai. Për Dhjetorin ai është gati dhe kompletohet dmth këtë që kërkon e ke miratuar njëherë.

Enver Memolla . Unë e kërkoj dhe prap.

Ervis Shera . Nuk ka problem mund ta kërkosh sa herë të duash.

Mukades Gixhari . Për mbledhjen e radhës …

Ervis Shera . Për mbledhjen e radhës vjen.

Indrit Dedej . Mund të ketë dhe mbledhje jashtë radhe.

Mukades Gixhari . Kemi këtë projektvendimin për komisionin e Integrimit Europian. Po ju sjellim një shkresë për miratimin e komisoneve të përhershme të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë. Misioni i komisionit të Integrimit Europian… Doni të jua lexoj informacionin?

Fatmira Thartori . Jo, se e kemi lexuar.

Mukades Gixhari . Atëherë fillojmë me komisionin, ju dy kryetarët…

Enver Memolla . Kryetare të ndërhyj pak këtu nuk e di do kem apo jo miratimin e Indritit për të bërë komisonin do bëj një mbledhje grupi por meqenëse nuk është i gjithë grupi këtu e lejmë për radhën tjetër këtë pikë. Që të diskutohen dhe grupet të mblidhen të diskutohen mos i vejmë pa qenë prezent personi unë t'i propozoj emrin, ne tre jemi këtu sot. Do bëj një mbledhje grupi mos e bëj me mendimin tim personal.

Mukades Gixhari . Jeni dakord z. Indrit ?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Indrit Dedej . Dakord jam.

Mukades Gixhari . Kalojmë tek te ndryshme.

Mitat Daja . Kisha unë ca gjëra tek të ndryshme, po i them të gjitha përnjëherë që të mos vonohemi shumë se u zgjat dhe shumë mbledhja nu do ju vonoj shumë. Dua përgjigje nga Andi dhe kush është… dua përgjigje konkrete jo burokratike. E përmenda dhe në fillim zona e malësisë lart është situatë emergjente për të rregulluar rrugë për të shkuar njerëzit dhe për të marrë prodhimet. Çfarë zgjidhje do i jepni asaj zone? Një përgjigje do ma japësh tani, apo ditë tjetër me shkrim ku e di unë si do e bësh përgjigjen?

Andi Proshka . Ne çdo vit…

Mitat Daja . Të lutem mi kurse burokracitë. Ka punonjës mirëmbajtjeje rruga Sinaballaj – Thartor një pyetje po të bëj?

Andi Proshka . Nuk po të bëj burokraci. Çdo vit kemi marrë masa…

Mitat Daja . Asnjë masë nuk është marrë…

Andi Proshka . E ke gabim.

Mitat Daja . Po të them unë asnjë masë nuk është marrë po të them unë se unë jam nga malësia nuk jam, çfarë masash ke marrë?! Unë po them mos më jep përgjigje burokratike. Cila rrugë është bërë?

Andi Proshka . Tek "Shimtë".

Mitat Daja . E di ku është malësia e Rrogozhinës? -Nga Sinaballaj në Thartor. Lëri "Shimtë" është çështje tjetër.

Andi Proshka . E kam fjalën janë marrë masa çdo vit për hapjen e këtyre rrugëve, parcelave.

Mitat Daja . Nuk është marrë asnjë masë. Këtë vit ça do bësh?

Andi Proshka . Këtë vit sipas problemeve…

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Mitat Daja . Nuk është problemi nuk kalon dot as me gomar. Çfarë do bëni atje është gjithë ajo zonë. 30 vjet e ka mbajt pushtet ai i Njësisë Administrative atje dhe nuk ka bërë asnjë gjë.

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë deri në fund.

Mitat Daja . Është shumë e thjeshtë ço eskavatorin të hapi rrugën të shkojnë njerëzit të marrin prodhimet.

Andi Proshka . Shkojmë ta verifikojmë pastaj të marrim masat çfarë mund të bëjmë.

Mitat Daja . Mbledhjen tjetër do më japësh përgjigje çfarë shkresash ke bërë. Tani buxhetin e diskutuam atë punë nuk po e diskutoj më. Atëherë këtu ke një zyrë arsimore që është e Rrogozhinës. Është në varësinë e Bashkisë Rrogozhinë apo në varësinë e Ministrisë së Arsimit? A i paguan qera Bashkisë Rrogozhinë sepse këshilli bashkiak është aksionere në pronat e bashkisë. Paguan qera është pyetje?

Andi Proshka . Jo nuk paguan.

Mitat Daja . Po si mund të ekzistonkan zyra pa qera këtu?

Andi Proshka . Kanë bërë marrëveshje midis palëve, ka qenë hapësira edhe…

Mitat Daja . Kush ta lejon ty hapësirën që të fusësh njerëz aty?

Andi Proshka . Kush ta ndalon?

Mitat Daja . Unë ta ndaloj, se jam këshill bashkiak. Ka qera për këtë?

Andi Proshka . Çfarë problemi ka?

Mitat Daja . E paguani ju qeranë e merrni e fusni në xhep ose e merr ai e fut në xhep puna e tij. Ka qera apo nuk paguan qera kaq?

Andi Proshka . Jo nuk paguan.

Mitat Daja . Kush ta lejon ty?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Andi Proshka . Me marrëveshje me mirëkuptim ajo zyrë është aty.

Mitat Daja . Kjo është pronë e këshillit bashkiak ndërtesa dhe këshilli bashkiak është aksionere në pronat publike dhe ti ke futur në mënyrë klandestine një person dhe një Institucion që nuk duhet të ekzitojë. Ke bërë marrëveshje me shkrim?

Andi Proshka . Mbledhjen e ardhshme e diskutojmë të marr dhe unë informacion më tepër për këtë rast.

Mitat Daja . Deri tani me çfarë është marrëveshja me shkrim apo me gojë?

Andi Proshka . Nuk kam dijeni për këtë gjë, mbledhjen e ardhshme e diskutojmë.

Mitat Daja . Është bërë pezullimi i punëtorëve në Bashkinë e Rrogozhinës apo jo? Kam dëgjuar që janë pezulluar një grup punëtorësh për çfarë arsyeje janë pezulluar?

Andi Proshka . Bëj një kërkesë që ta shikojmë për mbledhjen e ardhshme.

Mitat Daja . Nuk e jep dot arsyen tani?

Andi Proshka . Jo.

Mitat Daja . Është bërë ngrohja tek shkolla "Qamil Gjuzi" sot nuk ka ngrohje Akoma.

Andi Proshka . Po merren masa që do shkollë të këtë sistem ngrohje.

Mitat Daja . Këto masa nuk e di çfarë masash po merrni aty nuk ka ngrohje. Kur do bëhet ngrohja me çfarë do ngrohen kalamajtë në shkollë? Është shi, është ftohtë po vjen i ftohti.

Andi Proshka . Tani çfarë masash tjera të them unë përveç kësaj që po them.

Mitat Daja . Meqë po merren masa e lejmë tek masat e juaja, kaq kisha unë por këto nuk janë përgjigje këto janë përgjigje me kaluar kohën dhe më falni që ju shqetësuam ju administratën.

Andi Proshka . Deri mbledhjen e radhës shkolla do jetë me ngrohje.

Mitat Daja . Deri tani shkolla është pa ngrohje.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Altin Tosku . Unë do isha për një treg fruta perimesh, që është jashtë çdo lloj standart janë të gjithë jashtë.

Andi Proshka . Sepse ne mund të kemi hapësira publike...

Altin Tosku . Hapësira publike çfarë e bëtë atë ndërmarrjen e punëtorëve, që ishte tregu i fruta perimeve, tani nuk merret vesh më se ku dalin punëtorët se ku është tregu. Tani filluan shirat ku do rri ai, ku do e shesë prodhimin? Leje hapësirën nuk ka gjë lëre hapësirën rregulloje.

Mukades Gixhari . Faleminderit Altin. Znj. Alime çfarë kishe?

Alime Hoxha . Përveç asaj që tha Altini për tregun nuk e di që është zënë, unë e di që është tregu i fruta perimeve, që ekziston. Kisha dhe tek pjesa e shkollave për sistemin e ngrohjes, aty tek gjimnazi është një sistem ngrohje kaldaja me naftë por duke qenë se unë e kam ngritur dhe herë tjetër vjet kemi qenë dy shkolla dhe aty ka shumë dëme materiale dhe një nga këto janë kaldajat, ato rrjedhin ujë se janë prishur. Doja që Bashkia të kishim një kontroll për t'i vënë në punë si sistem kaldaje, ka dhe të tjera dëme aty tek ajo shkollë, unë thashë e kam ngritur njëherë por prapë nuk është bërë asgjë...

Mitat Daja . As ka për t'u bërë gjë mos ki merak.

Alime Hoxha . Si për dyert për sistemin e ndriçimit sepse kemi dhe priza që janë të prishura, ato janë të rrezikshme sepse nxënësit ato janë të rritur nuk kontrollohen mund të shkojnë t'i prekin vetë ato, do isha për një kontroll dhe një rikonstruksion të shkollës. Edhe një gjë tjetër kisha jemi tek pjesa e zënies së hapësirave publike, i kemi tavolinat nëpër trotuare kemi pjesët e trotuareve apo parkingjeve janë të zëna me materialet e dyqaneve që shesin nuk kemi ku kalojmë nuk e di çfarë mase marrim.

Silvana Aliu . Nuk mund të japësh në shfrytëzim trotuarin kur ai tre metra është.

Erind Tosku . Kisha diçka meqë është drejtori i arsimit në bashki, këto evidentime që sapo foli Mitati, Alimeja i keni evidentuar ju?

Fatmir Meçaj . Po, i kemi çuar tek drejtoria e shërbimeve janë në procedura prokurimi flasim për pajisjen tuaj edhe problemet e tjera...

Mitat Daja . Po me shkollën "Qamil Gjuzi" çfarë do bëhet?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Fatmir Meçaj . Ne për shkollën "Qamil Gjuzi" meqenëse nuk është marrë në dorëzim ne nuk mund të ndërhyjmë dot.

Mitat Daja . Çfarë do bëhet pra?

Fatmir Meçaj . Kanë problemet e tyre presidenti i firmës me pagesap apo ku e di unë. Na kanë premtuar që do ndërhyjnë brenda kësaj jave.

Erind Tosku . Se kjo pjesa të ishin marrë masa paraprakisht...

Mitat Daja . Kemi që në Shtator që po themi këtë gjë, që në Shtator është konstatuar problemi i shkollave dhe asgjë nuk është bërë deri më sot. Po të ishte dhe Olsi aty të na tregonte afatet e veta data 16 apo 17 që na dha Olsi.

Fatmir Meçaj . Për të qenë i qartë unë e kam parasysh çfarë po ngre, juve na i keni sjellë më shkrim dhe ne i kemi përcjellë dmth e kemi marrë iniciativën që të kryhet procesi i prokurimit.

Erind Tosku . Nuk e ve në diskutim nuk e kam tek pjesa e bazës materiale, po flas tek pjesa e problematikave prizave të korentit nuk besoj që duhet procedurë për të regulluar prizën e shkollës, ndriçimin e gjëra të tjera. Këto janë gjëra si të thuash neglizhencë ose mos kushtim rëndësie, mos i kushtojmë rëndësi i bie që tani që po bie shi dhe errësohet shpejt, të mos kemi ndriçim nëpër shkolla dhe nxënësit ...

Andi Proshka . Unë jam në dijeni të problemit këto janë të pajisura me neone që ne nuk kemi gjendje.

Alime Hoxha . Janë dhe prizat.

Andi Proshka . E kam fjalën për dritat.

Erind Tosku . Përveç kësaj, shkollat kanë ngritur edhe kërkesa për festat e 28-29 Nëntorit që shkollat shyqyr që po e vitalizojnë Qendrën Kulturore "Haxhi Memolla" tani është për të ardhur keq dhe na vjen zor që nxënësit paguajnë lekë për të marrë ato kostumet me qira apo kostumet popullore për të marrë flamuj për të marrë dekorime. Kështu që nuk ka ndonjë buxhet Bashkia që të japë apo nga kërkesat që vijnë nga shkolla, që t'i japë shkollave që të bëjmë festa më të bukura. T'i angazhojmë nxënësit po i këndojmë himnin javën e parë të çdo muaji. - Dakord, pse

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

po e heqim atdhetarizmin kur kemi festat se nuk kemi mundësi?! Të paktën bën sens kjo pjesë që t'i vejmë ca gjëra që më përpara se janë fëmijët përpara pastaj jemi ne, kaq kisha.

Fatmir Meçaj . Tani sa për tek Pallati i Kulturës janë marrë të gjitha ato kërkesat se po bëhen shumë aktivitete dhe jam dakord me atë pjesën që thoni ju sepse ngelen këto kostumet të bëhen pjesë e Pallatit të Kulturës. Tani në atë vazhdimësi sepse përnjëherë nuk bëhen.

Alime Hoxha . Do ishte mirë që jo të themi ne për shkollën por të kishte kostume popullore që të jenë atje.

Andi Proshka . Disa vegla muzikore.

Enver Memolla . Vetëm Andin kam këtu nuk kam Olsin, kam vënë re që nga reshjet e shumta kohët e fundit rruga e Peqinit ka shumë puseta të bllokuara . Vetë herën e fundit desh jam aksidentuar para fabrikës "Qoshku" ishte pellg me ujë që nuk e pashë realisht nuk e di kush merret emergjencat civile apo shërbimet por realisht është diçka që ...

Andi Proshka . Pusetat duan mjete të posaçme që të pastrohen por punëtorët e shërbimit kanë qenë në terren.

Enver Memolla . Realisht është problem nuk po kërkoj llogari por duhet të gjeni një zgjidhje për këtë pjesë sepse edhe hyrja në autostradë mban ujë aty. Është një rrezik me makinë je me këmbët e huaja nuk jemi me këbët tona.

Andi Proshka . Duhet të jemi të vetëdijshëm që shirat dihet 2-3 orë zgjasin ...

Enver Memolla . Jo ato janë të bllokuara unë kam parë që ato janë të bllokuara. Pas shirave të shihen që të mos presim të bllokohen.

Indrit Dedej . Ai specialisti të çojë punonjësit se shira të rrëmbyeshëm bien dy herë tre herë.

Andi Proshka . Kanë qenë në terren.

Rezart Vogli . Unë do flisja për rastin që ngriti zysh Alimeja për shkollën "Haxhi Qehaj" gjimnazin është ngritur grupi i punës nga ana e Bashkisë para 2-3 ditësh është komunikuar me firmën që është marrë me ndërtimin e shkollës është komunikuar me mbikëqyrësin e punimeve besoj që nga dita e Hënë nga dita e Martë do kemi një takim në ambientet e shkollës bashkë me

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

drejtoreshën e shkollës dhe me mësuesit që kanë ngritur shqetësimin në këshill bashkiak. Duhet të fillojmë patjetër sistemin aty.

Alime Hoxha . Sepse aty ka dhe një problem tjetër në një klasë mbushet me ujë sa herë që bie shi. Do kemi një takim shumë shpejt besoj brenda javës që vjen. Për sa i përket Pallatit të Kulturës e kemi thënë dhe vjet në moment që u rikonstrukturua e gjithë Qendra Kulturore ne nisëm me sistemimin dhe krijimin e një klase për muzikën ku me këshillin e shkuar kemi diskutuar që dëshira jonë vazhdonte me sistemimin e atyre dy dhomave me kostumet dhe me pajisjet që do i duhej kësaj Qendre Kulturore në pamundësi për t'i realizuar këto muaj që kaluan them se do i realizojmë shumë shpejt. Dëshira jonë dhe premtimi i Kryetarit të Bashkisë ishte që ajo Qendër Kulturore të kthehet në qendër multifunksionale ashtu siçështë ajo klasë aty që ofroi ca kurse profesionale muzike, u krijua dhe biblioteka e qytetit. Ato ambiente që janë të brendshme mundësohet sistemimi bashkë me bazën materiale që janë kostumet popullore apo gjëra tjera artistike që i duhen asaj qendre. Këto kisha faleminderit.

Silvana Aliu . A mund të na jepni një datë se kur mbarojnë punimet e shkollës "Qamil Gjuzi"? Keni lënë një makineri aty dhe nxënësit luajnë aty.

Fatmir Meçaj . Nuk varet nga ne.

Andi Proshka . Ke të drejtë ne një datë nuk japim se e jep firma.

Silvana Aliu . Ne drejtori na e dha 8 Nëntorin e quajti të mbaruar.

Geraldo Gjini . Ajo siç e dini nuk duhej të futej fare në punë, ajo u bë sepse ishin të dyja shkollat që po u rikonstrukturoheshin njëkohësisht edhe u mor masa sespe firma s'duhet ta lejonte fare që të futeshin nxënësit po ku do rrinin nxënësit. Na toleruan, ne i kemi toleruar pak tek afati.

Silvana Aliu . Shkolla tjetër ka mbaruar.

Geraldo Gjini . Kishte afatin më të gjatë ajo kishte vetëm rikonstruksion që u bë nga e para. Besoj që ajo brenda këtij viti do jetë e përfunduar.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër? Atëherë meqë nuk kemi më diskutime, mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 45^{oo} . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total 02 orë ; 29 min ; 01 sek e ndarë në dy video regjistrime konkretisht video e parë 26 min ; 48 sek video e dytë 02 orë ; 02 min ; 13 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 57 (pesëdhjetë e shtatë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social

Nr.4453 Prot.

Rrogozhinë,më 15.12 2023

PROJEKT-VENDIM

Nr___dt / / 2023

"Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nentor 2023 nga fondi i Bllok-Ndihmës 6%"

Sektori i Ndihmes Ekonomike dhe Komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkise me datë 17.06.2020 me Urdherin e Brendshem Nr.159 per verifikimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 date 17.12.2015 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", Ligjin Nr. 57/2019 date 10.03.2005.Ne ligjin Nr. 57/2019 date 10.03.2005 i ndryshuar me dt.07.12.2016, pika 13 parashikohet qe: *"Keshilli Bashkiak ka te drejte te trajtoje me ndihme ekonomike familjet aplikuese te cilat nuk jane shpallur perfituese nga sistemi i pikezimit, bazuar ne vleresimin social-ekonomik te kryer nga administratori shoqeror keto familje do te trajtohen nga fondi i kushtezuar per bllok-ndihmen ekonomike deri ne 6% dhe /ose me fonde te buxhetit vendor.Menyra e dhenies se ndihmes ekonomike,per familjet qe nuk jane shpallur perfituese nga sistemi i pikezimit, percaktohet me udhezim te Ministrit pergjegjes per ceshtjet sociale.*

Këshilli i Bashkisë Rrogozhinë në mbledhjen e tij te rradhës

TE MIRATOJË:

1-Dhënien e Ndihmës Ekonomike për 21 familje sipas listës bashkengjitur këtij projektvendimi duke qënë se këta persona plotësojnë të gjitha kriteret juridike dhe ekonomike për marrjen e Ndihmës Ekonomike.

2-Fondi total prej 80`702 leke

3-Këto familje trajtohen në një listë të vecantë me fondin e 6% të bllok Ndihmës-Ekonomike.

Lista që i bashkangjitet projektvendimit në total të familjeve të propozuara në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar.

Njësia Gosë	**Shuma që perfitojnë**
1-Nexhip Sheshi	3`703leke
2-Rudin Aliu	3`703leke
3-Atlije Huqi	5`940leke
4-Dizo Veliu	3`703leke
5-Bashkim Gjoni	3`703leke
6-Xhevdet Rosa	4`752leke
Njësia Lekaj	**Shuma që përfitojnë**
1-Ali Koxha	5`227leke
2-Bashkim Shaba	3`703leke
3-Islam Doda	4`792leke
Njësia Kryevidh	**Shuma që përfitojnë**
1-Shyqyri Elezi	3`703leke

Njësia Rrogozhinë	Shuma që përfitojnë
1-Perparime Cani	2`178leke
2-Isa Tusku	3`703leke
3-Kujtime Xhafa	5`720leke
4-Hajrije Xhavara	3`703leke
5-Sami Memolla	3`703leke
6-Jeta Tosku	3`146leke
7-Brunilda Sina	5`940leke
8-Lindita Kashari	2`178leke
9-Gezim Deda	2`178leke
10-Fitnete Arapi	3`146leke
11-Prandvera Andoni	2`178leke

Per komision

Suela Proshka (Spec Ndihma Ekonomike)

Bashkim Cela (Spec Mireqenie Sociale)

Brunilda Gjuzi (Spec PAK)

KRYETAR I BASHKISE

Edison MEMOLLA

Në mungesë dhe me urdhër

N/KRYETAR

Andi ROSHKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

DREJTORIA FINANCES DHE SHERBIMIT SOCIAL

Nr.4454Prot. **Rrogozhinë,më 15.12.2023**

PROJEKT-VENDIM

Nr_____datë / / 2023

"Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2023 nga fondi I pushtetit vendor "

Komisioni I ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr 84 datë 13.02.2023 nga Kryetari I Bashkisë "Për verifikimin e familjeve që jetojnë në gjendje të vështire ekonomike " ,mbështetur në Ligjin Nr 139 datë 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" VK B Rrogozhinë "Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023" ,Ligjin Nr. 10296 ,datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin""Udhëzimi Nr.2 datë 06.02.2012 "Për Proçedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit", të nenit 21 ,të Ligjit Nr. 57/2019 ,datë 18.07.2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" ,*Vkm nr.597 ,date 4.9.2019 " Për përcaktimin e proçedurave ,të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike* Vendimit të Këshillit Nr. 03 ,datë 27.01.2020 "Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë financiare me fondet e buxhetit vendor nga Bashkia Rrogozhinë".

Keshilli i Bashkise Rrogozhine ne mbledhjen e tij te rradhes

TE MIRATOJE:

1-Dhënien e Ndihmës Ekonomike për 18 familje sipas listës bashkengjitur këtij projekt vendimi duke qënë se këta persona plotësojnë të gjitha kriteret për marrjen e Ndihmës Ekonomike,
2-Fondi total prej 81 472 leke
3-Këto familje trajtohen në një listë të vecantë me fondin Ndihma Ekonomike të Bashkisë Rrogozhinë të vitit 2023 (Llogaria 606-1004) .
Lista që i bashkangjitet projektvendimit në total të familjeve të propozuara në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin

Emër Atësi Mbiemër	Shuma	Nr.identifikimit	Vendbanimi
1.Elmaz Selman çelhaka	3060 lekë	F40518025H	Rrogozhinë
2.Luan Haxhi Shima	3060 lekë	G60912149V	Rrogozhinë
3.Xhevrije Caush Stafa	5580 lekë	G16025034N	Sinaballaj
4.Lije Sulejman Shehi	5580 lekë	G45524185E	Gosë
5.Vitore Myslim Met-hasani	4880 lekë	I25331051IU	Sinaballaj

CamScanner

6.Besnike Shemsir çoku	5780 lekë	H55826036P	Rrogozhinë
7.Gezim Hysen Kasa	3060 lekë	G60711016F	Gosë
8.Defrime Zylyf Daja	4320 lekë	G75420349A	Rrogozhinë
9.Bledi Nuredin Lusha	1800 lekë	J10717068P	Rrogozhinë
10.Liliana Beqir Duzha	3960 lekë	H55207127B	Rrogozhinë
11.Emilian Osman Gjuzi	1800 lekë	J91012042J	Rrogozhinë
12.Xhevahire Ram Gjuzi	1800 lekë	G55310094O	Rrogozhinë
13.Zenepe Lutfi Hoxha	4320 lekë	G05327040E	Lekaj
14.Altin Banush Suta	5760 lekë	I20530047G	Rrogozhinë
15.Pasionata Muhamet Xhafa	16632 lekë	I75103026N	Rrogozhinë
16.Lirije Sulejman Sinameta	3060 lekë	G05223164K	Rrogozhinë
17.Landa Abaz Meka	5220 lekë	H75221052C	Rrogozhinë
18.Ervin Banush Murrani	1800 lekë	I30206046I	Rrogozhinë

Komisioni
Ledian Hasani
Dorina Maçolli
Manjola Gjuzi

KRYETAR

Edison MEMOLLA

Në mungesë dhe me Urdhër

Ardjeldo

Andi Proshka

Nr. 3997/2 Prot
Dt. 22.12.2023

Projekt-Vendimi Paketa Fiskale për Vitin 2024

PAKETA FISKALE 2024

BASHKIA RROGOZHINË

RROGOZHINA

PËRMBLEDHËSE:

a. PROCESI I HARTIMIT TË PAKETËS FISKALE, BAZA LIGJORE	**faqe 3-4**
b. KUADRI LIGJOR	**faqe 5**
c. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL	**faqe 6**
d. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME	**faqe 6-7**
e. TAKSA E NDËRTESËS	**faqe 7-11**
f. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE	**faqe 11-12**
g. TAKSA MBI TRUALLIN	**faqe 12**
h. TAKSA E FJETJES NË HOTEL	**faqe 13**
i. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË	**faqe 13-17**
j. TAKSA E KALIMIT E SË DREJTËS SË PRONËSISË	**faqe 17-18**
k. TAKSA E TABELËS	**faqe 18-20**
l. TAKSA E MJETEVE TË PËRDORURA	**faqe 20**
m. TË ARDHURA PJESORE NGA TAKSA E RENTËS MINERARE	**faqe 21**
n. TAKSA PËR INFRASTRUKTURË NËN-TOKËSORE	**faqe 21**
o. TARIFA E PASTRIMIT DHE SHËRBIMIT (BIZNESE)	**faqe 22-25**
p. TARIFA E ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE PËR ZONËN E PLAZHIT	**faqe 25-26**
q. TAKSA E TREGUT TË LIRË	**faqe 27**
r. TARIFA E LICENSIMIT TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE	**faqe 27-28**
s. TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE	**faqe 28**
t. TARIFA PËR VULOSJE VETERINARE BAGËTIVE TË THERURA VENDE LEJUAR	**faqe 28-29**
u. TARIFA BAZË TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË, PËR LLOJET INDUSTRIALE	**,faqe 29-30**
v. TARIFA BAZË PËR VADITJEN E TOKAVE BUJQËSORE	**faqe 30**
x. TARIFA BAZË PËR KULTIVIMIN E PESHKUT NE REZERVUAR	**faqe 30**
x. NIVELET E TARIFËS PËR DHËNIE LICENSE PËR TREGTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËN-PRODUKTEVE TË SAJ	**faqe 30-31**
z. KUNDRAVAJTJET DHE MASAT E GJOBAVE	**faqe 31-32**
w. GJOBA PËR MOSSHLYERJE NË AFAT TË DETYRIMIT	**faqe 33**

PAKETA FISKALE VITI 2024

Reforma territoriale e aplikuar në vitin 2015, solli ndryshime edhe për kufijtë territorial të Bashkisë Rrogozhinë, duke përfshirë brenda saj territore tërësisht të ndryshme nga përbërja administrative, kulturore, sociale etj. Lidhur me këto ndryshime, lindi domosdoshmëria e krijimit të raporteve ndërmjet zonave në fushat e ndryshme administrative, në ruajtjen e këtyre traditave, territoreve produktive në aspektin bujqësor, në ruajtjen dhe mirëadministrimin e pyjeve, kullotave etj. Gjithashtu, për të qenë sa më pranë banorëve si dhe për të krijuar mundësi të barabarta të përfitimit të shërbimeve publike, u studiuan me prioritet llojet dhe nivelet e taksave dhe tarifave. Tashmë Bashkia Rrogozhine në tërësinë e saj, është përkushtuar për arritjen e objektivave, për realizimin e të ardhurave si dhe në shpërndarjen sa më të drejtë të buxhetit për çdo NJ/A. Sipas Ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", **Bashkia Rrogozhinë kufizohet gjeografikisht nga lindja me Bashkinë Tiranë, në perëndim nga Deti Adriatik, në veri nga Bashkia Kavajë, në jug-lindje nga Bashkia Peqin dhe në jug nga Bashkia Lushnje. Bashkia Rrogozhinë ka një sipërfaqe prej 223.5 km² tokë, me një vijë bregdetare prej 15 Km. Përbëhet nga Qyteti Rrogozhinë dhe 4 Njësi Administrative që janë: Nj/A. Gosë, Nj/A. Lekaj, Nj/A. Kryevidh dhe Nj/A. Sinaballaj, me një numër prej 39 fshatrash. Numri i familjeve në Bashkinë Rrogozhinë është 11.349 dhe me popullsi 42.732 banorë.**

Nr.	Qyteti/Njësia Administrative	Lagja/Fshati
1	Qyteti Rrogozhinë	Lagja Nr 1,Lagja Nr.2
2	Nj.A. Sinaballaj	Sinaballaj, Hasdushk, Met-hasanaj, Hamenraj, Kocaj, Thartor, Rrostej, Fliballie, Demarke.
3	Nj.A. Gosë	Gosë Qendër, Kërcukaj, Gosë e Madhe, Gosë e Vogël, Kalush, Ballaj, Vilë Bashtovë.
4	Nj.A. Lekaj	Luz i madh, Shkozet, Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Gërmenj, Okshtun, Zanbishë, Mushnikë, Mlik.
5	Nj.A. Kryevidh	Domen, Kazie, Spanesh, Stërbeg, Spille, Greth, Shardushk, Kryevidh, Rreth Greth, Ballaj, Zhabjak, Patk-Milot.

CamScanner

Procesi i Hartimit të Paketës Fiskale.

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Rrogozhinë;

- Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social.
- Drejtoria e të Ardhurâve dhe Zhvillimit Ekónomik.
- Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Mardhënieve me Publikun.
- Drejtoria e Politikave Urbane.
- Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse.
- Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve.
- Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.
- Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës dhe Sportit.
- Gjendja Civile.
- Policia Bashkiake.
- Administratorët e Njësive Administrative.

Hartimi i Paketës Fiskale 2024 kalon nepërmjet etapave si më poshtë;

- Ngritja e grupit të punës.
- Përcaktimi i bazës ligjore dhe prioriteteve strategjike të zhvillimit.
- Konsultimi propozimeve të paketës fiskale me banorët dhe grupet e interesit (bizneset).
- Miratimi nga Keshilli Bashkiak, Prefektura dhe më pas publikimi i paketës fiskale.

Çfarë prezanton paketa fiskale?

Prezanton propozimet për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qënë në linjë dhe në zbatim me prioritetet e Strategjisë së Zhvillimit në Bashkisë Rrogozhinë dhe Planit të Zhvillimit të Territorit. Propozimet konsistojnë në përmirësime teknike dhe proçeduriale, për përgatitjen e një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë. Gjithashtu synojm nje taksim dhe tarifim sa më të drejtë për të gjithë qytetarët e Bashkisë Rrogozhinë dhe atyre që ushtrojnë aktivitet privat pranë territorit të Bashkisë tonë.

Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët;

- Taksim në bazë të ligjeve.
- Tarifim i drejtë dhe i mbështetur në kosto.
- Klasifikimi dhe përcaktimi i taksave dhe tarifave që aplikohen për të gjitha kategoritë, duke nisur nga ato familjare dhe biznesi.
- Aplikimi i lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish të përjashtuar, siç parashikon ligji.

CamScanner

Kuadri ligjor dhe nënligjor

- Ligji Nr. 9632, Datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 139/2015, Datë 17.12.2015 "*Për vetqeverisjen vendore*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 68/2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9975, Datë 28.7.2008 "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9920, Datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10279, Datë 20.05.2010 "*Për kundravajtjet administrative*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9723, Datë 3.5.2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10081, Datë 23.2.2009 "*Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10304, Datë 15.7.2010 "*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*".
- Ligji Nr. 93/2015 "*Për turizmin*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9482, Datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10 465, Datë 29.9.2011 "*Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 8450, Datë 24.2.1999 "*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre*", i ndryshuar.
- Ligji. Nr. 9385, Datë 4.5.2005 "*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9693, Datë 19.3.2007 "*Për fondin kullosor*", i ndryshuar.
- Ligji Nr.8744, Datë 22.2.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10296, Datë 08/07/2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10463, Datë 22.9.2011 "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 152/2015, Datë 21.12.2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 64/2012, Datë 31.05.2012 "*Per Peshkimin*", i ndryshuar.

CamScanner

1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

- **Baza Ligjore:** Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "*Për Tatimin mbi të ardhurat*" , i ndryshuar, Kreu III. Ligji Nr. 9632, Datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, Kreu III, Neni 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19.
- **Struktura e ngarkuar për arkëtimin e tatimit:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.
- **Administrata Tatimore Qëndrore**: transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet dhe për shërbimin që kryen merr një komision, i cili është në masën 1% (një për qind) dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qëndrore.
- **Struktura e ngarkuar për kryerjen e akt-rakordimeve:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik është përgjegjëse për rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore, Durrës.

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i madh se 14.000.000 (katermbedhjete milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

- **Baza e taksës/tatimi**: Kështet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatim-paguesit me qarkullim vjetor mbi 14.000.000 lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë.
- Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatim-paguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 1. Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Shkalla tatimore	Njësia	Shkalla tatimore	
		Nj.A.Rrogozhinë	Nj.A të tjera
A. Me qarkullim vjetor nga 0 – 14.000.000 lekë	lekë/vitë	0	0
B. Me qarkullim vjetor mbi 14.000.000 lekë	lekë/vitë	15% e fitimit	15% e fitimit

Mënyra e pagesës: Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore kështet tre-mujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

2. TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME

- **Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9632, Datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, Neni 20, 21.VKM Nr. 132, Datë 7.3.2018 "*Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme" Ndërtesa*", e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës".
- **Struktura e ngarkuar për arkëtimin e Taksës mbi pasuritë e paluajtshme:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
- Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

- **Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:**

a) taksa mbi ndërtesat;
b) taksa mbi tokën bujqësore;
c) taksa mbi truallin;

- Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.
- Këshilli Bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në kufijtë plus-minus 30% të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.
- Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në Njësitë Administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat i'u bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1 deri në masën -35%, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

2a. TAKSA MBI NDERTESEN

- **Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9632, Datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, Neni 22, 22/1, 22/2, 22/3, 22/4, 22/5.
  VKM Nr. 132, Datë 7.3.2018 "*Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluatshme"Ndërtesa*", e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës".
- **Struktura e ngarkuar për arkëtimin e taksës mbi ndërtesat:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë Rrogozhinë si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

a. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.
b.Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas Ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
c.Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
ç.Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
d.Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i Taksapaguesit.

- **Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:**

a. pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
b. pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me Vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
c. ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
ç. banesat sociale në pronësi të bashkive;
d. pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
dh. ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

CamScanner

e. strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
ë. ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
f. ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
g. ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

- **Shkalla e Taksës:**

a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

- **Informacioni lidhur me taksën mbi ndërtesën**

Këshilli i Ministrave përcakton rregulla në lidhje me:
a) Natyrën dhe prioritetin e informacionit që do të përdoret në lidhje me përcaktimin e bazës së taksës mbi ndërtesat, në raste mospërputhjesh të informacionit të marrë nga burime të ndryshme;
b) Prioritetin e të dhënave që do të përdoren në lidhje me vlerën e tatueshme;

- **Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë**

a) menaxhon regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
b) udhëheq, nga pikëpamja metodologjike, në lidhje me administrimin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme;
c) vlerëson vlerën e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat me metodat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe detyrimin për taksën e pasurisë ndërtesë.

- **Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore**

a. Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:
b) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
c) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
ç) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;
d) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj;
dh) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

CamScanner

- **Sipërfaqja e prezumuar**

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;

b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me Ligjin Nr. 7652, Datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.

- **Vetëdeklarimi**

Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore,që ka në pronësi apo në përdorim.Vetëdeklarimi bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore.

- **Burimet e informacionit**

a.Të dhënat e vetëdeklaruara nga taksapaguesi mbi ndërtesën/njësinë e ndërtesës në pronësi/përdorim të tij;

b.Të dhënat e disponuara nga ZVRPP-të lidhur me vlerësimin dhe rivlerësimin e ndërtesave, si dhe titujt e pasurisë mbi to;

c.Të dhënat e zyrave të urbanistikës për lejet e dhëna të ndërtimit;

ç.Të dhënat e zyrave të noterisë për transaksionet e shitblerjeve të ndërtesave;

d.Të dhënat e ALUIZNI-t për ndërtesat në proces legalizimi;

dh.Të dhënat e siguruara nga verifikimi në terren nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore;

e.Të dhënat nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile;

ë.Të dhënat nga subjekte ekonomike që kanë kontakte me konsumatorët, si: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve apo dhe institucione të tjera të papërmendura më lart, të cilat disponojnë informacion mbi pasurinë ndërtesë/njësi ndërtese, tituj pronësie apo statusin juridik të marrëdhënies së taksapaguesit në marrëdhënien e tij me pasurinë e paluajtshme, objekt taksimi, si dhe për vetë taksapaguesin;

f.Të dhënat nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për pasuri të trajtuara me vendime të KKKP-së.

CamScanner

Aneksi 1

Tabela 2: Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qellim banimi, Bashkia Rrogozhine është 41.000 lekë/m².

			NjA Rrogozhinë		NjA të Tjera	
Nr.	**Kategoritë dhe nënkategori**	**Njësia**	**Sipas ligjit**	**Propozimi**	**Sipas ligjit**	**Propozimi**
	Ndërtesa Banimi		41000 lekë/m²		-35%	-35%
a	Çmimi për m² sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së banimit (41000 x 1.5 x 0.2% = 123/lekë/m²)	Lekë/m²/vitë	123	123	80	80
a/1	Për Nj/A. Reduktohet -35% Ndërtesa në vijën bregdetare Spille	Lekë/m²/vitë	123	123		
b	Çmimi për m² sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar e bodrum është 70% e çmimit të sipërfaqes së banimit (41000 x 70% x 0.2%)	Lekë/m²/vitë	57	57	37	37
c	Çmimi për m² sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30% e çmimit të sipërfaqes së banimit (41000 x 30% x 0.2%)	Lekë/m²/vitë	25	25	16	16
ç	Çmimi për m² sipërfaqe ndërtimi të destinuar për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim apo magazinim të mallrave industriale duke përfshirë fabrika, depo, e objekte të ngjashme është 50% e çmimit të sip.banesës (41000 x 50% x 0.2%)	Lekë/m²/vitë	41	41	27	27
d	Çmimi për m² sipërfaqe ndërtimi që përdoret për bujqësi dhe blektori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinimin e ruajtje së produkteve bujqësore e blektorale është 30% e çmimit të sip. banesës	Lekë/m²/vitë	25	25	16	16
dh	Çmimi për m² për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohen për banim është 0.05% e çmimit të referencës 41000 x 0.05%. (NJ/A – 35%)	Lekë/m²/vitë	20.5	20.5	13	13
e	Çmimi për ndërtesat e privatizuara me Ligjin Nr. 7652, Datë 23.12.1992 "Per privatizimin e ndërtesave shtetërore" i ndryshuar, çmimi për m² është 70% (41000 x 70% x 0.05%)	Lekë/m²/vitë	14	14	10	10
ë	Çmimi për të gjithë sipërfaqen ndërtimore për të cilën zhvilluesi është i paisur me leje ndërtimi por nuk ka arritur ta përfundoj atë sipas afatit është 30% (41000 x 30% x 0.2%)	Lekë/m²/vitë	25	25	16	16

CamScanner

Aneksi 2

ÇMIMET MESATARE PËR M² SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR NDËRTESAT QË NUK SHËRBEJNË PËR BANIM.

a.Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe ndërtesat tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera si: prodhim, tregtim ose edhe shërbime me pakicë.

b.Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70% (shtatëdhjetë) e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

c.Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim i hapur është 30% (tridhjetë) e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

ç.Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtim të destinuara për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industrial, duke përfshirë fabrika, depo, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50% (pesëdhjetë) e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve.

d.Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30% (tridhjetë) e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

dh.Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat ju bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 115/2014 reduktohet deri me 35% (tridhjetë e pesë), krahasuar me çmimet e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

e.Për ndërtesat e privatizuara me ligjin Nr. 7652, Datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" i ndryshuar, çmimi për metër katror është 70% (shtatëdhjet) e çmimit sipas zonave të tabelës vëtem në rastin e shitjes së parë.

2.b. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

- **Baza ligjore:** Ligji 9632, Datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, Neni 23 "Taksa mbi tokën bujqësore", ANEKSI 1.
- **Struktura e ngarkuar për arkëtimin e taksës mbi tokën bujqësore:** Sektori i Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike, Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë Rrogozhinë si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

- Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.
- Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.
- Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

CamScanner

- Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
- Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.
- Pagesat e taksës së tokës bujqësore do të kryhen dhe përllogariten në masën 70% të vlerës sipas kategorisë së tokës bujqësor kur paguhen brenda datës 30 Mars të vitit pasardhës.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon

Tabelë 3. Nivelet e taksës mbi tokën bujqësore

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Nj. e matjes	Niveli Taksës	Propozimi-30%
I	lekë/hektar/vitë	5600	3920
II	lekë/hektar/vitë	4900	3430
III	lekë/hektar/vitë	4200	2940
IV	lekë/hektar/vitë	3600	2520
V	lekë/hektar/vitë	3000	2100
VI	lekë/hektar/vitë	2400	1680
VII-X	lekë/hektar/vitë	1800	1260

2.c. TAKSA MBI TRUALLIN

- **Baza ligjore:** Ligji Nr. 9632, Datë 30.12.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", Neni 23/1, ANEKSI 2.
- **Struktura e ngarkuar për arkëtimin e taksës mbi truallin:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë Rrogozhinë,zyrat e taksave pranë Njësive Administrative

a. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit,në m^2,në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë,përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Kategoritë minimale të truallit jepen në Tabelën 4,Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

b. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

c. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Tabela 4. Nivelet e Taksës së Truallit

	Vlera e taksës në lekë/m^2/vitë	
Lloji taksës	**Për qëllime biznesi**	**Për Banim**
A. Taksë trualli	12 lekë/m^2	0.14 lekë

3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL

- **Baza ligjore:** Ligji Nr. 9632, Datë 30.12.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", Neni 26.
- **Struktura e ngarkuar për arkëtimin e taksës së fjetjes në hotel:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë Rogozhinë si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

a. Për qëllim të këtij ligji, me "hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

b. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.

c. Niveli tregues i taksës është sipas aneksit 8 bashkëlidhur këtij ligji.

d. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

e. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

ë. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Tabelë 5. Nivelet e taksës së fjetjes në hotel

Emërtimi	Nivelet e taksës
a. Hotelet 4-5 yje	105 lekë/natë/fjetje/person
b. Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomodues pavaresisht emertimit qe mban, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	35 lekë/natë/fjetje/person

4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURE

- **Baza ligjore:** Ligji Nr. 9632, Datë 30.12.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", Neni 27.

Ligji 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, Ligji Nr. 8402, Datë 10/09/1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 3, Datë 28/12/2016 të Këshillit të Ministrave "*PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE*", PËR VITIN 2016.

- **Struktura e ngarkuar për arkëtimin e taksës së Ndikimit në Infrastrukture:** Drejtoria e Politikave Urbane dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë Rrogozhinë.

- Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

CamScanner

- Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind deri 8 (tetë) për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, te kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerrë me akt nga Këshilli i Ministrave.

- **Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është:**

a. Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individi apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastructure është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit.

b. Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1 (zero pikë një) për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

c. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 (zero pikë pesë) për qind e vlerës së investimit.

d. Për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0(zero) deri në 3(tre) për qind të vlerës së investimit. Këshilli Bashkiak përcakton me vendim zonat malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi.

dh. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.E ardhura nga taksa,mblidhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet,për llogari të bashkisë,që mbulon territorin ku do bëhet investimit.

e. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

- **Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse:**

a. Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*".

b. Investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

c. Investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara si pasojë e

fatkeqësive natyrore,sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet,rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës ndikimit në infrastrukturë,sipas kësaj pikë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave

ç. investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

- **Sipas Relacionit të mësipërm Tarifat për vitin 2024 të Drejtorisë së Politikave Urbane për shërbime të ndryshme ndaj qytetarëve dhe firmave të ndërtimit janë:**

a.Taksë Aplikimi (Hapje Dosje).....2.000 lekë.

b.Tarifa për punimet që kryhen me deklaratë paraprake punimesh të jetë 2% i vlerës së preventivit.

c.Tarifa për punimet që kryhen pa deklaratë paraprake punimesh(Njoftim Kryerje Punimesh) .....5.000 lekë

d. Tarifa për tërheqje dokumentesh të njësuar me origjinalin (me përjashtim kur kerkohen nga institucionet shtetërore) . . . . 100 lekë / fletë

e. Tarifa për Vërtetimet për trajtimin me tokë bujqësore . . . . . 1.000 lekë

f. Tarifa për ndryshimin/konvertimin nga tokë Bujqësore në Truall ..... 50 lekë / m^2

g. Tarifë për trajtimin dhe shqyrtimin e kërkes / ankesave drejtuar Drejtorisë së Politikave Urbane/(Sektori i kadastres) . . . . . 2.000 lekë

h. Tarifë për proçedurë të përshpejtuar në systemin e-leje..... 20.000 lekë

Tabela.6. Nivelet e tarifave së taksës ndikimit nëinfrastrukturë

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i Taksës në %
Në mbështetje të fermerëve dhe agropërpunuesve vazhdon orientimi i tyre për prodhimet bujqësore dhe blegtorale për aplikime në grante dhe programe mbështetjeje si programi IPARD, Programi i mbështetjes së qeverisë shqiptare dhe donatorë të tjerë. Gjatë këtij viti janë orientuar dhe mbështetur me asistencë teknike për aplikime mbi 500 fermerë.

Drejtoria e Bujqësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike me mjetet e veta kanë rritur në mënyrë progressive çdo vit, masën (ml te pastruara) e kanaleve te II –ta e të III-ta të Pastruara dhe përmirësimi i kushteve në parcela është i dukshëm.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 04240

								FBA 2024-2026
Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**							
Bashkia Rrogozhinë	**Institucioni**							
Programi	04240	**Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja E konsumatorëve**						
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2021 Fakt**	**2022 Fakt**	**2023 Buxh. Fillest.**	**2023 Buxh. Pritshëm**	**2024 Plani**	**2025 Plani**	**2026 Plani**
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	1,881.00	1,608.00	1,622.00	1,980.00	2,574.0	3,346.2	4,350.1
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	300	391	419.3	425	552.5	718.3	933.7
Korrente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	11,552.50	7560	8,755.00	8,860.00	9,391.6	9,955.1	10,552.4

CamScanner

Kapitale								
		13,733.50	9,559.00	10,796.30	11,265.00	12,518.10	14,019.55	15,836.19

Komente për programin
Programi 04240: **Planifikim, menaxhim dhe administrim:** ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhura të tjera. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera dhe transferta e pakushtëzuar Specifike me një mesatare prej 100.0%. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore me: o 56.8 % në vitin 2024 o 57.2% në vitin 2025 o 57.4% në vitin 2026. Ndërsa shpenzimet korrente zënë: o 43.2% në vitin 2024 o 42.8% në vitin 2025 o 43.6% në vitin 2026. Shpenzimet kapitale zënë: o 0.0% të shpenzimeve totale për vitin 2024, 2025,2026

Funksioni 04: ÇËSHTJE EKONOMIKE

Nënfunksioni 042: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia

Programi 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Përmbajtja

PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm		
Në këtë program buxhetor Bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për sigurimin e administrimit të çështjeve dhe shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullosor, shfrytëzimin e racionalizuar të rezervave pyjore dhe kullosore, konservimin dhe zgjerimin e tyre. Bashkia siguron mikëqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore, dhënien e liçencave për prerje pemësh, ripyllëzime, kontrolle të dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë.		
04260	**Administrimi i pyjeve dhe kullotave**	☐ Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore; ☐ Konservim, zgjerim dhe shfytëzimi racionalizuari rezervave pyjore; ☐ Administrimi fondit pyjor dhe kullosor publik; ☐ Mbikëqyrje dhe disiplinimi operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh. ☐ Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë; ☐ Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore; ☐ Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore; ☐ Shpërndarja e kullotave, duke përshirë menaxhimin e

CamScanner

		kullotjes;

Qëllimi i Bashkisë për ruajtjen dhe Administrimin e pyjeve dhe kullotave është gjithmonë në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve e të gjitha shërbimet që sot ofrohen nga Bashkia me anën e punonjësve pyjorë vijon të jetë një ndër prioritetet e punës.

Bashkia Rrogozhinë disponon gjithsej 2,093.4 ha fond pyjor, 848.5 ha fond kullosor dhe 13,180.0 ha sipërfaqie toke pemtore(ullishta,vreshta,pjeshke,molle,nektarina,dhe shumë lloje të tjera pemë frutore në sasi më të vogla)

Gjithashtu Bashkia Rrogozhinë ka llogaritur në tërësi një sipërfaqie prej 16.122.0 ha në funksion të Administrimit të pyjeve dhe kullotave ku për fondin pyjor kemi 1.808 ha pyje të kontrolluara plotësisht nga Sektori Pyjor, 257.3 ha të kontrolluara nga pyjet dhe Bashkia dhe 28.1 ha të kontrolluara nga Inspektoriati pyjor Shtetëror.

Sektori i Administrimit të pyjeve dhe Kullotave përbëhet nga një Inspektor Specialist,dhe dy punonjës pyjor të cilët kanë pasur përvojën e duhur dhe janë angazhuar për përmirësimin e sistemit pyjor dhe kullosor,ndërsa për kullotat nuk kemi punonjës ose specialist të mirëfilltë por me këtë sector është marrë Drejtoria e Bujqësisë në Përgjithësi me punonjësit e saj duke përfshirë këtu edhe spërfaqen me pemëtore.këtu duhet theksuar se fond ii dhënë nga ana e Ministrisë përkatëse nuk është i mjaftueshëm,dhe Bashkia ka përballuar me fondet e saj pjesën tjetër të pagës dhe shërbimeve që bëhën në këtë sektor.

Problemi kryesor i Administrimit të pyjeve dhe Kollotave është Hyrja në fuqi e ligjit nr 57/2020 " Për pyjet" dhe mos azhornimi i akteve nënligjore u shoqërua me një vakuum në zbatimin e këtyre dispozitave.

☐ Bazuar në Ligjin 57/2020 "Përfitimet nga shfrytëzimi i produkteve jodrusore nga pylli" Bashkitë duhet të pajisnin subjektet me çertifikatë origjine, dokumenti cili duhet të miratohej nga Ministri i Turizmit e Mjedisit me udhëzim të veçantë, i cili ende nuk është miratuar, si rrjedhim u bë pengesë për realizimin e të ardhurave të parashikuar për shfrytëzimin e produkteve jo pyjore.

☐ Dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore për aktivitete të cilat lejohen nga legjislacioni pyjor, vështirësohet sepse fondi pyjor akoma nuk është regjistruar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Sfida:

☐ Administrimi, konservimi, zgjerimi dhe shfytëzimi i racionalizuari rezervave pyjore;

☐ Mbikëqyrja dhe disiplinimi i operacioneve pyjore, organizimi ose mbështetja për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrolli i dëmtuesve dhe semundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjore;

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 04260

PBA 2023-2025

Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike						
Bashkia Rrogozhinë	Institucioni						
Programi	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave					

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021 Fakt	2022 Fakt	2023 Buxh. Fillest.	2023 Buxh. Pritshëm	2024 Plani	2025 Plani	2026 Plani
Paga dhe Sigurime								

Paga	**600**	1,005.80	932.00	1.145.0	1,212.00	1,575.60	2,048.28	2,662.76
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	160.00	169.00	175.00	182.00	236.60	307.58	399.85
Korrente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	200.00	293.00	227.00	330.00	349.80	370.79	393.04
Kapitale								
		1,365.80	1,394.00	402.00	1,724.00	2,162.00	2,726.65	3,455.65

Komente për programin

Programi 04260:

Administrimi i pyjeve dhe kullotave:

ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar Specifike. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera dhe transferta e pakushtëzuar Specifike me një mesatare prej 100.0%.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore me:

- 83.82 % në vitin 2024
- 86.40% në vitin 2025
- 88.63% në vitin 2026.

Ndërsa shpenzimet korrente zënë:

- 16.18% në vitin 2024
- 13.60% në vitin 2025
- 11.38% në vitin 2026.

Shpenzimet kapitale zënë:

- 0.0% të shpenzimeve totale për vitin 2024, 2025,2026

FUNKSIONI 04: Çështjet ekonomike

Programi 04520: Rrjeti rrugor rural

Përmbajtja

PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm		
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.		
04520	**Rrjeti rrugor rural**	☐ Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, , parkime, , rrugë këmbësore etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië e njësisë së vetëqeverisjes vendore; ☐ Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rjetin rrugor nën administrimtin e njësisë vendore; ☐ Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore;

Qëllimi i Bashkisë Rrogozhinë është të bëjë përpjekje për të përmirësuar strukturën ekzizstuese të rrugëve rurale,trotuareve shesheve të caktuara nga Bashkia për mirëmbajtje dhe dhënë në përdorim të qytetarëve etj
Duke parë mundësinë e mbështetjes Buxhetore nga ana e Qeverisjes Qëndrore Bashkia Rrogozhinë duhet të vazhdojë zbatimin e projekteve për rrugët e Mbrendëshme si dhe rrugët e lagjeve sipër Hekurudhës me mundësinë edhe për të patur një Unazë për qytetin e Rrogozhinës.

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Përpjekjet e drejtuesve të Bashkisë për sigurimin e Fondeve duhet të jenë të vazhdueshme duke ditur se ekziston një studim projektim për të gjitha rrugët dhe sheshet në të gjithë teritorin e Bashkisë.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 04520

								PBA 2024-2026
Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**							
Bashkia Rrogozhinë	**Institucioni**							
Programi	04520			**Rrjeti rrugor rural**				
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2021 Fakt**	**2022 Fakt**	**2023 Buxh. Fillest.**	**2023 Buxh. Pritshëm**	**2024 Plani**	**2025 Plani**	**2026 Plani**
Paga dhe Sigurime								
Korrente								
Kapitale								
Aktive Investime	**231**	102,802.8	0.0	2,716.4	0.0	112,450.0	222,540.0	239,705.0

Komente për programin
Programi 01110: **Rrjeti Rrugor Rural:** ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar nga Buxheti i shtetit. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të transferta e pakushtëzuar me një masë prej gati 100.0%. Si rezultat i kalimit për dy vitet e fundit të pasojave të tërmetit dhe Pandemisë ,këto fonde nga Buxheti janë ndërprerë por duhet të fillojnë patjetër sepse pot ë shohësh trasfertën e Pakushtëzuar 2024 ne jemi nga të vetmet Bashki që nuk përfitojmë nga fondet buxhetore për Rrugët Rurale.

Funksioni 0: MENAXHIMI I MBETJEVE

Programi 05100: Menaxhimi i Mbetjeve
Përmbajtja
PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm		
Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtja ndaj rrezatimevë. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore		
05100	Manaxhimi i Mbetjeve	☐ Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; ☐ Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; ☐ Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve;

CamScanner

		☐ Pastrimi i rrugëve, parqeve etj. ☑ Masa mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja; ☐ Ndërtim, mirëmbajtje dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të ndotjes, si dhe masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. Administrim, mbikëqyrje, inspektim, organizim ose mbështetje e veprimtarive që lidhen me kontrollin dhe zvogëlimin e ndotjes; ☐ Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë që lidhen me uljen dhe kontrollin e ndotjes; ☐ Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit. ☑ Administrimi, kordinimi dhe monitorimi i politikave, planeve, programeve dhe buxheteve për promovimin e mbrojtjes mjedisore; ☐ Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor. ☐ Identifikim, kontroll dhe menaxhim i burimeve ujore brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

Qëllimi i Bashkisë Rrogozhinë është të bëjë përpjekje për të përmirësuar strukturën menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtesinë për përthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve

Shërbimi i pastrimit

Shërbimi i Pastrimit në Qytet dhe Njësive Administrative realizohet duke u mbështetur në Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane

☐ Në Qytet shërbimi kryhet me sipërmarrje private, sipas kontratës "Shërbimet Publike të Pastrimit,Gjelbërimit,Dekorit dhe Varrezave në Teritorin e Bashkisë Rrogozhinë ,për 5 – vite" me kontraktues privet BOE , zona qendrore pastrimit Qytet"

☐ Edhe në njësitë administrative shërbimi i pastrimit realizohet me sipërmarrje private dhe përcaktohet si zona funksionale perëndimore dhe shumë pak lindore dhe Verilindore.

Gjatë këtij viti vazhdon përmirësimi i cilësisë të shërbimit dhe rritja e performancës, e matur me vlerat e indikatorëve:

☐ Popullata rezidente e mbuluar me shërbim në qytet në raport me totalin e popullsisë;

☐ Popullata rezidente e mbuluar me shërbim në njësi administrative në raport me totalin e popullsisë njësi adminsitrative:

☐ Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuar (mbulimi kostos së shërbimit nga tarifa)

☐ Eficienca buxhetore për ofrimin e shërbimit;

☐ Buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuar (Lekë për 1 ton mbetje);

☐ Efiçienca buxhetore për ofrimin e shërbimit. Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuara;

☐ Ndyshimi në % e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve bashkiake në qytet (herë në javë);

☐ Ndryshimi në % i frekuencës së mbledhjes së mbetjeve bashkiake në njësi administrative (herë në javë);

☐ Sasia e mbetjeve urbane të grumbulluara dhe të transportuara në vendet e miratuara kundrejt numrit total të banorëve (kg për frymë);

☐ Monitorimi i shërbimit të pastrimit përmes zbatimit të procedurës standarte të veprimit mbi ofrimin e shërbimit në Bashkinë Rrogozhinë";

☐ **Problematikat e dala gjatë punës**

Në funksion të një vendimmarrje kolegjale, shuma e detyruar nga rritja e tarifës do të reflektohen në rritjen e vlerës së Kontratave respektive të ofrimit të shërbimit në Zonën Qendrore,Lindore dhe Perëndimore të Bashkisë Rrogozhinë.

CamScanner

Lagja Nr.1
a) Shtimi i pikave të grumbullimit dhe kontinierëve në Qytet;
b) Shtim pika grumbullimi nëpër lagje;
c) Kërkesë për kazanë të vecantë për disa biznese Shumice. Të shikohet mundësia nga inspektorët e lagjes për vendosjen e kontinenierëve për familjarët duke synuar eliminimin e pikave në shetitoret afër Parkut.

Lagja nr.2
a) Përsa i përket mbetjeve duhet bërë një studim më i thelluar. Plehrat nuk duhet të shihen në rrugët kryesore. Ka ardhur koha që të bëhen studime më profesionale. Jemi koshient që ky lloj planifikimi ka kosto shumë të mëdha, por duhet menduar për projekte të tilla.
b) Në rrugën në rrugën "Elbasanit" kontenierët janë gjithmonë plot. Është në Qendër të qytetit që shërben për shumë banorë.
c) Mendohet që do t'i shërbente më mirë pastrimit, vendosja e një orari të caktuar për tërheqjen e mbeturinave.
d)-Hartimi i një plani duke parë mundësinë e reduktimit të pikave të grumbullimit nga rrugët kryesore. Mundësia për t'i vendosur në rrugët e lagjes.

Njësitë Administrative :
a) Të respektohen frekuencat në zonat Lindore Pjesa e Rrugës deri në Sinaballaj dhe Zonat Perëndimore Lekaj,Gosë dhe Kryevidh të përfshira në zonën e shërbimit.
b) Pika e grumbullimit të mbetjeve e vendosur në hyrje të varrezave duhet të menaxhohet më mirë. Ka nevojë për kazanë shtesë.
c) Duhet rregulluar frekuenca e tërheqjes pranë pikës së grumbullimit të mbetjeve ne Shkolla pasi ka shpeshherë mbetje të paevaduara në orar kur ka frekuentim nga nxënësit.
d) Përsa i përket pastrimit nga mbetjet, problemi është edhe nga banorët. Problemi është me kontinierët të cilët shpesh lëvizen nga vendi i caktuar.
e) Ka nevojë në disa raste për ndërrim kontinierësh pasi janë të amortizuar
f) Është problem hedhja e mbetjeve inerte dhe pemëtore dhe lule e barishte,si dhe shpesh plehra bagëtishë në kontinierë. Nevojitet ndërgjegjësim i banorëve.
g) Qytetarët kërkojnë të njihen me rregulloren dhe kriteret e vendosjes së pikave të grumbullimit të mbetjeve. Duhet të ndërgjegjësohen banorët.
gj) Duhet të vendosen gjoba për shkelësit, deri tani nuk është penalizuar asnjë shkelës.
h) Duhet lëvizur pikat e grumbullimit të mbetjeve tek portat e Shkollës, se përbën rrezik për nxënësit. Janë disa kontinierë ku depoziton i gjithë fshati aty. Duhen shtuar pikat e grumbullimit të mbetjeve dhe kontinierë.
i) Problematike mbetet fakti që mbetjet na vijnë nga qyteti, psh tek Hekurudha. Policia duhet të gjobisë shkelësit apo të vendosë kamera për t'i zbuluar ata.
j) Është problem vendosja e pikës së grumbullimit të mbetjeve, banorët nuk i duan afër shtëpive
k) Pika e grumbullimit të mbetjeve tek Varrezat ka kazanë të dëmtuar dhe duhen ndërtuar mure rrethuese.
l) Ka nevojë për sensibilizim për kompostim se nuk duhet të hidhen mbetje bujqësore në kazane.
ll) Është problem numri i hedhjes së inerteve në Lumin Shkumbin.
m) Është problem lëvizja e kazanëve nga qytetarët dhe duhet ndërtuar pikat e grumbullimit të mbetjeve fikse që të mos lëvizen nga qytetarët.
t) Pikat e grumbullimit të mbetjeve të shkollave duhet të jenë brenda territorit të shkollave dhe të shërbejnë vetëm për shkollat.
n) Ka nevojë për sensibilizim, nuk duhet të hidhen mbetje bujqësore në kazanë. Është problem hedhja e inerteve në kanalin Kullues Peqin -Kavajë. Duhet të gjobiten shkelësit.

Mbrojtjes së mjedisit
Bashkia Rrogozhinë, në zbatim të dispozitave ligjore, Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Ligjin Nr. 124/2015 "Për efiçencën e energjisë", të ndryshuar", Ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" etj., harton plane dhe projekte për zhvillimin e politikave mjedisore për reduktimin e ndotjes në përgjithësi dhe asaj.sektoriale sipas problematikave të identifikuara.
Në zbatim të këtyre dispozitave bazuar edhe në programin buxhetor që ka parashikuar aktivitete të cilat në fund të realizimit prodhojnë dokumenta ose aktivitete, të cilat kanë si qëllim reduktimin e ndotjes.

Sfidat:
☐ Mbrojtja e mjedisit, ruajtja dhe përmirësimi i tij, parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetarëve.
☐ Bashkëpunim me të gjitha institucionet rajonale për ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimi i statusit të ruajtjes për llojet dhe habitatet që janë pjesë e mbrojtur me ligje dhe konventa të veçanta.
☐ Zvogëlimi dhe administrimi i ndotjes së mjedisit.

CamScanner

Të vlerësohet kostoja e zbatimit dhe të merren masa për zëvendësimin e bimësisë aktuale në trafik ndarëset e qytetit dhe rrethrrotullimet në të cilat sipas standardeve ndërkombëtare nuk duhet të ketë bimësi që rritet mbi 30 cm. Bimësia aktuale në disa raste nuk është në përputhje me këtë standard dhe përbën rrezik për qarkullimin e qytetarëve.

Ndërgjegjësimi mjedisor

Ndërgjegjësimi është një ndër elementët thelbësorë për mbrojtjen e mjedisit, ndaj është e rëndësishme të kontribuojmë në mbrojtjen e tij përmes organizimit dhe financimit të sa më shumë eventeve, të cilët kanë impakt të drejtpërdrejtë tek publiku. Mbrojtja e mjedisit është kthyer në një ndër prioritetet e Bashkisë për pastrimin dhe marrjen e masave për të parandaluar dhe ulur ndotjen e ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera. Për këtë Bashkia parashikon zhvillimin e aktiviteteve të parashikuar në programin buxhetor

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 05100

PBA 2024-2026								
Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**							
Bashkia Rrogozhinë	**Institucioni**							
Programi	05100	**Menaxhimi Mbetjeve**						
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2021 Fakt**	**2022 Fakt**	**2023 Buxh. Fillest.**	**2023 Buxh. Pritshëm**	**2024 Plani**	**2025 Plani**	**2026 Plani**
Paga dhe Sigurime								
Korrente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	0	0	15,300.0	15,300.0	16,300.0	16,610.0	17,656
Kapitale								

Komente për programin

Programi 05100:

Planifikim, menaxhim dhe administrim:

ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhura të tjera nga Bashkia. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera dhe transferta e pakushtëzuar me një mesatare gati 100.0%.

Funksioni 06: PLANIFIKIMI URBAN VENDOR

Programi 06140: Planifikimi Urban Vendor

Përmbajtja

PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm		
Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;		
06140	**Planifikimi Urban Vendor**	☐Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të zhvillimit urbanistik; ☐ Planifikim, administrim, zhvillim dhe kontrolli i territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; ☐ Grante, hua ose financime për të mbështetur zgjerimin, përmirësimin ose mirëmbajtjen e stokut të banesave;

CamScanner

		☐ Lëshimi i lejeve për ndërtime të reja; zhvillimi i tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore; ☐ Administrim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve të lidhura me strehimin; ☐ Shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e strehimit; ☐ Sigurimi i truallit të nevojshëm për ndërtime banesash; ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njësive banuese për publikun në përgjithësi ose për njerëz me nevoja të posaçme; eliminim i ndërtimeve të degraduara i lidhur me sigurimin e strehimit; ☐ Planifikim i përgjithshëm duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin të Planeve të Përgjithshme Vendore /Planeve të Zhvillimit Strategjik; ☐ Hartimi i planeve të zonimit dhe i rregullave të ndërtimit; ☑ Hartim, administrim, bashkërendim dhe monitorim i politikave të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve që lidhen me shërbimet për komunitetin; ☐ Administrim i çështjeve dhe shërbimeve për zhvillimin e komunitetit; ☐ Planifikimi i komuniteteve të reja ose i komuniteteve të rehabilituara.

Pikësynimi Kryesor i Bashkisë në lidhje me Programin **Planifikimi Urban Vendor** ka qenë dhe është Pasja e Projekteve të Gatshme për Investime sidomos për planet Vendore ku më pas do të merren lejet për ndërtim,dhe paraqitja e këtyre Projekteve pranë Qeverisë qëndrore për përfitime Fondesh.

Duhet thënë se Bashkia edhe me fondet e veta si nga të Ardhurat edhe nga Granti Pakushtëzuar do të planifikojë fonde për këtë Program,gjithashtu përpjekje do të bëhen për të përfituar Fonde edhe nga Donatorë të tjerë dhe FSHZH.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 06140

								PBA 2024-2026
Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**							
Bashkia Rrogozhinë	**Institucioni**							
Programi	06190				**Planifikimi Urban Vendor**			
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2021 Fakt**	**2022 Fakt**	**2023 Buxh. Fillest.**	**2023 Buxh. Pritshëm**	**2024 Plani**	**2025 Plani**	**2026 Plani**
Paga dhe Sigurime								
Korrente								
Transferta për Familje & Individë	**606**	128,373.0	449,393.0	566,278.1	425,220.0	235,000.0	0	0
Kapitale								
Aktive Stud. & projekte	**230**							
Aktive Investime	**231**	8,653.3	0	0	0	182,500.0	185,000.0	0

Komente për programin

Relacion diskutimi Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025

CamScanner

Programi 06140:Planifikimi Urban Vendor:
ka si burim financimi transfertën e kushtëzuar dhe të ardhura të tjera. Shpenzimet fieto janë shpenzime që mbulohen nga e transferta e kushtëzuar me një mesatare prej 90.0% dhe pjesa tjetër prej 10.0% mund të mbulohet nga të ardhura të tjera dhe për rastin tonë përfaqësohet nga Nënprogrami 04190

FUNKSIONI 6: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Programi 06260: Shërbimet publike vendore

Përmbajtja

PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm		
Sigurimi i ofrimit të shërbimeve publike vendore		
06260	**Shërbimet publike vendore**	□ Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; □ Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore; □ Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve; □ Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; □ Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike; □ Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore; □ Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike; □ Zhvillimi, rregullimi dhe përmirësimi i standardeve të ndriçimit rrugor. □ Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike; □ Zhvillimi, rregullimi dhe përmirësimi i standardeve të ndriçimit rrugor.

Shërbimi i Mirëmbajtjes së Varrezave Publike.
Shërbimi është kryer dhe vazhdon të kryhet me sipërmarrje private. Për këtë sipërmarrje të re, për një performace të mirë, për të qenë të gatshëm gjithmon për kryerjen e shërbimit funeral, jemi mbështetur në "Rregullorën dhe normativat e funksionimit të Varrezave Publike".

Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra
Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 72 331 m2 sipërfaqe të gjelbër, ku përfshihen 14 spërfaqie lulishteje ndër të cilat 35 331 m2 në qytet dhe 17 000 m2 lulishte . Njëkohësisht realizohet dhe mirëmbajtja e gjelbërimit rrugor në qytet dhe Nj.Ad. me 6 343 rrënjë pemësh. Ky shërbim, me kërkesa në rritje për një performancë gjithnjë e më të mirë duke rritur sipërfaqet e gjelbra, duke shtuar numrin e pemëve dekorative nëpër lulishte ashtu dhe për gjelbërim rrugor, numrin e stolave, koshave të vegjël të mbeturinave nëpër lulishtet me atraktive.

Shërbimin e dekorit publik
Shërbimin e dekorit Bashkia Rrogozhinë e realizon me burimet e veta financiare dhe është dhënë me Kontratë BOE Viola Green dh Bardhi Sh.p.k, me mjetet logjistike e fuqinë punëtore sipas Kontratës së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe

CamScanner

Infrastrukturës. Krahas punës për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, realizohet shërbimi edhe në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkisë gjatë vitit, ku ndër më kryesoret janë aktivitetet tradicionale si 14 Marsi, Dita e Luleve, Festa e Çlirimit , Festa e Pavarësisë, etj.

Shërbimi i ndriçimit

Shërbimi i ndriçimit publik të qytetit në Qytet, përfshin mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjetit të ndriçimit në qytet dhe në njësi administrative, të klasifikuar si më poshtë:

- ndriçimi i rrugëve kryesore dhe dytësore
- ndriçimi i shesheve
- ndriçimi i parqeve dhe lulishteve

Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve, arrin afërsisht 62,000 m2, nga të cilat 32,400 m2 janë të ndriçuara, ose 51.7% e sipërfaqes totale, të rrugëve dhe shesheve në qytetin e Rrogozhinës të Njësisë Administrative Gosë,Njësia Administrative Lekaj,Komplet Pjesa Bregdetare e Njësisë Administrative Kryevidh dhe një pjesë e Njësisë Administrative Sinaballaj. Sipërfaqet e lulishteve dhe brezit të gjelbërt zënë një hapësirë mbi 31,000 m2, nga të cilat 22,000 m2 janë të ndriçuara, ose 70.9% e sipërfaqes së gjelbër është e ndriçuar.

Asetet në dispozicion të shërbimit të ndriçimit publik për qytetin janë:

- Numri i pikave të furnizimit të energjisë (kabinave elektrike) që kanë kontratë 65 kontrata
- Numri i ndriçuesve të instaluar rreth 540 copë

Në territorin urban të qytetit ka 3 lloje shtyllash:

- dekorative: të cilat gjenden në zonat Parkut dhe Para Pallatit të Kulturës dhe disa zona në Qendër të Njësive Adminstrative dhe në zonën e Plazheve Spillej Kryesisht dhe Vilë Bashtovë;
- çeliku: pothuajse të gjitha të zinkuara, përbëjnë pjesën dominuese të shtyllave që shërbejnë për ndriçimin e qytetit;
- betoni: shtyllat i përkasin OSHEE, por ndriçuesit janë të Bashkisë .

Nëpërmjet shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit realizohet puna për rehabilitimin rrjetit elektrik ekzistues në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:

- Mirëmbajtje e 240 ndriçuesve të zakonshëm;
- Mirëmbajtje e 48 ndriçuesve dekorativ;
- Realizimi i pagesës për konsumin e energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative.
- Realizohen investime të reja.

Problematikat:

- Shpesh ka vështirësi në administrimin e territorit sipas rregullores së funksionimit te varrezave publike, pasi varrezat nuk kanë rrethim të plotë në pjesën e parcelave të vjetra.
  Kjo shkakton vështirësi në kontrollin e territorit dhe lëvizje të pakontrolluara të kalimtarëve dhe kafshëve.
- Në pjesën më të madhe të njësive, administrimi i varrezave bëhet nga vetë komunitetet apo nga institucionet fetare.
- Bashkia ka angazhuar punonjës të shërbimeve të varrezave të pajisur me mjete përkatëse për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave në Njësitë administrative.
- Në ndonjë nga njësitë administrative pjesë e Bashkisë Rrogozhinë, kërkohet vlerësimi dhe planifikimi për shpronësim të hapësirave të reja në funksione të shërbimit të varrezave.
- Puna e përbashkët dhe e vazhdueshme, për ruajtjen dhe administrimit e sipërfaqeve të gjelberta nga dëmtimet e personave të papërgjegjshëm.
- Në konteksin e ri territorial të Bashkisë Rrogozhinë, lind nevoja për shtrirjen e këtij shërbimi në njësitë administrative të Bashkisë si dhe rritja e cilësisë së dekorit urban në të gjitha qendrat dhe sheshet urbane.
- Nevoja për financime më të mëdha për ripërtëritjen me aksesorë të rinj bashkëkohorë për të rritur cilësinë sipas pritshmërisë së qytetarëve.
- Dëmtimi i ndriçuesve, i shtyllave zinkat dhe kapakëve nga kundravajtës. Nga aksidentet rrugore dhe amortizimi i ndriçuesve janë dëmtuar dhe kanë dalë jashtë funksioni shtylla zinkat 8 - 10 m dhe ndriçues SMART, dhe vjedhja e kapakëve dhe e kabllove elektrike.
- Faturimet e parregullta nga ana e OSHEE, ku shpesh paraqiten probleme me mbifaturime, lexim jashtë kushteve teknike si psh faturat e mujit Shtator ku temperaturat janë më të larta vinë rreth 2.5 milion dhe në Tetor vinë 1.6 milion lekë pas një kërkese llogarie më të madhe nga ana jonë.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 06260

Relacion diskutimi Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025

CamScanner

								PBA 2024-2026
Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**							
Bashkia Rrogozhinë	**Institucioni**							
Programi	06260			**Shërbimet publike vendore**				
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2021 Fakt**	**2022 Fakt**	**2023 Buxh. Fillest.**	**2023 Buxh. Pritshëm**	**2024 Plani**	**2025 Plani**	**2026 Plani**
Paga dhe Sigurime								
Korrente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	43,079.5	54,155.2	77,900.0	68,505.0	80,237.0	84,570.0	89,989.0
Kapitale								

Komente për programin
Programi 06260: **Shërbimet Publike Vendore:** ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhura të tjera. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera dhe transferta e pakushtëzuar me një mesatare prej 45.0%.

FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Programi 06370: Furnizimi me ujë dhe kanalizime

Përmbajtja

PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm		
Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Funksionimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza. Ndërtimi dhe menaxhimi i sistemit të kolektorëve, kanaleve, tubacioneve dhe pompave për të larguar të gjitha ujërat e zeza (ujin e shiut, ujërat shtëpiakë dhe ujëra të tjerë të ndotur).		
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	☐ Administrim i problemeve të furnizimit me ujë; ☐ Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë; ☐ Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnimizmit me ujë; ☐ Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë; ☐ Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë.

CamScanner

		☑ Administrim, mbikëqyrje, inspektim, vënie në funksionim ose mbështetje e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza; ☐ Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza.

Bashkia Rrogozhinë në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të saj për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve,ka pasur prioritet furnizimin me ujë të pishëm për 24 orë të Qytetit të Rrogozhinës dhe Njësive Administrative.
Për këtë arsye me fondet e Buxhetit të shtetit janë siguruar fonde për realizimin e tre projekteve të rëndësishme.

Duke qenë se kemi realizuar me fondet tona Projektin e Rrjetit Kryesor të Ujësjellësit atëherë me fondet e Buxhetit të shtetit janë alokuar fonde si më poshtë:

1. Studim Projektim Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit me kontratën nr.914 dt.03.08.2016.në vlerën 23,000 mijë lekë,përfaqësuar Operatori ekonomik Infrateck sh.p.k
2. Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Loti i I-rë me kontratën nr.3208 dt.03.08.2016.në vlerën 32,890 mijë lekë, me përfaqësues BOE përfaqësuar Integrated Technology Servises dhe Vazhdim i Lotit Të I-rë me vlerën 65,446 mijë lekë përfaqësuar nga i njëjti operator është marrë në dorëzim dhe kanë përfunduar të gjitha punimet.

3. Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Loti i II-të me kontratën nr.2449 dt.10.07.2017.në vlerën 97,486.5 mijë lekë, me përfaqësues BOE përfaqësuar nga Operatori ekonomik Hastoçi sh.p.k.,kanë përfunduar plotësisht punimet dhe janë marrë në dorëzim.

4. Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Loti i III-të me kontratën nr.2862 dt.07.08.2019.në vlerën 246,466.0 mijë lekë, me përfaqësues BOE përfaqësuar nga Operatori ekonomik Hastoçi sh.p.k. realizuar në masën 98.5% pritet marrja ne dorëzim i Projektit.

5. Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Lekaj Bashkia Rrogozhinë me kontratën nr.534/2 dt.04.02.2021.në vlerën 281,991.7 mijë lekë, me përfaqësues BOE përfaqësuar nga Operatori ekonomik Boshnjaku sh.p.k janë kryer deri tani rreth 45 % e punimeve.

6. Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Gose Bashkia Rrogozhinë me kontratën nr.1943 dt.26.04.2021.në vlerën 191,575.8 mijë lekë, me përfaqësues BOE përfaqësuar nga Operatori ekonomik Pesë Vëllezërit sh.p.k dhe janë realizuar deri tani 54 % e punimeve.

7. Ndërtimi i Rrjetit të KUZ Lagjia e Re Gosë Bashkia Rrogozhinë me kontratën nr.4693/2 dt.01.11.2020 Vlera e Kontratës 29,170.6 mijë lekë realizuar deri tani 100 % e Kontratës ndërsa edhe në terren situate e realizimit të kontratës është drejtë përfundimit.

Gjithashtu vlen të përmendet që po bëhën përpjekje për gjetje donatorësh dhe fondesh nga ana e Buxhetit të shtetit në vlerën 13,002.3 mijë lekë për fillimin e punimeve për Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Kryevidh Bashkia Rrogozhinë.Kemi një Projekt preventive të gatshëm edhe për këtë Projekt dhe presim që kërkesa e bërë nga ana e Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë të marrë zgjidhje.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 06370

	PBA 2024-2026
Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**
Bashkia Rrogozhinë	**Institucioni**

Relacion diskutimi Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025

CamScanner

Programi	06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime						
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021 Fakt	2022 Fakt	2023 Buxh. Fillest.	2023 Buxh. Pritshëm	2024 Plani	2025 Plani	2025 Plani
Paga dhe Sigurime								
Korrente								
Kapitale								
Aktive Stud. & projekte	230							
Aktive Investime	231	183,205.5	150,223.6	140,422.5	173,482.0	173,482.0	182,156.0	187,302.0

Komente për programin
Programi 06370: **Planifikim, menaxhim dhe administrim:** ka si burim financimi transfertën e kushtëzuar me një mesatare prej 100.0%.

FUNKSIONI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA

Programi 08140: Sport dhe argëtim

Përmbajtja
PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm		
Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;		
08140	**Sport dhe argëtim**	☐ Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (fusha lojërash, fusha tenisi, pishina noti, korsi vrapimi, ringje boksi, pista patinazhi, palestra etj.); mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive; Mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (struktura për qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojëra me letra, lojëra me tabelë etj.); ☐ Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe apo lojtarë ndividualë; ☐ Vënie në funksionim ose mbështetje për ambiente që përdoren për veprimtari çlodhëse (parqe, plazhe, kampingje dhe vendqëndrimet përkatëse) të ofruara në bazë jotregtare.

Bashkia Rrogozhinë, në zbatim të Ligjit 79/2017 "Për sportin", i ndryshuar, ka paraqitur në Këshill Bashkiak relacionin dhe projekt vendimin për Kthimin e "Sport Klub Egnatia" në shoqëri Aksionere.
Me VKB nr 58 datë 20.10.2017 konfirmuar nga Prefektura Tiranë nr.4582/1 prot. Dt.01.11.2017"Për kalimin e "Sport Klub Egnatia" në shoqëri Aksionere"

Sipas VKB nr. 22, datë 04.03.2020, konfirmuar nga Prefektura Tiranë nr.484/1 datë 05.03.2020 Këshilli Bashkiak ka miratuar ndarjen e Aksioneve nëpërmjet pjesëmarrësve në Aksione ku 25% i mbeten Bashkisë Rrogozhinë dhe 37.5 % të Aksioneve i ka

CamScanner

Shoqëria Italo shqiptare "Foglio Engeniering" dhe 37.5% Shoqëria "Demrozi Construksion sh.p.k" .Një Aktëmarrveshje dt.21.08.2021 ka formalizuar këtë pjesëmarrje.

Aktualisht Bashkia Rrogozhinë do vazhdojë të financojë për hapjen dhe masivizimin e sportit nëpërmjet dhe në bashkëpunim me këto shoqëri do vazhdojë t'i mbështesë si me fonde ashtu dhe me vënien në dispozicion të infrastrukturës sportive përkatëse në pronësi të saj për trajnim dhe aktivitete sportive duke ju përmbajtur aksioneve të saj.

Performance që ekipi po jep na jep të drejtën të pohojmë me kënaqësi që veprimet e Administratës së Bashkisë dhe Vendimet e Marra nga ana e Këshillit Bashkiak kanë qenë shumë të qarta nga ku Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet zgjerimit të Aktiviteteve sportive mund të sigurojë në të Ardhmen edhe të Ardhura të Kosiderueshme.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 08140

PBA 2024-2026 000/lekë

Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike							
Bashkia Rrogozhinë	Institucioni							
Programi	08140		Sport dhe argëtim					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021 Fakt	2022 Fakt	2023 Buxh. Fillest.	2023 Buxh. Pritshëm	2024 Plani	2025 Plani	2026 Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	600	448.3	442.0	960.0	960.0	1,022.0	1,287.4	1,413.6
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	50.0	84.0	168.0	168.0	179.0	281.0	323.0
Korrente								
Mallra dhe Shërbime	602	10,178.8	3,773.0	8,866.0	8,866.0	10,075.0	12,429.0	13,800.0
Kapitale								

Komente për programin
Programi 08140: **Sport dhe Argëtim:** ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhura të tjera. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera dhe transferta e pakushtëzuar me një mesatare prej 40.0%.

FUNKSIONI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA

Programi 08230: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Përmbajtja

PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm
Organizim, mbështetje e ngjarjeve kulturore në njësinë e vetëqeverisjes vendore; mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore.

CamScanner

08230	**Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturo**	☐ Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrim i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve; ☐ Mbështetja e vendeve historike. ☐ Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, e i ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytatar; ☐ Mbështetje për muzeumet, teatrot, sallat e ekspozitave; ☐ Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.); ☐ Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore; ☐ Organizim i aktiviteteve kulturore dhe promovim i identitetit kombëtar e lokal.

Bashkia Rrogozhinë në mbështetje të ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 "PËR ARTIN DHE KULTURËN" ka marrë të gjitha masat e duhura për zgjerimin e Aktiviteteve Kulturore në Qytet.

Duke Rikostruktuar Pallatin e Kulturës"Haxhi Memolla" i ka krijuar vetes dhe ka të gjitha mundësitë që të realizohen nëpërmjet këtij Institucioni aktivitete të larmishme me pjesëmarrjen e Shkollave me Programacionete tyre,të shoqateve dhe OJF si edhe duke krijuar premise edhe për sigurim të Ardhura shtesë nga këto Aktivitete.

Gjatë kitij viti pas Rikonstruksionit të Pallatit ne kemi pasur disa Aktivitete dhe mendojmë që deri në fund të vitit kjo të rritet duke promovuar shfaqie të ndryshme ,filma si edhe grumbullime për festime të ndryshme.

Sektori i Kulturës pranë Bashkisë Rrogozhinë ,organizohet si sector në Drejtorinë e Arsimit,Kulturës,Turizmit,Sportit dhe Rinisë dhe përfaqësohet nga një drejtues Përgjegjës dhe dy punonjës që për vitin 2022 janë shtuar edhe tre punonjës të tjerë.Gjithashtu në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve Kulturore si edhe të promovimit të vlerave Historike kemi edhe një qendër të rëndësishme si "Kalaja e Vilëboshtovës" e cila edhe kjo nga një projekt i Ministrisë së Kulturës për promovimin e Vlerave historike po kryhen punime ku do të dalin në pah objekte me përmbajtje historike dhe në fund të projektit do të kemi kalanë të Rikonstruktuar dhe duke ruajtur vlerat ndërtuese të kohës afër 2000 vjeçare të saj.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 08230

PBA 2024-2026 000/leke

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**							
Bashkia Rrogozhinë	**Institucioni**							
Programi	08230			**Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturo**				
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2021** Fakt	**2022** Fakt	**2023** Buxh. Fillest.	**2023** Buxh. Pritshëm	**2024** Plani	**2025** Plani	**2026** Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	1,796.5		2,429.0	2,429.0	3,858.0	4,051.0	4,254.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	169.0		341.0	341.0	645.0	677.0	711.0
Korrente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	1,009.2		2,945.0	1,780.0	2,624.0	2,755.0	2,893.0
Kapitale								
Aktive Stud. & projekte	**230**							
Aktive Investime	**231**					725.0	761.0	799.0

CamScanner

						7,852.0	8,245.0	8,657.0

Komente për programin
Programi 08230: **Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore:** ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhura të tjera. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera dhe transferta e pakushtëzuar me një mesatare prej 40.0%. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore me: o 57.34 % në vitin 2024 o 57.34% në vitin 2025 o 57.35% në vitin 2026. Ndërsa shpenzimet korrente zënë: o 33.42% në vitin 2024 o 33.41% në vitin 2025 o 33.42% në vitin 2026. Shpenzimet kapitale zënë fare pak per vitet 2024,2025,2026 kjo me disa paisje që janë parashikuar si më poshtë o 9.2%, të shpenzimeve totale për vitin 2024, 2025,2026.

FUNKSIONI 9: ARSIMI
Programi 09120: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor
Përmbajtja
PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm		
Mbështetja e arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte.		
09120	**Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor**	☑ Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës; ☐ Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve; ☐ Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore

Arsimi bazë parashkollor frekuentohet nga 1273 nxënës dhe 171 mësues dhe 14 Ndërtesa shkollore , të cilat 2 shkolla janë në qytet dhe 12 janë në njësi administrative, 105 klasa me një numër mesatar nxënësish prej 11 vetë në një klasë.
Bashkia Rrogozhinë mbulon me paga një staf mbështetës prej 47 punonjësish arsimin bazë parashkollor. Ajo mbulon shpenzimet e mirëmbajtjes, të transportit, të ngrohjes dhe sigurisë në këto shkolla ku përfshihen 14 roje dhe 19 sanitare
Kopshtet në Bashkinë Rrogozhinë janë gjithsej, 1 në qytet dhe 17 në njësitë administrative. Numri i fëmijëve që i frekuentojnë kopshtet 333 fëmijë që ka gjithsej . Dhjete fëmijë kanë braktisur shkollën dhe jënë kryesisht Jetimët dhe komuniteti rom.Bashkia Rrogozhinë shpenzon për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës. Ky staf në sistemin e kopshteve përbëhet nga 47 punonjësish nga të cilët 32 janë staf 4·edukator në çerdhe nga 18 ndërtesa.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 09120

PBA 2024-2026 000/lekë		
Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**	
Bashkia Rrogozhinë	**Institucioni**	
Programi	09120	**Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor**

Relacion diskutimi Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025

CamScanner

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021 Fakt	2022 Fakt	2023 Buxh. Fillest.	2023 Buxh. Pritshëm	2024 Plani	2025 Plani	2026 Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	600	29,466.0	29,904.0	34,935.3	33,500.0	44,756.7	46,994.6	49,344.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	5,350.3	5,866.3	7,811.3	6,250.0	7,480.3	7,854.4	8,247.0
Korrente								
Mallra dhe Shërbime	602	15,770.1	12,080.2	22,671.0	19,300.0	24,052.0	25,255.0	26,517.0
Kapitale								
Aktive Stud. & projekte	230							
Aktive Investime	231	6,000.0				6,251.0	2,781.0	2,920.0

Komente për programin

Programi 09120:

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor:

ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar Specifike dhe të ardhura të tjera. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera dhe transferta e pakushtëzuar Specifike me një mesatare prej 64.0%.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore me:

- 63.29 % në vitin 2024
- 66,17% në vitin 2025
- 66.17% në vitin 2026.

Ndërsa shpenzimet korrente zënë:

- 29.14% në vitin 2024
- 30.47% në vitin 2025
- 30.47% në vitin 2026.

Shpenzimet kapitale zënë:

- 7.60 % për vitin 2024 ,3.35%,të shpenzimeve totale për vitin 2025,2026

Funksioni 9: Arsimi N/Funksioni 092: Arsimi Parauniversitar
Programi 09230: Arsimi i mesëm

Përmbajtja
PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm

Mbështet arsimin e mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur ambientet shkollore dhe pagesën e stafit mbështetës. Programe arsimore dhe trajnim për mësuesit.

09230	**Arsimi Parauniversitar**	☐ Mirëmbajtje.e ndërtesës arsimore e sistemit shkollor parauniversitar ☐ Shpenzimet për paga për stafin mbështetës. ☐ Administrim,inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave; ☐ Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve.

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Arsimi mesëm Parauniversitar frekuentohet nga 328 nxënës dhe 28 mësues dhe 2 Ndërtesë shkollore 16 klasa me një numër mesatar nxënësish prejmë shumë 21 vetë në një klasë.

Bashkia Rrogozhinë mbulon me paga një staf mbështetës prej 8 punonjësish arsimin bazë parashkollor nga të cilët 1 sekretare 2 roje dhe 5 sanitare. Bashkia mbulon shpenzimet e mirëmbajtjes, të transportit, të ngrohjes dhe sigurisë në këto shkolla.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 09230

PBA 2024-2026 000/leke

Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike							
Bashkia Rrogozhinë	Institucioni							
Programi	09230		Arsimi Parauniversitar					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021 Fakt	2022 Fakt	2023 Buxh. Fillest.	2023 Buxh. Pritshëm	2024 Plani	2025 Plani	2026 Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	600	2,114.5	1,791.6	2,486.5	2,190.0	2,873.7	3,017.6	3,168.4
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	319.0	407.0	398.0	415.0	480.3	504.4	529.6
Korrente								
Mallra dhe Shërbime	602					532.0	559.0	587.0
Kapitale								
Aktive Stud. & projekte	230							
Aktive Investime	231			2,893.0				

Komente për programin

Programi 09230:

Arsimi i mesëm i përgjithshëm :

ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar Specifike dhe të ardhura të tjera. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera dhe transferta e pakushtëzuar Specifike me një mesatare prej 100.0%.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore me 86.3.0%:

Shpenzimet operative: 13.70%

Shpenzimet kapitale zënë:

- 0.0 % të shpenzimeve totale për vitin 2024, 2025,2026

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

FUNKSIONI 104: MBROJTJA SOCIALE
Programi 10430: Përkujdesi Social

Përmbajtja
PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm		
Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Dhënia e ndihmës në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të lehtësuar jetën e tyre të përditshme, integrimin në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre.Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Mbulimi i kostove për ofrimin e shërbimit të çerdhes prane njësive vendore për fëmijët e moshës nga 0 deri në 3 vjeç. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar; marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta		
10430	**Përkujdesi Social**	□Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari; □ Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare; □ Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore; □ Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigjenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktima të dhunës kriminale etj.); □ Përfitime në para, si kompensim page dhe pagesa të tjera për personat e varfër ose të dobët, për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë ose në situata të vështira; Përfitime në natyrë, si strehë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe vakte ushqimi dhënë personave të varfër dhe të dobët, shërbime dhe mallra për të ndihmuar personat, si kështillim, strehim ditor, ndihmë për të kryer punët e përditshme, ushqim, veshje, lëndë djegëse etj; □ Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar;

CamScanner

		☐ Përfitime monetare oše në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.); ☐ Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor; ☐ Administrim, vënie në funksionim ose mbështetje për skema të mbrojtjes shoqërore.
		☐ Administrim dhe organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore.
		☐ Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë të aftë për punë, të disponueshëm për punë, por janë të paaftë të gjejnë punësim të përshtatshëm; ☐ Pagesa për grupe pjesë në forcën e punës që marrin pjesë në skemat e trajnimit që kanë për qëllim të zhvillojnë potencialin e tyre për punësim, kompensime për humbje të punës, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të papunët, në veçanti për të papunët afatgjatë; ☐ Përfitime në natyrë, si pagesat për lëvizje dhe zhvendosje; ☐ Trajnim profesional për personat pa punë ose ritrajnim për personat që rrezikojnë të humbin vendin e punës;

Përkrahja Sociale është Organizuar në sëktor më vëtë me një Përgjegjës dhe me dy zyra.Një zyrë për Ndihmën ekonomike dhe një zyrë për PAK-un.Një specialist dhe një punonjëse janë Për ndihmën Ekonomike dhe katër punonjës të tjerë janë për PAK-un dhe për probleme të tjera koordinuese sociale.

Gjithashtu për cdo Njësi Administrative kemi nga Një specialist që merret edhe me Ndihmën Ekonomike dhe me PAK-un.

Në Këshillin Bashkiak Rrogozhinë kalojnë projektvendimet cdo Muaj për ndihmën ekonomike, për 6% e Familjeve që paguhen po nga Fondet e Ministrisë përkatëse gjithashtu kalojnë edhe Projektvendimet e për 3% që mbolohen nga Fondet tona.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 10430

PBA 2024-2026 000/lekë

Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike							
Bashkia Rrogozhinë	Institucioni							
Programi	10430		Përkujdesi Social					

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021 Fakt	2022 Fakt	2023 Buxh. Fillest.	2023 Buxh. Pritshëm	2024 Plani	2025 Plani	2026 Plani
Paga dhe Sigurime								
Korrente								
Transferta për Familje & Individë	606	134,262,1	135,283.1	138,520.0	138,520.0	141,625.0	149,273.0	158,677.0
Kapitale								

CamScanner

FUNKSIONI 106: MBROJTJA SOCIALE
Programi 10661: Strehimi Social
Përmbajtja
PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026

Vështrim i përgjithshëm		
Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.		
10430	**Përkujdesi Social**	□ Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit; □ Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; □ Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë; □ Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit; □ Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë; □ Përfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira;

Një ndër fnksionet e Bashkisë Rrogozhinë është strehimi social. Bashkia Rrogozhinë synon harmonizimin dhe bashkërendimin më efikas të shërbimeve sociale në mbështetje të grupeve sociale më në nevojë.
Ligji i ri për strehimin social ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe proçedurave administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, administrimitdhe planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm,duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore.
Bashkia Rrogozhinë ka zbatuar disa programe te strehimit social dhe ka zbatuar disa projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të strehimit të komuniteteve në nevojë siç janë:

- Subvencioni i interesave të kredisë si një instrument financiar për zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, me anë të të cilit familjet që përfitojnë banesa me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore me kushte lehtësuese.
- Granti i menjëhershëm është një tjetër instrument financiar për lehtësimin e zbatimit të Projekteve, me anë të cilit familjet që kanë përfituar banesa me kosto të ulët dhe që i përkasin disa kategorive të përcaktuar në ligj kanë të drejtë të përfitojnë një grant të menjeheshëm për të lehtësuar pagesën e kredisë.
- Subvencionimi i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale.
- Banesat sociale për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit romë, ku do të përfitojnë familje të komunitetit rome të cilët do të mbështeten për fuqizimin dhe integrimin e tyre social.

Programet e strehimit dhe projektet që synojnë përmirësimin e kushteve të strehimit, bashkëfinancohen me jo më pak se 20% të vlerës nga Bashkia Rrogozhinë.

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 10661

	PBA 2024-2026 000/leke
Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**
Bashkia Rrogozhinë	**Institucioni**

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Programi	**10661**				**Strehimi Social**			
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2021 Fakt**	**2022 Fakt**	**2023 Buxh. Fillest.**	**2023 Buxh. Pritshëm**	**2024 Plani**	**2025 Plani**	**2026 Plani**
Paga dhe Sigurime								
Korrente								
Kapitale								
Aktive Stud. & projekte	**230**							
Aktive Investime	**231**	8,653.3	0	0	0	7,000.0	8,000.0	9,000.0

Komente për programin

Programi 10661:

Përkujdesja Sociale :
ka si burim financimi transfertën e kushtëzuar. Shpenzimet Kapitale neto janë shpenzime që mbulohen kushtëzuar me një mesatare prej 80-100.0%.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë Shpenzimet për Banesa Sociale për komunitetin rom Dhe Egjyptian me 80-100.0%: ku 20% mund të kryhen shpenzime nga Bashkia Rrogozhinë.

Për Programet PBA është punuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik,në mënyrë të tillë që për cdo Program të punohet vetë nga Drejtuesi i çdo program,dhe të gjitha problematikat që ka sejcili Program paraqiten vetë nga Drejtuesi i Programit dhe i bashkëngjiten këtij Relacioni.

BUXHETI GJINOR.

Me propozim të punonjësit të Kujdesit Parësor,që ka në planin e saj të veprimit në përgjithësi Dhunën,dhe në veçanti dhunën ndaj grave si edhe shpesh herë edhe të burrave,për diskriminimin e rolit të gruas në shoqëri ,për problemet e të menduarit konservator e patriarchal,trajtimin dhe kujdesin parësor për gratë dhe vajzat,për problem të trajtimit të momografisë, të kancerit të gjirit etj.

Lind nevoja e planifikimit Afatmesëm të Buxhetit Gjinor,i cili ka si qëllim planifikimin e disa fondeve shtesë të cilat në planifikimin Buxhetor përfshihen në zërin,"të tjera shpenzime Operative" dhe është i shpërndarë në dy tre Programe ku më kryesorët janë program 01110 **"Planifikim, Menaxhim dhe Administrim" dhe "Programi 10430: Përkujdesi Social" etj.**

Gjithashtu për herë të parë këtë vit po Organizohet nga Shërbimi Social pranë Bashkisë Rrogozhinë një studim i thellë për përcaktimin e nivelit real të Varfërisë në të gjithë teritorin e Bashkisë kun ë bazë të këtij Studimi do të dilet edhe me projekte konkrete sipas mundësive që do të ofronte Bashkia nëpërmjet Këshillit Bashkiak.

PEMA E PROGRAMIT.

Një nga këqrkesat më të rëndësishme për PBA 2024-2026 është plotësimi nga ana e grupit të Menaxhimit të Programit e pemës së Programit që s'është gjë tjetër veç plotësimi i kërkesave Buxhetore që edhe këtë vit bëhet dhe kontrollohet nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS).
Kjo ka si qëllim që cdo shpenzim që do të planifikohet të kryhet do të kryhet duke plotësuar pemën e programit një për një për çdo Produkt të Programit.

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Pasi plotësohet pema e programit nga ana e çdo Drejtuesi Programi ,atëherë Sektori i Financës hedh në pasqyrat përkatëse të Instrumentit të planifikimit Financiar të gjitha të dhënat.

Bashkëngjitur këtij Relacioni janë këto Pasqyra:

1. Pasqyra e Srtukturës Organizative.
2. Pasqyra e Burimeve Buxhetore.
3. Pasqyra e të Ardhurave me Destinacion.
4. Pasqyra e Projekteve të Investimeve.
5. Detyrimet e Prapambetura deri më 31 Gusht 2023.
6. Pasqyra e Tavaneve Buxhetore.

PËR GRUPIN E MËNAXHIMIT STRATEGJIK.

Andi	**PROSHKA**	**Nënkryetar i Bashkisë**
Rezart	**VOGLI**	**Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social.**
Orges	**TOSKU**	**Drejtor i Tatimeve dhe të Ardhurave**
Olsi	**DRANGA**	**Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse.**
Gerard	**GJINI**	**Drejtor i Politikave Urbane.**
Helidon	**PLAKU**	**Drejtor Juridik & Burimeve Njerëzore.**
Fatmir	**MEÇAJ**	**Drejtor i Arsimit & Kulturës.**
Fatmir	**MURATI**	**Përgjegjës i Financës dhe Buxhetit.**
Nuredin	**TOSKU**	**Përgjegjës i Auditit të Brëndëshëm.**

TITULLARI I NJESISE PUBLIKE

EDISON MËMOLLA

Relacion diskutimi Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Nr.4515 prot

Rrogozhinë më 20 .12.2023

Relacion

Për diskutimin dhe miratimin e Projekt Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë të vitit 2024.

- **Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur Relacioni si më poshtë:**

a. Ligjit nr.115/2014 datë 31.07.2014 "Për ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"ndryshuar.
b. Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
c. Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" .
d. Ligjit nr 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"

Relacioni është përgatitur pas Përfundimit të Raportit për Buxhetin Faktik ,drejtuar nga Grupi i Punës i përbërë nga Drejtuesit Kryesorë të Bashkisë,ku bëjnë pjesë edhe Drejtorët e Drejtorive Përkatëse, është marrë inisiativa pas ardhjes jo përfundimatare e Trasfertës.

Trasferta e Pakushtëzuar për vitin 2024 nuk ka ndonjë ndryshim të madh përveç rritjes së përcaktuar më parë,por ajo që është e rëndësishme është se qeveria Shqiptare në kuadfër të rritjes së pagave ka dërguar vetëm për këtë qëllim një rritje shtesë fondi prej 12.2 milion lekë,që i korespondon një shtese në fondin e pagave prej 7-8 %.

Edhe Buxheti i vitit 2024 është i përbërë në disa ndarje kryesore që janë:

Të Ardhurat:

- **Buxheti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore viti 2024**
- **Buxheti I Pakushtëzuar për Funksionet shtesë për vitin 2024.**
- **Grantet e trashëguara nga viti 2023.(Fonde nga Granti i Pakushtëzuar Vendor dhe Funksionet Shtesë)**
- **Të ardhurat e planifikuara për vitin 2024 dhe ato të trashëguara nga viti 2023.**

CamScanner

Shpenzimet:

- **Shpenzimet për pagat dhe Sigurimet shoqërore**
- **Shpenzimet Operative për mallra e Shërbime,ku përfshihen edhe shpenzimet për këshilltarët dhe admistratorët e fshatrave dhe ndihmat për familjet në nevojë.**
- **Dhe shpenzime kapitale për shtimin dhe mirëmbajtjen e Aktiveve Kapitale nëpërmjet Investimeve.**

Buxheti i vitit 2024 do të diskutohet dhe miratohet në Këshillin Bashkiak në shifra të plota edhe pse ndarja në 3-mujorë mund të jetë për shkak të llogaritjeve edhe me paraqitje shifrore.

Problem mund të jetë ndonjë lëvizje e vogël që mund të ndodhë me gjendjen e fondeve të parrealizuar sepse akoma nuk janë saktësuar nga ana e Degës së thesarit të Ardhurat dhe grantet e parealizuara që trashëgohen për vitin 2023 që shifrat të jenë edhe në presje dhjetore.

Për këtë edhe mund të na lindë rishikimi i Pjesshëm i Buxhetit i cili nuk do të jetë një process i vështirë pasi pothuajse tërë struktura e buxhetit është tashmë e ngritur dhe do të jetë vetëm një miratim në Parim.

Baza kryesore për diskutimin dhe miratimin e Buxhetit është balancimi i të hyrave me të Dalurat ose më thjeshtë Të Ardhurat me Shpenzimet ,ai në domethënien e tij të përgjithëshme dhe në tërësinë e vet si kryesore ka dy anët e tij të cilat barazohen me njëra tjetrën ,pra të Ardhurat të balancohen me shpenzimet.

Kërkesat Buxhetore që gjithmonë janë më të mëdha se mundësitë Buxhetore, por edhe Realizimi i planifikimit në fund të vitit Ushtrimor Asnjëherë nuk është i barabartë me Faktin pasi kjo varet shumë nga mënyra e realizimit të shpenzimeve sipas Urdhër Shpenzimve dhe sidomos Çelja e të Ardhurave në sistemin e Thesarit,pasi asnjëherë nuk i afrohet planifikimit.

TE HYRAT(Të Ardhurat)

Për të Ardhurat(të hyrat gjithsej) e vitit 2024 ,kjo jo vetëm për Buxhetin e Pakushtëzuar të Qeverisjes Vendore, kemi disa burime.

1. Te Ardhura nga Grant i Trasheguar 2023 ne Shumen 27,393,258 leke
2. Vlera e Trashëguara nga të Ardhurat e Vitit 2023 në shumën 13,450,903 lekë që përfaqëson shumat e pa alokuara (celura)të të Ardhurave deri ne fund Dhjetor 2023.
3. Granti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore në shumën 208.106.000 lekë, ku përfshihet edhe granti llogaritur për shtesën e Pagave.
4. Grant iPakushtezuar I Mbetjeve Urbane ne Shumen 16,631,000 lekë

5. Grant iPakushtezuar I Mbetjeve Urbane I trashëguar nga viti 2023 ne Shumen 3,240,000 lekë.
6. Granti I Trashëguar nga Fondi I Rindërtimit per vitiń 2023 në shumën 159,377,000 lekë.
7. Të ardhurat të Planifikuara për vitin 2024 në shumën 236,749,571 lekë,kjo pasqyrohet në planin e të Ardhurave bashkëngjitur Buxhetit.Kjo është pothuajse e njëjtë me vitin e kaluar duke pësuar një ulje të lehtë,pasi kemi disa mosrelizime në planin e të Ardhurave ku edhe këtë vit më kryesori është planifimi i Lejeve të ndërtimit të cilin këtë vit e kemi ulur.

Të hyrat gjithsej janë për funksionet kryesore të veta janë në shumën 664,947,732.10 lekë ńga 471,071,000 lekë viti 2023 ose 41.2% më shume se në vitin 2023 dhe duke mos perfshirë ketu te hyrat nga Funksionet shtese ose trasfertat Sektoriale kjo ka të bëjë me një shtesë gati 11 % të Grantit dhe nga Fondet e trashëguara.

Duke e parë Grantin do të shohim se kemi një rritje të ndjeshme në krahasim se vitin e kaluar i Grantit për Bashkinë nga shuma 175,753,000 lekë për vitin 2022 në shumën 208,106,000 lekë për viti 2024 ose rreth 12.% më shumë
Këtu duhet theksuar se për vitet 2024 ka patur një shtesë për fondin e pagave në shumën 12,149,000 lekë kjo specifikisht vetëm për fondin e pagave.

Për Grantet e Funksioneve shtesë ose trasfertat sektoriale për vitin 2024 kemi:

- Të Ardhurat nga granti për vitin 2024 për Arsimin Parashkollor në shumën 43,747,000 lekë nga 40.210.000 lekë vitin e kaluar ose + 3,537,000 lekë më shumë se viti i kaluar me një rritje prej 10.9% dhe të trashëguara nga granti 2023.
- Të Ardhurat nga granti përt vitin 2024 për Arsimin Parauniversitar në shumën 2,920,000 lekë me një shtesë prej 340.000 lekë nga viti i kaluar me 11.3% rritje,dhe të trashëguara nga viti i kaluar.
- Të Ardhurat nga granti për vitin 2024 për Ujitjen dhe kullimin 11,159,000 lekë nga 10,796,000 lekëvitin e kaluar +363,000 lekë ose me 10.3% rritje 2023
- Të Ardhurat nga granti viti 2024 për Pyjet në masën 1,722,000 lekë nga 1.546.000 lekë për vitin 2023 + 304.000 lekëmë shumë ose 11.1% më shumë nga viti 2023.
- Të Ardhurat nga granti viti 2024 për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në vlerën 15,037,000 lekë 13,972,000 lekë ose me një rritje prej +1,065,000 lekëose me një rritje 10.8% më shumë nga viti 2023.

Të hyrat gjithsej janë për funksionet shtesë janë 74,585,000 lekë për vitin 2024 nga 69,104,000 lekë që ishte Granti 2023 ose gati 11.0%. Gjithashtu kemi edhe Grante të trashëguara nga Fondet Specifike nga viti 2023 në total 7,750,147 lekë të parealizuara dhe këto jepen të cpecifikuara në tabelën e Buxheteve.

Gjithsej shuma e Buxhetit për Programet Specifike është 82,335,147 lekë edhe kjo e pasqyruar në Tabelën e Buxhetit

CamScanner

Të hyrat gjithsej për vitin 2024 janë 747,282,879.10 lekë nga shuma 542,889,000 lekë në vitin 2023 dhe kjo shpjegohet me faktet që thamë më sipër.

Ne mendojmë se në hartimin e Buxhetit 2024 janë të sintetizuara disa nga detyrat kryesore Bazë të Funksionimit të Pushtetit Vendor që është shërbimi ndaj Komunitetit.

Në kuadër të zhvillimit të përgjithsëm ekonomik e financiar për Bashkinë Rrogozhinë për vitin 2023 kanë dalë në pah një sërë problemesh që mundësojnë hartimin e një plani Strategjik Zhvillimi për përballimin e situatave në dobi të komunitetit si edhe zbutjen e tyre.

Për këtë arsye Grupi i Menaxhimit Strategjik bazuar në Rregulloren e brëndëshme ka ndarë në mënyrë racionale përfundimisht detyrat funksionale për cdo drejtori, zyre dhe indivit,ku edhe shkalla e përgjegjësive do të jetë individuale.

Po paraqesim më poshtë Përshkrimin e disa Programeve më Kryesore të cilat janë të përhershme jane detya funksionale nuk ndryshojnë dhe përmirësohen nga viti në vit edhe si pasojë e rritjes së mbulimit me fonde
Si më poshtë :

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 01110 (Administrata)
Qëllimi i Bashkisë Rrogozhinë është të bëjë përpjekje për të përmirësuar strukturën menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtesinë për përthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Sfidë për vitin 2024 mbetet mundësia që do të Ofrojë Bashkia për rritjen e Pagave ,e cila edhe pse është ndihmuar nga Qeverisja qëndrore nëpërmjet fondit shtesë i mbetet Bashkisë pjesa tjetër për stimulimin e punonjësve sidomos të specialistëve të rinj të cilët mund të zgjedhin vende të tjera pune nëse paga e tyre vazhdon cdo vit tu afrohet pagës së punonjësve të thjeshte si rezultat i rritjes së pagës mesatare.

Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore ku qytetarët kanë mundësinë që të aplikojnë dhe përfitojnë shërbimin në çdo Njësi Administrative, lagje dhe Bashki qendër të gjitha shërbimet që sot ofrohen nga Bashkia, vijon të jetë një ndër prioritetet e punës.

Bashkia Rrogozhinë çdo vit përmirëson vazhdimisht kushtet normale në punë për administratën në funksion të rritjes së performancës së saj në ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit. Shërbimet mbështetëse për administratën vendore, sigurimi, planifikimi e zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të administratës vendore dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun, janë disa ndër aktivitete që buxhetohen dhe realizohen për të garantuar mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të institucionit.

Edhe Shërbimi i Gjendjes Civile që bën pjesë në këtë është funksion i deleguar në njësitë e qeverisjes vendore dhe financohet nga qeveria qendrore. Bashkia Rrogozhinë mbështet sigurimin e një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për këtë funksion.

2. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 04130(Policia Bashkiake)

Policia bashkiake kontribuon dhe ka funksion:
- Ruajtjen e rendit, të qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike brenda territorit të Bashkisë.
- Pjesëmarrjen aktive në dhënien në ndihmë të familjeve në nevojë.
- Sigurimin i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjeter shtetëror;
- Ekzekutimin dhe zbatimim e akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë.

Sfidat:
- Nevojë për më shumë bashkërendim ndërmjet institucioneve, me Drejtorinë e Policisë së shtetit.
- Rritja e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake deri ne 20-25 punonjës policie me kushtin që nëpërmjet rritjes së prezencës së tyre në disa Sektore të pa kontrolluar më parë të sigurojnë një rritje të Ardhurash në masën që justifikojnë rritjen e këtij numri.

- Duhet të shihet mundësia e lirimit të trotuareve. Zaptohen trotuaret nga bizneset. Njerëzit detyrohen të ecin në rrugë, dhe bëhet burim aksidenti. Në këto raste duhet të veprohet me forcë për lirimin e hapësirave publike (trotuare). Trotuaret bllokohen me fruta dhe perime nga ambulantët dhe njerëzit detyrohen të ecin në rrugë. Duhet të shihet me përparësi lirimi i hapësirave publike.

3. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 03280(Mbrajtja nga Zjarri dhe Shpëtimi)

☐ Ngritjen dhe zgjerimin e strukturës së vullnetarëve civilë si pjesë e rëndësishme e strukturave të mbrojtjes civile në partneritet me organizatat e shoqërisë civile.

☐ Zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë përmes aktivizimit të shërbimit të mbrojtjes civile.

☐ Përmirësimin e sigurisë publike në të gjithë territorin e Bashkisë Rrogozhinë, duke siguruar informacion publik të vazhdueshëm për rreziqet, aktivitetet e shërbimet Bashkisë, me prioritet parandalimin e situatave që cënojnë sigurinë e jetës dhe pronës së qytetarëve, bizneseve, aseteve administrative, pasurive kulturore, natyrore, etj.

☐ Vlerësimin e dëmeve nga specialistët e ngarkuar me urdhër të brendshëm dhe përllogaritjet financiare të vlerësimit për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

☐ Hartimin dhe plotësimin e dokumentacionit për dhënien e ndihmës së menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie.

☐ Kryerjen e kontrollit sistematik vjetor dhe çertifikimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin të objekteve të Bashkisë sipas prioriteteve.

☐ Blerjen e fikseve automatike të zjarrit, rimbushjen e bombolave të fikseve automatike të zjarrit për objektet institucione publike në administrim të Bashkisë Rrogozhinë.

☐ Rimbushjen e bombulave e fikseve automatike të zjarrit në shkolla, bombulave të fikseve automatike të zjarrit për rimbushje gjendje pranë MZSH- së, dhe në godinën e Bashkisë Rrogozhinë për përdorim në rast emergjence.

• Trajtimin dhe vlerësimin e akteve teknike për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin për objektet.

☐ Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për popullsinë: Shërbimi i MNZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Kjo strukturë ka kryer inspektimin, parandalimin, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrje për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave, ndërhyrje në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

4. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 04240 dhe 4260 (Ujitja Kullimi dhe Pyjet)

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit AMTP vijon punën për përditësimin e regjistrit të tokës bujqësore, kështu, bazuar dhe në Urdhërin e Kryetarit së Bashkisë ka vijuar puna për identifikimin dhe regjistrimin e të gjithë përdoruesve faktik të tokës bujqësore pasi rezultojnë ndarje, copëzime, tjetërsime të parcelave bujqësore.
Në mbështetje të fermerëve dhe agropërpunuesve vazhdon orientimi i tyre për prodhimet bujqësore dhe blegtorale për aplikime në grante dhe programe mbështetjeje si programi IPARD, Programi i mbështetjes së qeverisë shqiptare dhe donatorë të tjerë. Gjatë këtij viti janë orientuar dhe mbështetur me asistencë teknike për aplikime mbi 700 fermerë.

Drejtoria e Bujqësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike me mjetet e veta kanë rritur në mënyrë progressive çdo vit, masën (ml te pastruara) e kanaleve te II –ta e të III-ta të Pastruara dhe përmirësimi i kushteve në parcela është i dukshëm. Qëllimi i Bashkisë për ruajtjen dhe Administrimin e pyjeve dhe kullotave është gjithmonë në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve e të gjitha shërbimet që sot ofrohen nga Bashkia me anën e punonjësve pyjorë vijon të jetë një ndër prioritetet e punës.

Bashkia Rrogozhinë disponon gjithsej 2,093.4 ha fond pyjor, 848.5 ha fond kullosor dhe 13,180.0 ha sipërfaqie toke pemtore(ullishta,vreshta,pjeshke,molle,nektarina,dhe shumë lloje të tjera pemë frutore në sasi më të vogla)

Gjithashtu Bashkia Rrogozhinë ka llogaritur në tërësi një sipërfaqie prej 16.122.0 ha në funksion të Administrimit të pyjeve dhe kullotave ku për fondin pyjor kemi 1.808 ha pyje të kontrolluara plotësisht nga Sektori Pyjor, 257.3 ha të kontrolluara nga pyjet dhe Bashkia dhe 28.1 ha të kontrolluara nga Inspektoriati pyjor Shtetëror.

Sektori i Administrimit të pyjeve dhe Kullotave përbëhet nga një Inspektor Specialist,dhe dy punonjës pyjor të cilët kanë pasur përvojën e duhur dhe janë angazhuar për përmirësimin e sistemit pyjor dhe kullosor,ndërsa për kullotat nuk kemi punonjës ose specialist të mirëfilltë por me këtë sector është marrë Drejtoria e Bujqësisë në Përgjithësi me punonjësit e saj duke përfshirë këtu edhe spërfaqen me pemëtore.këtu duhet theksuar se fond ii dhënë nga ana e Ministrisë përkatëse nuk është i mjaftueshëm,dhe Bashkia ka përballuar me fondet e saj pjesën tjetër të pagës dhe shërbimeve që bëhën në këtë sektor.

CamScanner

Qëllimi i Bashkisë Rrogozhinë është të bëjë përpjekje për të përmirësuar strukturën menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtesinë për përthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve

5. Përshkrim I Përgjithshëm i Programit 04260 dhe 05100 (Pastrimi ,Gjelbërimi dhe Mbetjet Urbane)

Shërbimi i Pastrimit në Qytet dhe Njësive Administrative realizohet duke u mbështetur në Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane

□ Në Qytet shërbimi kryhet me sipërmarrje private, sipas kontratës "Shërbimet Publike të Pastrimit,Gjelbërimit,Dekorit dhe Varrezave në Teritorin e Bashkisë Rrogozhinë ,për 5 – vite" me kontraktues privet BOE , zona qendrore pastrimit Qytet"

□ Edhe në njësitë administrative shërbimi i pastrimit realizohet me sipërmarrje private dhe përcaktohet si zona funksionale perëndimore dhe shumë pak lindore dhe Verilindore.

Gjatë këtij viti vazhdon përmirësimi i cilësisë të shërbimit dhe rritja e performancës, e matur me vlerat e indikatorëve:
□ Popullata rezidente e mbuluar me shërbim në qytet në raport me totalin e popullsisë;
□ Popullata rezidente e mbuluar me shërbim në njësi administrative në raport me totalin e popullsisë njësi adminsitrative:
□ Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuar (mbulimi kostos së shërbimit nga tarifa)
□ Eficienca buxhetore për ofrimin e shërbimit;
□ Buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuar (Lekë për 1 ton mbetje);
□ Efiçienca buxhetore për ofrimin e shërbimit. Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuara;
□ Ndyshimi në % e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve bashkiake në qytet (herë në javë);
□ Ndryshimi në % i frekuencës së mbledhjes së mbetjeve bashkiake në njësi administrative (herë në javë);
□ Sasia e mbetjeve urbane të grumbulluara dhe të transportuara në vendet e miratuara kundrejt numrit total të banorëve (kg për frymë);
□ Monitorimi i shërbimit të pastrimit përmes zbatimit të procedurës standarte të veprimit mbi ofrimin e shërbimit në Bashkinë Rrogozhinë";

Problematikat e dala gjatë punës
Në funksion të një vendimmarrje kolegjale, shuma e detyruar nga rritja e tarifës do të reflektohen në rritjen e vlerës së Kontratave respektive të ofrimit të shërbimit në Zonën Qendrore,Lindore dhe Perëndimore të Bashkisë Rrogozhinë.

Lagja Nr.1
a) Shtimi i pikave të grumbullimit dhe kontinierëve në Qytet;
b) Shtim pika grumbullimi nëpër lagje;
c) Kërkesë për kazanë të vecantë për disa biznese Shumice. Të shikohet mundësia nga inspektorët e lagjes për vendosjen e kontinenierëve për familjarët duke synuar eliminimin e pikave në shetitoret afër Parkut.

Lagja nr.2
a) Përsa i përket mbetjeve duhet bërë një studim më i thelluar. Plehrat nuk duhet të shihen në rrugët kryesore. Ka ardhur koha që të bëhen studime më profesionale. Jemi koshient që ky lloj planifikimi ka kosto shumë të mëdha, por duhet menduar për projekte të tilla.
b) Në rrugën në rrugën "Elbasanit" kontenierët janë gjithmonë plot. Është në Qendër të qytetit që shërben për shumë banorë.
c) Mendohet që do t'i shërbente më mirë pastrimit, vendosja e një orari të caktuar për tërheqjen e mbeturinave.
d) Hartimi i një plani duke parë mundësinë e reduktimit të pikave të grumbullimit nga rrugët kryesore. Mundësia për t'i vendosur në rrugët e lagjes.

Njësitë Administrative :
a) Të respektohen frekuencat në zonat Lindore Pjesa e Rrugës dejri në Sinaballaj dhe Zonat Perëndimore Lekaj,Gosë dhe Kryevidh të përfshira në zonën e shërbimit.
b) Pika e grumbullimit të mbetjeve e vendosur në hyrje të varrezave duhet të menaxhohet më mirë. Ka nevojë për kazanë shtesë.
c) Duhet rregulluar frekuenca e tërheqjes pranë pikës së grumbullimit të mbetjeve ne Shkolla pasi ka shpeshherë mbetje të paevaduara në orar kur ka frekuentim nga nxënësit.
d) Përsa i përket pastrimit nga mbetjet, problemi është edhe nga banorët. Problemi është me kontinierët të cilët shpesh lëvizen nga vendi i caktuar.
e) Ka nevojë në disa raste për ndërrim kontinierësh pasi janë të amortizuar

CamScanner

f) Është problem hedhja e mbetjeve inerte dhe pemëtore dhe lule e barishte,si dhe shpesh plehra bagëtishë në kontinierë. Nevojitet ndërgjegjësim i banorëve.

g) Qytetarët kërkojnë të njihen me rregulloren dhe kriteret e vendosjes së pikave të grumbullimit të mbetjeve. Duhet të ndërgjegjësohen banorët.

gj) Duhet të vendosen gjoba për shkelësit, deri tani nuk është penalizuar asnjë shkelës.

h) Duhet lëvizur pikat e grumbullimit të mbetjeve tek portat e Shkollës, se përbën rrezik për nxënësit. Janë disa kontinierë ku depoziton i gjithë fshati aty. Duhen shtuar pikat e grumbullimit të mbetjeve dhe kontinierë.

i) Problematike mbetet fakti që mbetjet na vijnë nga qyteti, psh tek Hekurudha. Policia duhet të gjobisë shkelësit apo të vendosë kamera për t'i zbuluar ata.

j) Është problem vendosja e pikës së grumbullimit të mbetjeve, banorët nuk i duan afër shtëpive

k) Pika e grumbullimit të mbetjeve tek Varrezat ka kazanë të dëmtuar dhe duhen ndërtuar mure rrethuese.

l) Ka nevojë për sensibilizim për kompostim se nuk duhet të hidhen mbetje bujqësore në kazane.

ll) Është problem numri i hedhjes së inerteve në Lumin Shkumbin.

m) Është problem lëvizja e kazanëve nga qytetarët dhe duhet ndërtuar pikat e grumbullimit të mbetjeve fikse që të mos lëvizen nga qytetarët.

t) Pikat e grumbullimit të mbetjeve të shkollave duhet të jenë brenda territorit të shkollave dhe të shërbejnë vetëm për shkollat.

n) Ka nevojë për sensibilizim, nuk duhet të hidhen mbetje bujqësore në kazanë. Është problem hedhja e inerteve në kanalin Kullues Peqin -Kavajë. Duhet të gjobiten shkelësit.

Të vlerësohet kostoja e zbatimit dhe të merren masa për zëvendësimin e bimësisë aktuale në trafik ndarëset e qytetit dhe rrethrrotullimet në të cilat sipas standardeve ndërkombëtare nuk duhet të ketë bimësi që rritet mbi 30 cm. Bimësia aktuale në disa raste nuk është në përputhje me këtë standard dhe përbën rrezik për qarkullimin e qytetarëve.

Ndërgjegjësimi mjedisor

Ndërgjegjësimi është një ndër elementët thelbësorë për mbrojtjen e mjedisit, ndaj është e rëndësishme të kontribuojmë në mbrojtjen e tij përmes organizimit dhe financimit të sa më shumë eventeve, të cilët kanë impakt të drejtpërdrejtë tek publiku. Mbrojtja e mjedisit është kthyer në një ndër prioritetet e Bashkisë për pastrimin dhe marrjen e masave për të parandaluar dhe ulur ndotjen e ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera. Për këtë Bashkia parashikon zhvillimin e aktiviteteve të parashikuar në programin buxhetor

6. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 06370 (Investime për Sitemin Ujor)

Bashkia Rrogozhinë në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të saj për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve,ka pasur prioritet furnizimin me ujë të pishëm për 24 orë të Qytetit të Rrogozhinës dhe Njësive Administrative.
Për këtë arsye me fondet e Buxhetit të shtetit janë siguruar fonde për realizimin e tre projekteve të rëndësishmepër furnizimin me ujë dhe një Projekt për Reabilitimin e KUZ.

Duke qenë se kemi realizuar me fondet tona Projektin e Rrjetit Kryesor të Ujësjellësit atëherë bashkë me fondet tona dhe me fondet e Buxhetit të shtetit janë realizuar fonde Investimesh si më poshtë:

1. Studim Projektim Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit me kontratën nr.914 dt.03.08.2016.në vlerën 23,000 mijë lekë,përfaqësuar Operatori ekonomik Infrateck sh.p.k
2. Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Loti i I-rë me kontratën nr.3208 dt.03.08.2016.në vlerën 32,890 mijë lekë, me përfaqësues BOE përfaqësuar Integrated Technology Servises dhe Vazhdim i Lotit Të I-rë me vlerën 65,446 mijë lekë përfaqësuar nga i njëjti operator është marrë në dorëzim dhe kanë përfunduar të gjitha punimet.

3. Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Loti i II-të me kontratën nr.2449 dt.10.07.2017.në vlerën 97,486.5 mijë lekë, me përfaqësues BOE përfaqësuar nga Operatori ekonomik Hastoçi sh.p.k.,kanë përfunduar plotësisht punimet dhe janë marrë në dorëzim.

4. Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Loti i III-të me kontratën nr.2862 dt.07.08.2019.në vlerën 246,466.0 mijë lekë, me përfaqësues BOE përfaqësuar nga Operatori ekonomik Hastoçi sh.p.k. realizuar në masën 98.5% pritet marrja ne dorëzim i Projektit.

5. Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Lekaj Bashkia Rrogozhinë me kontratën nr.534/2 dt.04.02.2021.në vlerën 281,991.7 mijë lekë, me përfaqësues BOE përfaqësuar nga Operatori ekonomik Boshnjaku sh.p.k janë kryer deri tani rreth 38.5 % e punimeve.

CamScanner

6. Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Gose Bashkia Rrogozhinë me kontratën nr.1943 dt.26.04.2021.në vlerën 191,575.8 mijë lekë, me përfaqësues BOE përfaqësuar nga Operatori ekonomik Pesë Vëllezërit sh.p.k dhe janë realizuar deri tani 45.3 % e punimeve.

7. Ndërtimi i Rrjetit të KUZ Lagjia e Re Gosë Bashkia Rrogozhinë me kontratën nr.4693/2 dt.01.11.2020 Vlera e Kontratës 29,170.6 mijë lekë realizuar deri tani 95 % e Kontratës

Gjithashtu vlen të përmendet që po bëhën përpjekje për gjetje donatorësh dhe fondesh nga ana e Buxhetit të shtetit në vlerën 13,002.3 mijë lekë për fillimin e punimeve për Rikonstruksion Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit Të Mbrëndëshëm të Ujësjellësit Kryevidh Bashkia Rrogozhinë.Kemi një Projekt preventive të gatshëm edhe për këtë Projekt dhe presim që kërkesa e bërë nga ana e Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë të marrë zgjidhje.

6. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 09120 dhe 09230 (Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar)

Arsimi bazë parashkollor frekuentohet nga 1273 nxënës dhe 171 mësues dhe 14 Ndërtesa shkollore , të cilat 2 shkolla janë në qytet dhe 17 janë në njësi administrative, 105 klasa me një numër mesatar nxënësish prej 10 vetë në një klasë.
Bashkia Rrogozhinë mbulon me paga një staf mbështetës prej 47 punonjësish arsimin bazë parashkollor. Ajo mbulon shpenzimet e mirëmbajtjes, të transportit, të ngrohjes dhe sigurisë në këto shkolla.
Kopshtet në Bashkinë Rrogozhinë janë gjithsej, 1 në qytet dhe 17 në njësitë administrative. Numri i fëmijëve që i frekuentojnë ato është 333 fëmijë nga rreth 800 fëmijë që ka gjithsej gjithsej janë 32 edukatore kopshti dhe një punonjëse sociale. Ky staf në sistemin e kopshteve përbëhet nga 47 punonjësish nga të cilët 36 janë staf edukator dhe 11 janë staf mbështetës.
Në këtë program janë planifikuar të mbështeten dhe rikontruksionin e strukturave shkollore dhe konkretisht 3 shkolla në qytet dhe 26 në Njësitë Administrative.
Nga Fondet e Rindërtimit janë realizuar tre projekte të rëndësishme për Shkollat të cilat u konsideruan të dëmtuara nga tërmeti që kanë përmirësuar shumë si Strukturën e Brëndëshme por edhe strukturat e Jashtëme si me oborre të vijëzuara dhe Palestra.

Arsimi mesëm Parauniversitar frekuentohet nga 328 nxënës dhe 28 mësues dhe 2 Ndërtesë shkollore 16 klasa me një numër mesatar nxënësish prejmë shumë 21 vetë në një klasë.

Bashkia Rrogozhinë mbulon me paga një staf mbështetës prej 4 punonjësish arsimin bazë parashkollor. Ajo mbulon shpenzimet e mirëmbajtjes, të transportit, të ngrohjes dhe sigurisë në këto shkolla.

Orientimi afatgjatë ngelet i pandryshuar sepse është sanksionuar në Strategjinë e zhvillimit Strategjik të miratuar edhe ne Këshillin Bashkiak disa vite më parë ku të gjithë treguesit janë Afatgjatë.
Duke menduar se në Programet e mësipërme janë përmbledhur pothuajse të gjitha çështjet kryesore të drejtimit dhe menaxhimit të situatave dhe nevojave të ndrydhme gjatë ushtrimit të detyrave funksionale gjithashtu të rëndësishme kanë qenë:

- Kultura dhe aktivitetet Artistike
- Sporti që është shumë i rëndësishëm
- Si edhe ,axhenda turistike,agroturistike dhe agrokulturore kulturore historike.

Që janë programe në të cilat Bashkia kontribuon në plotësimin e disa kërkesave bazë dhe ndihmëse.

Po kalojmë tani në detaje zbërthimin e shifrave Buxhetore.

Buxheti i i Vitit 2023 sipas shumave totale.

Buxheti total i të Ardhurave është si më poshtë:

- të ardhura nga granti i vitit 2023.....190.010.258 lekë
- të ardhura të trashëguara nga viti 2023 .....13.450.903 lekë
- të ardhura nga Granti i Pakushtëzuar viti 2024.....208.106.000 lekë
- Granti i pakushtezuar per Mbetjet Urbane viti 2024.....16.631.000 leke
- të ardhura nga Granti i Pakushtëzuar Funksione shtesë 2024.....74.585.000 lekë
- të ardhura nga Granti i Pakushtëzuar trash.Funks. shtesë 2023.....7.750.147 lekë
- të ardhura Planifikuar viti 2023.....236.749.571 lekë

CamScanner

TOTALI 747.282.879 lekë

- Buxheti total për sa i përket Shpenzimevefillimisht për fondet e Veta është si më poshtë:

Për Programin 01110 Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi

Fonde të planifikuara nga Granti 2024

1	00/1110/01	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	Paga	600	**76313707.02**
	00/1110/01		Sigurime	601	**11873120**
	00/1110/01		Operative	602	**23166874.8**
	00/1110/01/Q		Operative	604	**0**
	00/1110/01		Operative	606	**695508**
	00/1110/f.kontigj.		Operative	609	**0**
	00/1110/ emergj..		Operative	609	**4109700**
	00/1110/Fondi Rez.		Operative	609	**0**
	00/1110/01		Projekte	230	**1140000**
	00/1110/01		Investime	231	**20233860**
TOTALI					**137532769.8**

Fonde te planifikuara nga granti i Trasheguar 2023

1	00/1110/	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	Paga	600	**6600370**
	00/1110/		Sigurime	601	**1104000**
	00/1110/		Investime	231	**12411480**
TOTALI					**201158500**

Fonde të planifikuara nga Të Ardhurat e Trashëguara 2023

1	00/1110/	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	Paga	600	**271903.1**
	00/1110/		Sigurime	601	**1287000**
	00/1110/		Operative	602	**240000**
	00/1110/		Investime	231	**4602000**
TOTALI					**6400903**

Fonde të planifikuara nga Të Ardhurat 2024

1	00/1110/05	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	Paga	600	**82676325.88**
	00/1110/05		Sigurime	601	**13434440**
	00/1110/05		Operative	602	**12569155.12**
	00/1110/05/Q		Operative	604	**1560600**
	00/1110/05		Operative	606	**2913720**

CamScanner

	00/1110/f.kontigj.		Operative	609	**10523520**
	00/1110/ emergj..		Operative	609	**10500000**
	00/1110/Fondi Rez.		Operative	609	**5741304**
	00/1110/05		Projekte	230	**4960000**
	00/1110/05		Investime	231	**46519365**
TOTALI					**191398430**

Për Programin 08140 Sport dhe Argëtim

Fonde të planifikuara nga Granti 2024

2	00/8140/	Sporti dhe Argetimi	Paga	600	**0**
	00/8140/		Sigurime	601	**0**
	00/8140/		Operative	602	**5541540**
TOTALI					**5541540**

Fonde të planifikuara nga Të Ardhurat 2024

2	00/8140/05	Sporti dhe Argetimi	Paga	600	**0**
	00/8140/05		Sigurime	601	**0**
	00/8140/05		Operative	602	**6610860**
TOTALI					**6610860**

Për Programin 08230 Trashëgimia Kulturore,Eventet Artistike dhe Kulturore

Fonde të planifikuara nga Granti 2024

3	00/8230/	Trasheg.Kulturore evente Artist.dhe Kult.	Paga	600	**1788660**
	00/8230/		Sigurime	601	**337440**
	00/8230/		Operative	602	**2154600**
TOTALI					**4280700**

Fonde të planifikuara nga Të Ardhurat 2024

3	00/8230/05	Trasheg.Kult. evente Artist.dhe Kult.	Paga	600	**3343512**
	00/8230/05		Sigurime	601	**519619**
	00/8230/05		Operative	602	**882200**
TOTALI					**4745331**

Për Programin 06260 Shërbimet Publike Vendore

Fonde të planifikuara nga Granti 2024

4	00/6260/ P	Sherbime Publike Vendore	Operative	602	42419400

Fonde te planifikuara nga granti I Trasheguar 2023

4	00/6260/ P	Sherbime Publike Vendore	Operative	602	3500000

Fonde të planifikuara nga Të Ardhurat e Trashëguara 2023

4	00/6260/ P	Sherbime Publike Vendore	Operative	602	4000000

Fonde të planifikuara nga Të Ardhurat 2024

4	00/6260/05/ P	Sherbime Publike Vendore	Operative	602	22128400

Për Programin 05100 Menaxhimi i mbetjeve

Fonde të planifikuara nga Granti 2024

5	TOTALI				16300000
	00/5100/01	602	Operative		16300000

Fonde të planifikuara nga Granti I trashëguar 20232024

5	TOTALI				3240000
	00/5100/01	602	Operative		3240000

Për Programin 03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile nga fondet e Bashkisë

Fonde të planifikuara nga Granti 2024

6	00/3280/	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile.	Operative	600	2039850.18

Fonde të planifikuara nga të Ardhurat 2024

6	00/3280/05	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile.	Paga	600	438350
	00/3280/05		Sigurime	601	405540
	00/3280/05		Operative	602	6338844
TOTALI					7182734

Për Programin 09120 dhe 09230 Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar nga Fondet e Bashkisë

Fonde të planifikuara nga Granti 2024

7	00/9120/	Arsimi Baze Dhe Parashkollor	Operative	602	**16291740**

Fonde te planifikuara nga granti i Trasheguar 2023

7	00/9120/		Operative	602	**1200000**

Fonde të planifikuara nga Të Ardhurat e Trashëguara 2023

7	00/9120/		Operative	602	**1050000**

Fonde te planifikuara nga Të Ardhurat 2024

7	00/9120/05		Operative	602	**879730**

Fondi total i Burimeve të veta 445,866,600 lekë.

Të dhënat e treguesve Buxhetorë për Funksionet Specifike janë si më poshtë:

Për Programin 4240 Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit.

Fonde të planifikuara nga Granti Specifik 2024

1	00/4240/01	Menaxhimi i Infrastr.Ujore dhe kullimi	Paga	600	**1817020**
	00/4240/01		Sigurime	601	**303190**
	00/4240/01		Operative	602	**9038790**
TOTALI					**11159000**

Fonde te planifikuara nga granti i Trasheguar 2023

1	00/4240/01	Menaxhimi i Infrastr.Ujore dhe kullimi	Paga	600	**1605265**
	00/4240/01		Sigurime	601	**183015**
	00/4240/01		Operative	602	**989128**
TOTALI					**2777408**

Për Programin 4260 Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave.

Fonde të planifikuara nga Granti Specifik 2024

2	00/4260/01	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	Paga	600	**1268580**
	00/4260/01		Sigurime	601	**203420**
	00/4260/01		Operative	602	**250000**
TOTALI					**1722000**

Fonde te planifikuara nga granti i Trasheguar 2023

2	00/4260/01	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	Paga	600	**75946**

CamScanner

	00/4260/01		Sigurime	601	0
	00/4260/01		Operative	602	151544
TOTALI					227490

Për Programin 09120 Arsimi Bazë dhe Parashkollor.

Fonde të planifikuara nga Granti Specifik 2024

3	00/9120/01	Arsimi Baze Dhe Parashkollor	Paga	600	37491000
	00/9120/01		Sigurime	601	6256000
TOTALI					43747000

Fonde te planifikuara nga granti i Trasheguar 2023

3	00/9120/01	Arsimi Baze Dhe Parashkollor	Paga	600	2209333
	00/9120/01		Sigurime	601	936087
	00/9120/01		Operative	602	1000000
TOTALI					4145420

Për Programin 09230 Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm.

Fonde të planifikuara nga Granti Specifik 2023

4	00/9230/01	Arsimi i Mesem e i Pergjithshem	Paga	600	2502440
	00/9230/01		Sigurime	601	417560
TOTALI					2920000

Fonde te planifikuara nga granti i Trasheguar 2023

4	00/9230/01	Arsimi i Mesem e i Pergjithshem	Paga	600	156529
	00/9230/01		Sigurime	601	1176
TOTALI					157705

Për Programin 03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile.

Fonde të planifikuara nga Granti Specifik 2024

5	00/3280/01	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile.	Paga	600	11575499
	00/3280/01		Sigurime	601	1931501
	00/3280/01		Operative	602	1530000
TOTALI					15037000

Fonde te planifikuara nga granti i Trasheguar 2023

5	00/3280/01	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile.	Paga	600	371320

CamScanner

	00/3280/01	Sigurime	601	70804
	00/3280/01	Operative	602	0
TOTALI				442124

Gjithsej shuma për shpenzimet nga Funksionet shtesë 82.753.000 lekë
Kurse sic thamë më lartë në total Fondi i Shpenzimeve Nga Fondet e veta është 664,947,702.10 lekë i cili balancohet me të Ardhurat dhe është e paraqitur shumë saktë në tabelën e Buxhetit bashkëngjitur Projektbuxhetit.

Për një krahasim për përqindjën që zënë fondet në Totalin e Përghithshëm të Buxhetit paraqiten në tabelat e mëposhtëme:

BUXHETI I PARASHIKUAR TOTAL 2024

	Funksioni	600 Pagat	601 Kontrib.e Sigurimeve Shoqerore	602 Malra dhe Sherbime	604 Te Tjera Transferta Korrente Brendshme	609 Shpenzime peremergjenca+kontigjenca+fondi rezerve	606 Transferta per Buxhetet Familiare dhe Individet	230 Shpenzime Kapitale te Patrupez. PROJEKTE	231 Shpenzime Kapitale te Trupezuara	Totali Totali
01	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	165,862,306.00	27,698,560.00	35,976,029.92	1,560,600.00	30,874,524.00	3,609,228.00	6,100,000.00	83,766,705.00	355,447,952.92
02	Trasheg.Kulturore evente Artist.dhe Kult.	5,132,172.00	857,059.00	3,036,800.00						9,026,031.00
03	Sporti dhe Argetimi			12,152,400.00						12,152,400.00
04	Arsimi Baze Dhe Parashkollor			19,221,470.00						19,221,470.00
05	Arsimi Baze Dhe Parashkollor	39,700,333.00	7,192,087.00	1000000.00						46,892,420.00
06	Arsimi i Mesem e i Pergjithshem	2,658,969.00	418,736.00						-	3,077,705.00
07	Menaxhimi i Infrastr.Ujore dhe kullimi F.Veta	1,605,265.00	183,015.00	6,192,310.00						7,980,590.00
08	Menaxhimi i Infrastr.Ujore dhe kullimi	3,422,285.00	486,205.00	10,027,918.00						14,936,408.00
09	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave F.Veta	205,560.00	34,344.00	361,000.00	-		-		-	600,904.00
10	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	1,344,526.00	203,420.00	401,544.00						1,949,490.00
11	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	2,478,200.18	405,540.00	6,338,844.00						9,222,584.18
12	Mbrojtja nga Zjarri dhe	11,946,819.00	2,002,305.00	1,530,000.00						15,479,124.00

	Mbrojtja Civile									
13	Sherbime Publike Vendore	-		72,047,800.00		-		-		72,047,800.00
14	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane			19,871,000.00						19,871,000.00
	TOTALI	234,356,435.18	39,481,271.00	187,157,115.92	1,560,600.00	30,874,524.00	3,609,228.00	6,100,000.00	83,766,705.00	586,905,879.10

Më poshtë po bëjmë një ndarje shpenzimesh sipas përcaktimit Buxhetor për Funksionete e veta dhe për funksionet shtesë ,që do të thotë se për funksionete veta Bashkia përveç fondeve të Trasfertës dhe atyre të trashëguara do të përdorë sipas celjes së fondeve Buxhetore (Rritje kërkesë Buxhetore) të të Ardhurave të realizuara për çdo muaj.

BUXHETI TOTAL ME FONDET E VETA.

	Funksioni	600 Pagat	601 Kontrib.e Sigurimeve Shoqerore	602 Mallra dhe Sherbime	604 Te Tjera Transferta Korrente Brendshme	609 Shpenzime peremergjenca+kontigjenca+fondi rezerve	606 Transferta per Buxhetet Familiare dhe Individet	230 Shpenzime Kapitale te Patrupez. PROJEKTE	231 Shpenzime Kapitale te Trupezuara	Totali Totali
01	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	165,862,306.00	27,698,560.00	35,976,029.92	1,560,600.00	30,874,524.00	3,609,228.00	6,100,000.00	83,766,705.00	355,447,952.92
02	Trasheg.Kultur ore evente Artist.dhe Kult.	5,132,172.00	857,059.00	3,036,800.00						9,026,031.00
03	Sporti dhe Argetimi			12,152,400.00						12,152,400.00
04	Arsimi Baze Dhe Parashkollor			19,221,470.00						19,221,470.00
05	Menaxhimi i Infrastr.Ujore dhe kullimi F.Veta	1,605,265.00	183,015.00	6,192,310.00						7,980,590.00
1	Mbledhje Keshilli - (6 (12 c'do muaj jo vetem 4 ne total te mbledhjeve jashte rradhe nuk te jashtezakonshme nese do te kete nevoja)	1												16																
			1																											
				1																										
					2																									
						1																								
							1																							
								2																						
									1																					
										2																				
											1																			
												2																		
													1																	
2	Mbledhje Komisionit te Perhershem (mesatarisht 3-4 mbledhje komisionesh ne muaj)	3												41																
			3																											
				4																										
					3																									
						4																								
							3																							
								3																						
									3																					
										4																				
											3																			
												4																		
													4																	
3	Pajisja e mbledhjeve konstituese te Keshillave te Fshatrave dhe Keshillave Komunitare ne Lagje (ne te gjitha gjitha Njesi, transporti ne vatrex te kan per zdn Njesi per zon up nuk jane ngritur ende																	10000												10000
4	Trajnime te Keshillatareve me fund te Keshillit																	30000												30000
5	Vizite studimore / shkembim eksperiencash ne keshilla homologe																	35000						100000	250000					385000
6	Ceremoni dhenie titull nderi																													0
7	Ekspertize e jashtme per trajtim te ceshtjeve te ndryshme ne keshill																			15000										15000
8	Shtesa/paga pagujes per transmetimin e mbledhjeve live dhe aguritim e transparences ne publikim																					20000								20000
	TOTALI I SHPENZIMEVE														-	-	-	95,000	-	15,000	-	20,000	-	100,000	250,000	-	-	-	2,000	482,000	

Plani vjetor i konsultimeve Keshilli Bashkiak
Rrogozhine 2023

	Tema	Lloji i konsultimit	Numri I konsultimeve	Shpenzimet													Shenime
				Kancelari	Leter	Shtypshkrime	Karburant	Qera salle	Shpenzime per foni	Shpenzime media	Njoftime ne media	Dieta	Akomodim	Boje printer/ fotokopje	Sherbime nga te trete per IT	Totali i shpenzimeve	
1	Buxheti vjetor dhe PBA	Flete palosje															
		Degjese publike Bashkia qender	1													0	
		Degjese publike NjA	1				6,000									6,000	
		Degjese publike me OJF/etj														0	
		Emision televiziv														0	
		etj														0	
2	Paketa fiskale	Flete palosje														0	
		Degjese publike Bashkia qender	1													0	
		Degjese publike NjA														0	
		Degjese publike me OJF/etj														0	
		Emision televiziv														0	
		etj														0	
																0	
3	Ndryshim buxheti	Flete palosje														0	
		Degjese publike Bashkia qender	1													0	
		Degjese publike NjA	1				6,000									6,000	
		Degjese publike me OJF/etj														0	
		Emision televiziv														0	
		etj														0	
5	Miratimi i normave e standarteve te secilit prej sherbimeve publike bashkiake	Flete palosje														0	
		Degjese publike Bashkia qender														0	
		Degjese publike NjA														0	
		Degjese publike me OJF/etj														0	
		Emision televiziv														0	
		etj														0	
6	Konsultim per blerje/ qera/ tjetersim prone (shpronesim)	Flete palosje														0	
		Degjese publike Bashkia qender	1													0	
		Degjese publike NjA														0	
		Emision televiziv														0	
		etj														0	
8	Miratimi i planit te sherbimit publik per secilin prej sherbimeve publike bashkiake	Flete palosje														0	
		Degjese publike Bashkia qender	1													0	
		Degjese publike NjA	1				6,000									6,000	
		Degjese publike me OJF/etj														0	
		Emision televiziv														0	
		etj														0	
9	Konsultim per planin strategjik te bashkise (miratim apo rishikim)	Degjese publike Bashkia qender														0	
		Degjese publike NjA														0	
		Degjese publike me OJF/etj														0	
10	Konsultim per planin e pergjithshem vendor apo ndryshimet e tij (ligji nr. 107/2014)	Degjese publike Bashkia qender														0	
		Degjese publike NjA														0	
		Degjese publike me OJF/ndertues etj														0	
	TOTALI I SHPENZIMEVE			**0**	**0**	**0**	**18,000**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**18,000**	

Keshilli Bashkiak Rrogozhine
BUXHETI VJETOR 2023

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Numri	Paga dhe sigurime mujore	Vlefta vjetore
1	Honorare per Keshillin (1/10 e pages se kryetarit)	21		
2	Sekretari i Keshillit, page, sigurime shoqerore	1		
	Honorare per kryetaret e fshatrave	41		
3	Administratore te lagjeve - Qytet	4		
5	Shpenzimet sipas Plani I punes I detajuar ne shpenzime (detajuar ne sheet tjeter)			482,000
6	Shpenzime per konsultime (detajuar te plani vjetor i konsultimeve)	buxheti, paketa fiskale, shitja dhenje me qera e pronave, miratimi I komisioneve te keshillit, rregullores se keshillit, plani strategjik I zhvillimit te bashkise,		18,000
Nr.	**Investime**			
	TOTALI I SHPENZIMEVE			-
				500,000

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4521 Prot.
1

Rrogozhinë, më 21.12.2023

RELACION

PËR PROGRAMIN E DETAJUAR TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË RROGOZHINË PËR PERIUDHËN JANAR 2024 – DHJETOR 2024

Të nderuar këshilltarë,

Të nderuar Kryetare/ë të Komisioneve të Përhershme të Këshillit

Programi i Punës së Këshillit për periudhën Janar 2024 - Dhjetor 2024, shoqëruar me planin e detajuar të konsultimeve dhe buxhetin e nevojshëm, është hartuar në mbështetje të nenit 54 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore ", Ligji nr. 68, datë 27.04. 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligje të tjera relevante me ndikim në funksionimin e qeverisjes vendore në përgjithësi dhe Këshillin Bashkiak në veçanti dhe rregulloreve specifike të miratuara në Këshillin Bashkiak Rrogozhinë.
Në mbështetje të nenit 51/3 , nenit 54 të ligjit 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe në zbatim të Rregullores së Funksionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, Neni 119 "Programi i Punës së Këshillit Bashkiak", po Ju propozoj *"Programin e Punës të Këshillit për periudhën Janar 2024 – Dhjetor 2024"*
Ky program pune ka për qëllim të përcaktoj aktivitete mujore që duhet të ndiqen nga Këshilli Bashkiak për organizimin e tij në një mënyrë sa më të plotë dhe efiçente. Gjithashtu trajton në mënyrë të detajuar të gjitha pikat e rendit të ditës mujore, (por gjithmonë duke patur parasysh dokumentacionin që do të hartojë dhe do të paraqesë administrata e bashkisë Rrogozhinë), sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Plani bashkëlidhur.

Sipas këtij relacioni, do të mbështeten dhe aktivitetet që Këshilli ka, në përputhje me funksionet e veta dhe në shërbim të interesit të komunitetit siç janë dhe seancat këshillimore për të gjitha rastet, që parashikon ligji. Shpenzimet e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për aktivitetet e vitit 2024 do të jenë rreth 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

Këto fonde kërkohet të shqyrtohen dhe detajohen në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të thirrur për këtë qëllim dhe në mbledhjen e radhës së Këshillit ku do të shqyrtohet ky projektvendim. Fondet do të miratohen nga Këshilli në Buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024 i cili do të sillet në Këshill për miratim në muajin Dhjetor 2023.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT

ERIND TOSKU

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Nr. 4207 prot
Dt. 17.11.2023

Rrogozhinë 15.11.2023.

Për dijeni: Kryetari
Për zbatim: Sek. Këshillit Bashkiak

KESHILLIT BASHKISE RROGOZHINE

K E R K E S E

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.112 .2013 "Per Dekoratat e Titujt e Nderit ,Medaljet ,dhe Titujt Vndore te Nderit ne Republiken e Shqiperise Neni 16 "Llojet e Titujtve vendore te nderit
pika 1. Titulli "Qytetar .Nderi "jepet nga Keshilli Komunal ose Bashkiak.cdo personaliteti Shqiptare ose te huaj per veprimtari te shquar ne dobi te komunes ose Bashkise perkatese ose veprimtari per mbrojtjen dhe promovimin e interesave te saj .
Mbeshtetur ne kete ligj nje grup personash te mbledhur me dt.07.11.2023 nga Rrogozhina ,fshati Thartor , Karina e Peqinit ,Gosa qender dhe Historian nga Kavaja dhe perfaqsues nga Organizata e Veteraneve te L.A.N.CL. Rrogozhine ku u be Promovimi I librit Monografi te autorit Rustem Thartori kushtuar jetes dhe veprimtarise se "Deshmorit Atedheut "Ramazan Halil Thartori me titull " Nderi I Malesise Rrogozhine " gjate viteve te Luftes Antifashiste Nacional Clirimtare.
Te pranishmit ne salle dhe ato qe diskutuan ne kujtim te 150 vjetorit te lindjes se Ramazan Halil Thartori I propozojn dhe I kerkojne Keshillit Bashkise Rrogozhine qe ti jepet titulli "Qytetar Nderi " pas vdekjes. Ramazan Thartori.
Bashkangjitur me kerkesen jane keto dokumenta .

Nr ren.	Permbajtja e dokumentit	nr. fletve
1	Kerkese drejtuar keshillit Bashkise Rrogozhine	Nje
2	Relacion	Dy
3	CIVI Per Deshmorin e Atedheut Ramazan Thartori	nje
4	Lista e Personave ne Promovimin e librit "Nderi Malsise Rrogozhines	nje
5	Opinjoni I Organizates Veteranve L.A.N.CL .Rrogozhine	një
6	~~Shuma flete~~ Deklarata	tre
	Shuma fletë:	Nëntë

ASTRIT THARTORI cel . 069 410 6740.

KOMITETI VETERANEVE TE LANCIT DHE
PASARDHESVE NDERI KOMBIT BASHKIA
RROGOZHINE

Nr.54/1.prot Dt.14/11/2023

LENDE: KERKESE

KESHILLIT BASHKIAK BASHKIA RROGOZHINE:

Komiteti Veteraneve Rrogozhine ne vazhden e respektimit te te reneve per clirimin e Atedheut ne luften Nacionale Clirimtare.

Me rastin e 150 vjetorit te lindjes se Deshmorit te Atedheut RAMAZAN HALIL THARTORI nga fshati THARTOR I malesise se Rrogozhines I cili dha jeten nga torturat e qeverise fashiste me DT.20.01.1943.

Propozojme qe Keshilli Bashkiak ti jape titullin QYTETAR NDERI si Deshmor I Atedheut mbas vdekjes.

Eshte ne nderin e qytetit tone dhe Keshillit Bashkiak vlersimi I figurave historike e patriotike per ti nderua.

Respekte per ju.

Per Komunitetin e Veteraneve Rrogozhine

Sekretar

Sabri Mingaj

Kryetari

Ylli Thartori

ORGANIZATA VETERANEVE TE LANCIT RROGOZHINE

D E K L A RA T

Une e quajtura Fatmira Sulejman Thartori (Saraci) lindur ne fshatin Gose e madhe te bashkis Rrogozhine dhe banuese Gose qender e martuar me nipin e Ramazan Thartori me Astrit Zeqir Thartori me profesion mesuese sot N/Drejtoreshe e shkolles Mesme Gose qender.Mbeshtetur ne tregimet qe tregonte vjerri po dhe nga veteran te tjere kam ndigjuar se familja e Ramazan Thartori ne fshatin Thartor ka qen baze e luftes nacionalclirimtare nga marsi vitit 1941 e deri me clirimin e plote te vendit. Gjithashtu Ramazan Thartori kish qene disa vite kryeplak I fshatit Thartor dhe kishte mbeshtetur qe ne fillim te vitit 1941 Ceten e Pezes dhe kishte strehuar partizanet e pare te plagosur te luftes pare 16 mars 1941.Pas strehimit te partizaneve te plagosur ne qershor te vitit1941 ne fshat kishte ardhur milicia fashiste ku kerkonte kryeplakun Ramazan Thartori per te treguar se ku I kishte strehuar partizanet dhe ku ndodhej Myslim Peza dhe Ceta e tij. Nga Ramazan Thartori ato nuk mesuan asgje dhe menjehere grumbulluan banoret e fshatit Thartor ku ne qender te fshatit kan rrahur e torturuar 70 vjecarin Ramazan Thartori po milicia nuk mesoi asnje fjale nga Ramazani po vetem I thonte se Myslim Peza dhe partizanet rrijne ne male pastaj milicia mori 6 djem te moshes 15-20 vjec te lidhur ne peme dhe ju kerkonin ku ishte Myslim Peza dhe Ceta e tij po nga goja e te rijve degjohej vetem nje fjale nuk dijme gje dhe nuk e njohim Myslim Pezen. Ne kete kohe milicia fashiste kishte vendosur te merte me vehte 50 burra ,gra,pleq,femij e te lidhur I kishin derguar ne rrugen Hemenraje,Okshtun , Kryeluzaj dhe me makina I kishin derguar ne kampin e Ndroqit Tirane.Ramazan Thartori u denua nje vit burg dhe pas lirimit nga burgu paraqitej dy here ne jave ne Milicine e Peqinit ku I kerkonin te dhena per Myslim Pezen dheCeten e tij .Po nga goja e tij nuk doli asgje deri sa milicia kishte vendosur ta eliminonte duke e helmuar ne 19 janare 1943. Ne nderim te kontributit te dhen nga Ramazan Thartori sipas letres se Myslim Pezes drejtuar familjes se Ramazan Thartori ku thuhet se Ramazan Thartori ishte Nderi I malesise Rrogozhines ku gjithe pasurine e vuri ne sherbim te luftes dhe ka mbajtur qendrim te mire ne burg e ne hetuesi ai ishte patriot.Ne kujtim te deshmorit te atedheut e qendreses te banorve te fshatit Thartor ne nentore te vitit 1989 ishte ndertuar lapidari ne qender te fshatit Thartor ku per kete ka dhe foto per pjesmarresit ne perurim.Per veprimtarine dhe per aktivitetin e Ramazan Thartori propozojm qe ti tepet tituli "Qytetare Nderi " me rastin e 150 vjetorit te lindjes nga ana e keshillit te bashkise Rrogozhine .

Rrogozhine me 07 / 11 /2023

D E K L A R U S I

Fatmira THARTORI

DEKLARATE

Une I quajturi Bashkim Adem Kushi lindur e banues ne Rrogozhine me profesion mesues e sot ne pension deklaroj se gjate viteve qe isha mesues ne fshatin Rrostej. te malesjse se Rrogozhines kam ndigjuar per Raprezaljen qe ka ndodhur ne fshatin Thartor me 13 qershor 1941 ku jane rrahur e torturuar 6 djemte moshes 15- 20 vjecare dhe po ate dite jane mare nga milicia 50 burra , gra , pleq e femij e kan derguar ne kampin e Ndroqit te Tiranes ku 16 prej tyre u burgosen pjesa tjeter u lirua. Nga te burgosurit ishte Ramazan Halil Thartori I cili u denua me 1 vit dhe pasi u lirua nga burgu paraqitej ne Milicin e Peqinit dy here ne jave.Me vone kam degjuar se Ramazan Thartori eshte helmua rnga milicia dhe ka nderruar jete .Gjithashtu di se eshte shpallur Deshmore I atedheut pas vitit 1979 dhe ne si shkolle e tetevjecare cdo date 5 Maje dita e deshmoreve shkonim si shkolle prane cezmes se fshatit Thartor ku na flisnin veteran te luftes antifashistenacional clirimtare ku tregonin dhe episode per Ramazan Thartori.

Duke qene pjese e komunitetit ne Rrogozhine dhe dhe ish mesues Rrostej per ate qe une kam lexuar dhe ndigjuar jam mendimit qe deshmorit te atedheut me rastin e 150 vjetorit te lindjes Ramazan Halil Thartori ti jepet tituli " Qytetar Nderi " per Malesine e Rrogozhines nga ana e Keshillit Bashkise Rrogozhine.

Rrogozhine 07. 11. 2023. Bashkim Kushi

D E K L A R A T

Une I quaturi Kadri Ferhat Daja lindur ne fshatin Kocaj 1939 te Malesise se Rrogozhines ku kam punuar gjithmone ne kete zone dhe si drejtues ne sektorin e malesise se Rrogozhines kam ndigjuar dhe nga veteranet e luftes nacionalclirimtare se shtepia e Ramazan Thartori ka qene baza e pare e luftes qe nga marsi 1941 e deri me clirimin e plote te vendit 1944 ne malesine e Rrogozhines .Kam ndigjuar se ne fshatin Thartor me 13 qershor te vitit 1941 eshte grumbulluar I gjithe fshati Thartor tek cezma e fshatit ku eshte rrahur fillimisht Ramazan Thartori I cili mbajti qendrim te prere se nuk dinte asgje per familjen Peza po ju pergjigjte Miliceve se Myslim Peza rrien ne mal.Po ne kete dite jan rrahur e torturuar te lidhur ne nje peme me koke poshte 6 djem te moshes15 deri 20 vjec ku ju kerkohej se ku ishin strehuar Myslim Peza dhe partizanet e plagosur te luftes se pare te 16 marsit 1941 te Pezes ku nga keto djem heronje milicia nuk mesoi asgje. Nga ky moment milicia mori vendimin ti mari rreth 50 banore burra, gra, pleq e femij e ka derguar ne Ndroq te Tiranes ku jan burgosur 16 burra te fshatit Thartor dhe Ramazan Thartori eshte denuar nje vit I burgosur . Pasi u lirua nga burgu Ramazanit ju la per detyre nga milicia qe te paraqitej dy here ne jave ne Milicine e Peqinit . Ne janare te vitit 194 3 pasi Ramazan Thartori kthehet nga Milicia e Peqinit ne shtepin e tij ne Thartor vjen nje grup Milicesh ne shtepine etij dhe pasi kembejn duhanin dhe fillon ta pij cigaren e dhene nga milicet pas 10 minutash fillon te kollitet ne keto momente milicet ikin nga shtepia e fshati pasi u gargantuan se ja arriten qellimit milicet u larguan.Djemt e Ramazanit moren mjekun ne Peqin po mjeku pasi beri viziten ju drejtua djemve te tij se babai eshte I helmuar dhe nuk shkon me shume se 5-6ore dhe keshtu ndodhi Ramazani ndrroi jete me 19 dhjetore dhe varrimi u be me 20 dhjetore 1943.Ne kujtim te tij ne fshatin Thartor u ndertua Lapidari ku I kushtohej deshmorit te atedheut Ramazan Thartori e banorve te fshatit Thartor per qendresen e Raprezaljes te 13qershorit1941 me rastin e perurimit pati te pranishem nga institucionet e atyre viteve veteran te luftes nac-cl. Banore te fshatit Thartor dhe shkolla 8 vjecare Rrostej.Duke patur keto merita evlersime qe I jane bere ne letren qe Myslim Peza I ka derguar familjes se tij ne vitin 1971 jap mendimin tim si perfaqsues I asaj zone dhe pasardhes veteran qe Ramazan Halil Thartorit tijepet tituli " Qytetar Ndri " Pas vdekjes me rastin e 150 vjetorit te lindjes nga Keshilli Bashkise Rrogozhine.

Rrogozhine me 07 / 11 / 2023

DEKLARUSI

KADRI D A J E

C I V I

Ramazan Halil Thartori

Ramazan Halil Thartori lindi ne fshatin Osmanllie dhe pas vitit 1953 me vendimte komitetit Ekzekutiv te rrethit Durres emerohet fshati Thartor .Ka lindur me 18 qershor te vitit 1873. U rrit po ne fshatin Osmanllie (Thartor) pa arsim .Kur arriti moshen umartua dhe pati 4 djem e dy vajza.Ne moshe te re rreth vitit 1908 ishte kryeplak I fshatit. Ne vitin 1912 bani organizimin e burrave te fshatit te tij per te· mbrojtur kalimin e Ismail Qemalit tek bishti zhurit ne Rrogozhine. Ka mare pjese ne te gjitha ngjarjet komtare duke u rreshtuar perkrah Adem Gjinishtit, Ramazan Cani e Mahmut Kaziu.Ka mare pjese ne luften e Shkodres nga fundi 1912 - 1913 dhe eshte plagosur. Ka marepjese ne rojen e sigurise te delegateve te Kongresit Lushnjes 1920. Shtepia e tij ka qene baze luftetarve te lirise si Myslim Peza , Ramazan Cani etj.

Ka mbeshtetur te gjithe kandidatet e opozites demokratike dhe ka qene kundra bejlerve derine fillimte viteve 1939.Me 7 prille 1939 ka organizuar burrat efshatit per te luftuar kundra fashizmit Italian ku kan arritur deri tek shkembi I Kavajesne Golem dhe jan kthyer mbrapsh sepse mbreti Zog e kishte shitur vendin.Ne mars te vitit 1941 lidhi besen me Myslim Pezen per ta mbeshtetur Ceten e Pezes me ushqime e veshmbathje dhe armatimet ku do timernin ne pikat e tyre ne Peqin dhe Rrogozhine. Ne mars te vitit1941 priti partizanet e plagosur ku qendruan afro 7 muaj deri sa u sheruan.Gjate luftes nacionalclirimtare shtepia e tij ka qene baza mbeshtetse per Ceten e Pezes me vone per Grupine Pezes dhe per Brigadat sulmuse qe kaluan ne kete zone. Vellezrit ,djemt , nipat ,grate qe gatuenin cdo nate ishin pjesmarres direkte ne mbeshtetje te luftes clirimtare Antifashiste po mbeshtetje pati nga gjithe fshati jo vetem ne pritjen e percjelljen e partizaneve po dhe pjesmarres direkt ne lufte.

Me 13 qershor 1941 rrihet barbarisht si person dhe banorete fshatit nga Milicia e Peqinit dhe dergohen 50 banore burra, gra ,epleq ne kampin e Ndroqit ku burgosen 16 burra e pleq u masakruan barbarisht per te treguar partizanet eplagosur.Pas nje viti burg Ramazani detyrohej te shkonte ne milicine e Peqinit per te treguar se ku strehohej Ceta e Pezes dhe komandanti saj Myslim Peza deri sa arriti qe milicia te vente ne shtepine e tij per ta eleminuar Ramazanin duke e helmuar me 19 janare 1943, Figura patriotike e Ramazan Thartori eshte vlersuar gjate luftes e gjate gjithe kohes nga Myslim Peza .

PROPOZOJM Keshillit Bashkise Rrogozhine qe Deshmorit te Atedheut ti japi (pas vdekjes) titullin "Qytetar Nderi "

Rustem Thartori

Këshillit të Bashkisë
Rrogozhinë

R E L A C I O N

Të nderuar këshilltarë,
Me datën 31.10.2023 në qytetin e Rrogozhinës u organizua promovimi i librit historik "NDERI I MALËSISË SË RROGOZHINËS", siç e ka quajtur patrioti i madh Myslim Peza, kushtuar jetës dhe veprimtarisë patriotike të Dëshmorit të Atdheut Ramazan Halil Thartori nga fshati Thartor, I helmuar nga milicia fashiste në janar të vitit 1943, shkruar nga bashkëqytetari ynë Rustem Thartori.
Në këtë aktivitet kulturor morën pjesë të afërm.të familjes, veteranë të Luftës Antifashiste Çlirimtare, miq e të njohur të familjes nga fshatrat e Malësisë së Rrogozhinës, mësues dhe qytetarë nga Rrogozhina, Luzi i Madh, Kalushi, historianë nga Kavaja nga Peqini,
Dëshmori i Atdheut Ramazan Thartori, i thirrur me respekt "Babë Zani".ka lindur në fshatin Thartor në vitin 1873. Ka qenë për shumë vite kryeplak i fshatit Thartor, bashkë me lagjet Murraj e Çekë. Gjatë gjithë viteve si kryeplak mbahet mend për drejtësi, ndershmëri, mençuri e zgjuarësi në zgjidhjen e çeshtjeve të ndryshme në komunitetin e tij.
Si kryeplak i fshatit ka qendruar gjithmonë në krahun e bashkëfshatarëve në kërkesat e tyre për të lehtësuar sadopak jetën e tyre.
Kështu në vitin 1933, kryesisht me shpenzimet e veta, ai ndërtoi një çezmë uji të pijshëm, duke lehtësuar furnizimin me ujë të fshatit.
Dëshmori i Atdheut Ramazan Thartori ka marrë pjesë aktive në të gjitha ngjarjet e rëndësishme kombëtare. I rreshtuar në krah të atdhetarëve të njohur peqinas Adem Gjinishi, Ramazan Cani, Mahmud Kaziu e të tjerë ai ka marrë pjesë:
1.Në krye të bashkëfshatarëve të vet, krahas të tjerëve, siguroi rrugën e kalimit të delegatëve të Vlorës nga Bishti i Zhurit deri tek Ura e Rrogozhinës, nëse ata do të kalonin andej.
2.Ka marrë pjesë në Luftën e Shkodrës më 1912-13, ku eshte është plagosur.
3.Ka marrë pjesë në rojen e sigurisë së delegatëve të Kongresit të Lushnjes më 1920.
4.Ka mbështetur gjithnjë kandidatët e opozitës demokratike kundër klasës së bejlerëve.
5.Shtëpia e tij ka qenë bazë e luftëtarëve të lirisë Myslim Peza, Ramazan Cani e të tjerë.
6.Gjatë Luftës Çlirimtare Antifashiste jo vetëm shtëpia dhe familja e tij por i gjithë fshati Thartor u bë bazë e sigurtë për partizanët nga viti 1941 deri më 1944.
7.Më 13 qershor 1941 familja e tij strehoi partizanët e plagosur të Pezës Shyqyri Pezën, Fadil Celmeten, Skënder Pezën, të birin e Myslimit, Abdurrahman Pezën dhe të tjerë. Milicia fashiste ka masakruar barbarisht popullin e Thartorit për të treguar partizanët e plagosur. Burra, gra, sidomos 5 të rinj janë torturuar egërsisht, duke i varur ata në degët e pemëve e duke i rrahur me kondakun e pushkëve duke i rrahur për vdekje. Milicia arrestoi burra e gra mbi 20 vjet dhe i burgosi në burgun e Durrëit dhe në kampin e përqendrimit ne Ndroq. Ramazan Thartori bëri më shumë se një vit burg dhe u lirua nga ndërhyrja e miqve të tij.
8. Pas daljes nga burgu ai u detyrua të paraqitej dy herë në javë në xhandarmerinë e Peqinit për ta detyruar atë të tregonte bazat e luftës të partizanëve të Myslim Pezës. Meqense nuk ia arritën dot, me 18 janar 1943 nisën një skuadër milicësh për në

CamScanner

Thartor. Ata vajtën në shtëpinë e tij dhe e helmuan Ramázan Thartorin me një cigare të helmuar. Ndërroi jetë më 19 janar 1943.

9.Figura patriotike e Ramazan Thartorit është vlerësuar gjatë gjithë kohës. Myslim Peza në disa letra që i ka dërguar familjes së tij e quan atë "Nderi i Malësisë së Rrogozhinës".

10.Pjesëmarrësit në promovimin e librit "Ramazan Thartori – Nderi i Malësisë së Rrogozhinës" pasi vlerësuan figurën e këtij Dëshmori"

PROPOZOJNË:

Këshilit të Bashkisë Rrogozhinë vlerësimin e Dëshmorit Ramazan Thartori duke i dhene (Pas Vdekjes) titullin "Qytetar Nderi" me motivacionin:

"Për kontributin e shquar për lirì e demokraci, një personalitet i shquar i Malësisë së Rrogozhinës dhe për Luftën Clirimtare Antifashsite, për të cilën ai dha edhe jetën".

Është në nderin e të gjithëve, anëtarëve të Këshillit Bashkiak, popullit të Rrogozhinës dhe Malësisë së Rrogozhinës vlerësimi i këtij patrioti të madh, sepse ai nuk i përket vetëm Dëshmorit Ramazan Thartori, por të gjithë popullit të Rrogozhinës.

CamScanner

LISTA E PJESMARRESVE NE PROMOVIMIN E LIBRIT "NDERI MALESISE RROGOZHINES,"

Nr,Ren	EMER MBIEMER	VENDBANIMI	VENDI PUNES	PROFESIONI	
1	Reuste Thartori	Rrogozh	pensionist	ekonomist	
2	Sabire Thartori	Rrogozh	"	pensionist	
3	Hysni Sina	Rrogozh.	"	mesues	
4	Kristina Dushku	Rrogozh	"	Agronom	
5	Sabri. Muçaj	"		Ekonomist.	
6	Adela Thartori	Kavinë	=		
7	ALTIN THARTORI	KAVINË	=		
8	Lenë Thartori	KAVINË	=	—	
9	Nazmi Thartori	Rrogozhin	-		
10	Rami Orfo	Rrogozh.	—	RO	
11	Arsen Hoxha	Rrogozh	-	Police	
12	Xhuli Thartori			—	
13	Xhuli Bashkëza				
14	Syljan Dedaj				
15	Orjan Agaj	Kavaj	mesues	Mesues	
16	SILI THARTORI			PENSYONIST	
17	Shefat Thartori			Pension	
18	Koço i Thartori		PO PUNË		
19				Pensjonist	
20	Sonjë Spaho				
21	Xhemine Dervishi			pensionist	
22	Bedrit Thartori				
23	Anxhela Thartori	G.e Vogël	Rrogozhinë	Police Bashkiake	
24	FATMIRA THARTORI	GOSË E MADHE (M/DRESTAD)		MËSUESE	
25	AGRIT THARTORI	GOSE	POLICIA SHTET.	POLICIA	
26	Florentina Thartori	Rrogozhinë	Mësuese (Rrogozhinë)	Mësuese	
27	Bardhyl Vyshka	Rrogozhinë	Punëtor	Mësues	
28	Rifat Hoxha	Kavaj	Punëtor	Hidraulik	
29					
30					
31					
32					
33					
34					
35					

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINE

Nr. 4269/4 **Prot** **Rrogozhine** 06.12.**2023**

Lenda : Dergim relacioni per dhenien e titullit "Qytetar nderi "
te z. Ramazan Halil Thartori

Drejtuar : Kryetares se Kshillit te bashkise

Znj.MUKADES GIXHARI

Ne pergjigje te kerkeses Tuaj ,me shkresen Nr.4269 date 22.11.2023 shqyrtimin e propozimit per dhenien e titullit "Qytetar Nderi "te z.Razan Halil Thartori, bashkelidhur ju dergojme Relacionin e sektorit juridik per kete ceshtje se bashku me dokumentacionin qe na kini vene Ju ne dispozicion.

Faleminderit.

Drejtori e Ars.Kult,Turiz.Rinis e Sporteve

Fatmir MECAJ

KRYETAR

Edison MEMOLLA

Ne mungese dhe me porosi

KRYETAR

Andi PR[illegible]HRA

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Nr 4269/3 prot.

Rrogozhinë më 06.12.2023.

RELACION

"Për shqyrtimin e propozimit për dhënie të titullit ***"Qytetar Nderi"*** të Ramazan Halil Thartori"

Komiteti i veteranëve të LANCIT të bashkisë Rrogozhinë me kërkesë Nr 36/1 prot datë 14.11.2023 i kërkon këshillit të bashkisë Rrogozhinë që dëshmorit të Atdheut Ramazan Halil Thartori ti jepët tiulli "Qytetar Nderi"

Baza Ligjore.

Ligji Nr 139/2015 neni 54 gërma "m" " Për Vetqeverisjen Vensore"i ndryshuar.

Ligji Nr 112/2013 " Për dekoratat,tituj nderi,medalje. Dhe tituj vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

Në gërmën " m" të nenit 54 " Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" ku është e cituar

- ***"Jept tituj nderi dhe stimuj".***

Mbështetur në nenitn 54 gërma "m" të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" këshilli i bashkisë ka kompetencë të tij për vendim marrjes për dhënie i titullit të nderit.

Referuar ligjit nr 112/2013 " Për dekoratat,tuituj nderi.medalje dhe tiuj vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15 "Autoriteti Përgjegjës"
1. Autoritetet përgjegjëse për dhënien e titujve vendorë të nderit janë:
a) këshilli komunal ose bashkiak;
b) këshilli i qarkut.
2. Titujt vendorë të nderit jepen, kryesisht, ose me propozimin e:
a) çdo anëtari të këshillit komunal ose bashkiak;
b) kryetari të komunës ose bashkisë;
c) çdo anëtari të këshillit të qarkut;
ç) kryetarit të këshillit të qarkut.

Pika 1 e nenit 15 përcakton se autoriteti përgjegjës për dhënie të titijve nderi është këshilli i bashkisë Në pikën 2 gërma a,b,c dhe Ç përcakton të drejtën e prop[ozimit për dhënie të titullit të nderit.

Referuar nenit 16 ***"Llojet e titujve vendorë të nderit"*** të ligjit Nr 112/2013 " Për dekoratat,tuituj nderi.medalje dhe tituj vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

1. *Titulli "Qytetar nderi" i jepet nga këshilli komunal apo bashkiak çdo personaliteti shqiptar ose të huaj për veprimtari të shquar në dobi të komunës apo bashkisë përkatëse ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të saj.*
2. *Kjo dispozitë ka përcaktuar se këshilli i bashkisë ka kompetenca të japë tituj "Qytetar Nderi"*

Procedura që ndiqet për dhënien e tutullit te nderit vendor.

Neni 17 të pika 1 e ligjit Nr 112/2013 " Për dekoratat,tuituj nderi.medalje dhe tituj vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë" përcatorn :

1. *Çdo autoritet përgjegjës për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve ose titujve vendorë të nderit krijon pranë tij një komision këshillimor, të përbërë prej 5 anëtarësh, ku 3 anëtarë duhet të jenë punonjës nën varësinë e tij dhe 2 anëtarët e tjerë personalitete të jashtme. 2. Në rastin e medaljes "Qytetar nderi i Republikës së Shqipërisë",*
2. *Kjo dispozitë specifikon se autoriteti përgjegjës që jep tituj nderi në rastin në fjalë është këshilli i bashkisë Rrogozhinë krijon komision të pozacën sipas përcaktineve të cituara më lart.*

Neni 18 i ligjit Nr. Nr 112/2013 " Për dekoratat,tuituj nderi.medalje dhe tituj vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë" përcatorn : afatat kohore të shqyrtimit të propozimit për dhënie titij nderi.
1. Komisioni këshillimor verifikon nëse akti i propozimit përmban të gjitha elementet e kërkuara nga ky ligj.
2. Nëse propozimi nuk është i plotë, komisioni këshillimor kërkon me shkrim, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së propozimit, plotësimin e tij nga autoriteti propozues. Plotësimi i propozimit bëhet jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.
3. Nëse propozimi është i plotë, komisioni këshillimor paraqet mendimin e tij pranë autoritetit përgjegjës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së propozimit.
4. Procedurat për shqyrtimin e dhënies së një dekorate, medaljeje ose titulli nderi nuk mund të zgjasin më shumë se 60 ditë kalendarike.
5. Procesi i shqyrtimit të propozimit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të dekorimit, dhënies së titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Në përfundim të këtij ralatimi se vetem pasi propozimi të ketë kaluar në këto procedura keshilli I bashkisw Rrogozhinw ushtron ka kompetencëne dhwnw nw gwrma "m" e nenit 54 tw ;igjit 139/2015 "Pwr Vetqevrisjes Vendore pwr vendimarrje pwr dhwnie e titullit **"Qytetar Nderi"** Ramazan Halil Thartori.

Relatoj sek juridik

Luan Gjuzi

Nr. 4376 prot
Dt. 07.12.2023

Për dijeni: Kryetari
Për zbatim: Këshilli Bashkia

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
NJËSIA ADMINISTRATIVE SINABALLAJ

Nr 318 prot. Sinaballaj më 07.12.2023.

LËNDA. MBI TITUJT NDERI.

. DREJTUAR: KËSHILLIT TË BASHKISË RROGOZHINË.

PËR DIJËNI: BASHKISË ROGOZHINË.

Referuar shkresës suaj me Nr- 4269/1 datë 30.11.2023 me lëndë "Shqyrtim të propozimit për dhënie titullit " Qytetar Nderi" të Z.Ramazan Thartori, Njësia Administrative Sinaballaj mbështetur në:

pikën," gj "të nenit. 66 - "Detyrat e administratës së njësisë administrative".

"g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial";

japim miratimin tonë në parim mbi miratimin e kërkesës për dhënie e titillit "Qytetar Nderi" Z. Ramazan Thartori.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

ADMINISTRATORI
MEXHIT SALIU

Dt. 14.11.2023

- Këshilli Bashkiak Rrogozhinë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

NJËSIA ADMINISTRATIVE SINABALLAJ

Nr. 294 Prot. Sinaballaj,më 14.11.2023

LENDA : Raport mbi mbarevajtjen e punes dhe problematikat e hasura gjate periudhes Qershor-Tetor 2023.

DREJTUAR: KESHILLIT BASHKIAK RROGOZHINE.

PER DIJENI: Z. EDISON MEMOLLA

KRYETAR I BASHKISE RROGOZHINE.

Bazuar ne shkresen tuaj me nr 3924 prot date 30.10.2023 ju raportojme se gjate periudhes Qershor – Tetor te vitit 2023 Njesia Administrative Sinaballaj ka ndjekur me prioritet detyren per realizimin e te ardhurave ku nga verifikimet e kryera raportojme se per kete periudhe plani i te ardhurave ne total per te gjithe zerat eshte 2042585 leke dhe realizimi 1133000 leke, 55.5 %.

Ne zerat te vecante realizimi per periudhen Qershor – Tetor 2023 eshte si me poshte vijon:

1-Takse ndertese familjar	Plani 422687	Fakti 260640 leke	61.6 %
2-Takse e tokes bujqesore	Plani 1355885	Fakti 751160 lek	55.3 %
3-Sherbime (pastrim + gjelberim + ndricim)	Plani 264013	Fakti 121200 leke	45.9 %
Total	Plani 2042585	Fakti 113300 leke	55.5 %

Problematika jane hasur kryesisht ne infrastrukture ku pothuaj te gjitha rruget e fshatrave kane nevoje imedjate per nderhyrje me sistemim dhe karikim por dhe pastrim kanalesh dhe riparim urash sipas askseve si me poshte vijon:

1.Ne fshatin Sinaballaj ka nevoje per pastrimin e shtratit te perroit nga prita deri te ura e trenit dhe ne vazhdim (hurdha e Kapllaneve) me gjatesi 1 km dhe perroi i vargut me gjatesi 1 km.

2.Rrogozhine –Hemenraje-Mèmollaj me gjatesi 4 km.sistemim dhe karikim rruge.

3.Sinaballaj – Koçaj- Thartor me gjatesi 11 km sistemim dhe karikim rruge.

4.Sinaballaj Kanali i Zogut ka nevoje per pastrim 2 km.

5.Fliballije – Rrostej –Thartor me gjatesi 7.5 km ka nevoje per sitemim dhe karikim rruge.

6.Fliballije –Demarkaj me gjatesi 1 km ka nevoje per sitemim dhe karikim rruge.

7:Kerkojme riparimin e 2 urave qe sherben si rruge per 4 fshatrat e Malesise

8.Riparimin e ures se pare ne fshatin Methasanaj te rruges Koçaj-Thartor.

9.Sistemim dhe karikim i rruges ne fshatin Fliballie lagja Kalemeve.

Theksojme se per ti ardhur ne ndihme banoreve per transportin e ullirit qe eshte prodhim i ketyre fshatrave per ta derguar prane fabrikave te vajit ,kerkohet nderhyrje imedjate me mjetet e bashkise per rregullimin e rrugeve para fillimit te sezonit shirave

Faliminderit per mirkuptimin.

ADMINISTRATORI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-NJËSIA ADMINISTRATIVE SINABALLAJ BASHKIA RROGOZHINË

Merhit SALIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4522 Prot.

Rrogozhinë, më 21.12.2023

R A P O R T

MBI VENDIMET E MARRA NGA KËSHILLI BASHKIAK PËR PERIUDHËN JANAR – NËNTOR 2023, VENDIMET TË CILAT NUK JANË KONFIRMUAR LIGJËRISHT NGA PREFEKTI I QARKUT TIRANË, SI DHE ZBATUESHMËRIA E KËTYRE-VENDIMEVE NGA ANA E ADMINISTRATËS SË BASHKISË

Të nderuar Këshilltarë ,

Nisur nga kërkesa e anëtarit të Këshilli Bashkiak z. Enver Memolla po ju paraqesim në vijim një raport të përmbledhur mbi Vendimet dhe mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Bashkiak Rrogozhinë për periudhën Janar - Nëntor 2023, vendimet e pakonfirmuara ligjërisht nga Prefekti i Qarkut Tiranë dhe zbatueshmërinë e këtyre vendimeve nga ana e Administratës së Bashkisë si më poshtë :

VKB të mbledhjes datë 20. 01. 2023 *(Procesverbal nr.1)*

Vendim nr .01. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2022 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .
Vendim nr .02. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i pushtetit vendor.

VKB të mbledhjes datë 27. 02. 2023 *(Procesverbal nr.2)*

Vendim nr . 3 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .
Vendim nr . 4 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
Vendim nr . 5 . Për miratimin e planit të emergjencave civile 2023 dhe dokumentin për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut për Bashkinë Rrogozhinë.
Vendim nr . 6 . Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit 'Rrugët sipër hekurudhës' faza e I-rë.

CamScanner

Vendim nr . 7 . Për miratimin e fondit për projektin, "Tungjatjeta jetë, shërbim lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar".

VKB të mbledhjes datë 27. 03. 2023 *(Procesverbal nr.3)*

Vendim nr . 8 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr . 9 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i pushtetit.vendor.

Vendim nr .10. Për një ndryshim të Vendimit Nr.15, datë 02.03.2000 të Këshillit Bashkiak për emrin e shkollës 9-vjeçare "Xhorxh Soros".

Vendim nr .11. Për miratimin në parim të servitutit të kalimit të një sipërfaqe bujqësore e ndodhur në Rrogozhinë fshat, parcela 35/4,35/5,35/13, ZK 3450 dhe parcelat 272/1 dhe 274/1, ZK 3235 Bashkia Rrogozhinë .

Vendim nr .12. Për mbylljen dhe disiplinimin e varrezës të fshatit Zeshtik Njësia Administrative Kryevidh.

VKB të mbledhjes datë 27. 04. 2023 *(Procesverbal nr.4)*

Vendim nr .13. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .14. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2023 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .15. Për disa ndryshime në vendimin nr.6, datë 27.01.2020 për krijimin e komisionit për programet e strehimit social (dhënien e subvencionimit të qirasë për shkak të fatkeqësive natyrore, subvencionimin e kredisë me interesa të ulët, si dhe për dhënien e banesave sociale me qira).

Vendim nr .16. Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin "Subvencionimi i interesave të kredisë".

VKB të mbledhjes datë 12. 05. 2023 *(Procesverbal nr.5)*

Vendim nr .17. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .18. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2023 nga fondi i pushtetit vendor.

VENDIMET E KËSHILLIT TË RI BASHKIAK MANDATI QERSHOR 2023 - 2027

VKB të mbledhjes datë 23. 06. 2023 *(Procesverbal nr.1)*

Vendim nr . 1 . Mbi miratimin e Komisionit të mandateve për Këshillin Bashkiak Rrogozhinë.
Vendim nr . 2 . Mbi miratimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.
Vendim nr . 3 . Mbi zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.
Venidm nr . 4 . Mbi zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.
Vendim nr . 5 . Mbi zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.
Vendim nr . 6 . Mbi zgjedhjen e anëtarëve që përfaqësojnë Këshillin Bashkiak në Këshillin e Qarkut Tiranë.

VKB të mbledhjes datë 30. 06. 2023 *(Procesverbal nr.2)*

Vendim nr . 7 . Për pranimin e dorëheqjes nga mandati i Këshilltarit të znj. Sadete Kaja.
Vendim nr . 8 . Për miratimin e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.
Vendim nr . 9 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .
Vendim nr .10. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i pushtetit vendor.

VKB të mbledhjes datë 31. 07. 2023 *(Procesverbal nr.3)*

Vendim nr . 11 . Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhië znj. Lije Dedej.
Vendim nr . 12 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .
Vendim nr . 13 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i pushtetit vendor.

CamScanner

VKB të mbledhjes datë 08. 08. 2023 *(Procesverbal nr.4)*

Vendim nr . 14 . Për shpalljen e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë.
Vendim nr . 15 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .
Vendim nr . 16 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i pushtetit vendor.

Mbledhja e datës 06.09.2023 *(Procesverbal nr.5) Nga kjo mbledhje nuk prodhohen vendime.*

VKB të mbledhjes datë 19. 09. 2023 *(Procesverbal nr.6)*

Vendim nr . 17 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .
Vendim nr . 18 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
Vendim nr . 19 . Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e strukturave komunitare në fshat.
Vendim nr . 20 . Për dhënie autorizimi Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë me objekt: Hartimin, nënshkrimin e marrëveshjes së posaçme ndërmjet Bashkisë Rrogozhinë dhe avokaturës së shtetit për të autorizuar e legjitimuar avokaturën e shtetit për të nënshkruar, depozituar rekursin për ta përfaqësuar Bashkinë Rrogozhinë në Gjykatën e Lartë të Rsh.
Vendim nr . 21 . Për pagimin e shpenzimeve të varrimit.
Vendim nr . 22 . Për një ndryshim në vendimin Nr.77 datë 27.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023 ".
Vendim nr . 23 . Për miratimin për servitut kalimi në pasurinë nr.1/187, zona kadastrale 3234, lagja nr.1, Rrogozhinë të kërkesës së z. Agron Aliu.
Vendim nr . 24 . Për dhënien e opinionit mbi propozimin për planin e ri tarifor për Ujësjellësin Rrogozhinë sipas shkresës së Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a me Nr.4244.Prot datë 28.08.2023.

VKB të mbledhjes datë 26. 10. 2023 *(Procesverbal nr.7)*

Vendim nr . 25 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr . 26 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr . 27 . Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile.

VKB të mbledhjes datë 02. 11. 2023 *(Procesverbal nr.8)*

Vendim nr . 28 . Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

VKB të mbledhjes datë 22.11.2023 *(Procesverbal nr.9)*

Vendim nr .29. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .30. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .31. Për deklarimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të Këshilltarit z. Bajazit Thaçi.

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË KËSHILLIT QË NUK JANË KONFIRMUAR LIGJËRISHT NGA PREFEKTI I QARKUT TIRANË

Këshilli Bashkiak Rrogozhinë përgjatë periudhës Janar - Nëntor 2023 mbështetur dhe në procesverbalet e Këshillit është thirrur për mbledhje 14-herë. Këshilli Bashkiak që nga data 28.10.2022 transmeton LIVE mbledhjet e tij në faqen zyrtare të Këshillit në rrjetin social Facebook emërtuar "Këshilli Bashkiak Rrogozhinë", dhe për vitin 2023 në këtë faqe gjenden të transmetura LIVE 13 mbledhje. Nuk është transmetuar LIVE mbledhja e datës dhe 02.11.2023, gjithashtu për arsye teknike mbledhja e konstituimit të Këshillit e mbajtur me datë 23.06.2023 e transmetuar Live në faqe është fshirë për arsye ende të paqarta. Për periudhën Janar - Nëntor 2023 janë marrë gjithsej 49 vendime nga Këshilli Bashkiak të cilat janë përcjellë për verifikim ligjor pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë nga ku 46 prej tyre janë gjetur në përputhje me aktet Ligjore e nënligjore në fuqi.

CamScanner

Për 3 (tre) vendimet e tjera Prefekti shprehet si më poshtë :

1 - Për VKB-në nr. 6 . datë 27.02.2023, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit 'Rrugët sipër hekurudhës' faza e I-rë".
Nuk është në përputhje me Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar si dhe me Ligjin nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" i ndryshuar me ligjin nr.20/2016 datë 10.3.2016 nr.11/2020, datë 12.2.2020.

2 - Për VKB-në nr.11, datë 27.03.2023, "Për miratimin në parim të servitutit të kalimit të një sipërfaqe bujqësore e ndodhur në Rrogozhinë fshat, parcela 35/4,35/5,35/13, ZK 3450 dhe parcelat 272/1 dhe 274/1, ZK 3235 Bashkia Rrogozhinë".
Nuk është në përputhje me nenin 4 të ligjit nr.77/2022 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.133/2015 "Për trajtimin e pronës për përfundimin e procesit të kompensimit të pronave".

3 - Për VKB-në nr.21, datë 19.09.2023, "Për pagimin e shpenzimeve të varrimit".
Nuk konfirmohet, referuar Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe Ligjit nr.9220, datë 15.04.2004 "Për administrimin e shërbimit të varrimit", ndryshuar me gjin nr.80/2014, datë 17.7.2014.

ZBATUESHMËRIA E VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK RROGOZHINË
PERIUDHA JANAR - NËNTOR 2023

Nr	Vendim i Këshillit Bashkiak, Nr / datë / titull	*Statusi i VKB - së* I pazbatuar / Zbatuar pjesërisht	Shënime
1	Vendim nr . 5 . datë 27.02.2023 "Për miratimin e planit të emergjencave civile 2023 dhe dokumentin për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut për Bashkinë Rrogozhinë".	Zbatuar pjesërisht	*Zbatohet aktualisht dhe deri në Dhjetor të vitit 2023.*
2	Vendim nr . 7 . datë 27.02.2023 "Për miratimin e fondit për projektin, "Tungjatjeta jetë, shërbim lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar".	Zbatuar pjesërisht	*Zbatohet aktualisht dhe deri në Dhjetor të vitit 2023.*
3	Vendim nr .12. datë 27. 03. 2023 "Për mbylljen dhe disiplinimin e varrezës të fshatit Zeshtik Njësia Administrative Kryevidh".	I Pazbatuar	*Vendimi i përcjellë Dr. së Politikave Urbane për zbatim.*

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

4	Vendim nr . 19 . datë 19.09.2023 "Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e strukturave komunitare në fshat".	Zbatuar pjesërisht	*Është përfunduar procesi i zgjedhjes së kryetarëve të fshatrave në Nj. A Gosë dhe Nj.A Sinaballaj. Nj.A Kryevidh ka ngelur vetëm fshati Spanesh pa zgjedhur Kryetarin e Fshatit (nga 12 fshatra total). Nj.A Lekaj- papërfunduar.*
5	Vendim nr . 22 . datë 19.09.2023 "Për një ndryshim në vendimin Nr.77, datë 27.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023 ".	Zbatuar pjesërisht	*Janë bërë procedurat e shpalljes së vendeve vakantë, në vijim ndiqen hapat e tjerë nga sektori i burimeve njerëzore për emërimin e punonjëve të MZSH-së.*
6	Vendim nr . 27 . datë 26.10.2023 "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile".	Zbatuar pjesërisht	*Proces tenderimi*

Të gjithë VKB-të e tjera të cilat janë konfirmuar ligjërisht nga Prefekti i Qarkut Tiranë nuk janë evidentuar në tabelën e mësipërme pasi janë zbatuar nga ana e Administratës dhe sektorëvë të cilëve ju është ngarkuar për zbatim Vendimi.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin .

Konceptoi ,
Sekretari i Këshillit
ERVIS SHERA

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT
ERIND TOSKU

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com